

RELACION

mbi

PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2025”

HYRJE

Projektbuxheti 2025 mbështet zhvillimin ekonomik dhe social të vendit si dhe reformat e nevojshme për integrimin sa më të shpejtë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë kuadër, plani i rritjes së Bashkimit Evropian (BE) për Ballkanin Perëndimor përbën një instrument të rëndësishëm për përshpejtimin e konvergjencës ekonomike sociale me vendet e BE nga vendi ynë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Në të njëjtën kohë, duke zbatuar në mënyrë rigorozë politikën e konsolidimit fiskal, sigurohet jo vetëm një stabilitet makroekonomik të vendit por edhe një ulje e qëndrueshme të borxhit publik në periudhën afatmesme 2025-2027.

Ekonomia e vendit parashikohet të zgjerohet me rreth 3.9 për qind në vitin 2024, e mbështetur nga kushtet e favorshme ekonomike, veçanërisht nga ecuria mjaft e mirë e sektorit të turizmit dhe aktivitetit të ndërtimit. Gjatë periudhës afatmesme 2025-2027, **rritja parashikohet të vijojë trendin pozitiv me mesatarisht në nivelin 3.9 për qind në vit**, ndikuar nga zhvillimet e ekonomisë së brendshme dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian. Aktiviteti ekonomik do të vazhdojë të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, nga rritja e mëtejshme e konsumit privat, ashtu edhe nga investimet në infrastrukturë si dhe zhvillimi i sektorëve strategjikë si turizmi.

Deficiti buxhetor për vitin 2025 planifikohet të jetë në **nivelin 2.6 për qind të PBB-së** dhe parashikohet të ulet më tej duke arritur në 1.4 për qind të PBB në vitin 2027. Balanca primare pritet të jetë e balancuar në vitin 2025, në zbatim të rregullit fiskal të parashikuar në LOB, ku përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare nuk mund të rezultojë më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Gjithashtu edhe **borxhi publik bruto** do vijojë trajektoren rënëse në përputhje me rregullin respektiv fiskal. Në vitin 2024 parashikohet që borxhi publik bruto të bjerë në rreth **56.3 për qind të PBB-së** dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth **55.8 për qind në vitin 2025**. Sipas skenarit bazë, borxhi publik bruto pritet të bjerë në rreth **55.0 për qind** në vitin 2026 dhe më tej në rreth **48.5 për qind** në vitin 2031.

Në projektbuxhetin e vitit 2025, **programimi i të ardhurave buxhetore** bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi. Të ardhurat buxhetore për vitin 2025 parashikohen në masën 754.6 miliardë lekë ose **28.8% e PBB-së**. Krahasuar me planin e rishikuar për vitin 2024, të ardhurat buxhetore për vitin 2025 parashikohen me rreth 40.6 miliardë lekë ose 0.2% e PBB më shumë.

Shpenzimet Buxhetore për vitin 2025 programohen në masën **822.7 miliardë lekë** ose rreth **31.4% e PBB-së** duke rezultuar rreth 51.4 miliardë lekë më shumë se plani i rishikuar i vitit 2024. Do të vijohet me financimin e një vëllimi të konsiderueshëm investimesh publike prej mesatarisht 6.1% të PBB përgjatë 2025-2027 të cilat përqëndrohen në financimin e projekteve me rëndësi strategjike dhe të lidhura me planin e rritjes së BE-së. Shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë mbështeten në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030 duke i kushtuar një vëmendje të veçantë dixhitalizimit, transportit, sigurisë kombëtare, shëndetësisë, arsimit dhe të bujqësisë e zhvillimit rural.

Në kuadër të **buxhetimit të përgjigjshëm gjinor**, në vitin 2025 do të vijojë adresimi i çështjeve të lidhura me barazinë gjinore kryesisht në fushat e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik. Në këtë projektbuxhet parashikohet që rreth 9.1% e shpenzimeve buxhetore t'i dedikohen politikave publike me bazë gjinore të përfshira në 77 programe buxhetore.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2025, janë parashikuar në masën **89.9 miliardë lekë**, me një rritje prej 13.2% më shumë se buxheti i vitit 2024. Këto shpenzime për vitin 2025, zënë **3.43% të PBB-së** nga 2.9 që zinin në vitin 2024 ose nga 2.3% në vitin 2015. Transferata e pakushtëzuar për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 është **1.8 miliardë lekë më shumë** ose rreth 7.6% më e lartë, dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale), është **13.9 miliardë lekë më shumë ose mbi dy herë më e lartë**.

1. SITUATA EKONOMIKE

1.1 ZHVILLIMET E FUNDIT DHE PERSPEKTIVA MAKROEKONOMIKE

Ekonomia e vendit gjatë viteve të fundit ka treguar një elasticitetit të konsiderueshëm përballë goditjeve të njëpasnjëshme që kanë prekur vendin tonë. Kjo qëndrueshmëri u vu në provë pasi vendi u përball me tre goditje të mëdha, të ndodhura njëra pas tjetrës me vazhdimësi të shpejtë, si: tërmeti, pandemia globale dhe ndërprerje të furnizimit në mallrat kryesorë për shkak të luftës në Ukrainë. Politikat e kujdesshme makroekonomike kanë mbështetur një rikthim të fortë ekonomik, dhe si rezultat fundamentet kryesore ekonomike dhe financiare si dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit kanë mbetur solide.

Përballë një mjedisi ekonomik sfidues, të karakterizuar nga çmime relativisht të larta, pasiguri dhe kosto financimi, vëllimi i aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2023 u rrit me 3.9 për qind, duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Ekonomia shqiptare vijon të qëndrojë në një trend pozitiv zhvillimi edhe gjatë vitit 2024. Sipas vlerësimeve të fundit të disponueshme nga INSTAT-i, PBB-ja reale shënoj një rritje vjetore prej 3.9 për qind gjatë gjysmës së parë të vitit. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik mbështetet në një gamë të gjerë faktorësh dhe është prezent në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Rritja e besimit të biznesit, veçanërisht në sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit, përmirësimi i ekonomive partnere, si dhe politikat mbështetëse fiskale e monetare, kanë sjellë rritje të konsumit të familjeve, të investimeve publike e private, si dhe të eksporteve. Nga këto zhvillime kanë përfituar si sektori prodhues dhe ai i shërbimeve, duke ofruar rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin dhe duke krijuar premisa të mira për perspektivën afat-mesme.

Sipas optikës së kërkesës agregate, bazuar në vlerësimet e deritanishme, rritja përgjatë gjysmës së parë të vitit 2024 duket të jetë gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet, si dhe nga ecuria mjaft e mirë e eksporteve të shërbimeve, në pasqyrim të një sezoni turistik mjaft pozitiv. Në këtë kontekst, konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, për gjysmën e parë të vitit 2024 shënoi rritje prej 5.23 për qind, ndërsa konsumi privat shënoi rritje prej 5.26 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale), pas një rritjeje me rreth 1.04 për qind në terma real vjetor përgjatë vitit 2023, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 shënoi rritje më të fortë prej 3.72 për qind.

Të dhënat e tregtisë së mallrave në terma nominal për periudhën tetë-mujore, tregojnë për një rënie të eksporteve me -14.9 për qind krahasuar me një vit më parë. Ndërsa importet e mallrave shënuan rritje prej +3.1 për qind krahasuar me një vit më parë. Kjo ecuri është reflektuar në zgjerim të deficitit tregtar në masën +22.5 për qind për këtë periudhë tetë-mujore. Efekti i çmimeve në rënie, i kombinuar me atë të kursit të mbiçmuar të këmbimit, vijon të jetë një faktor i konsiderueshëm i kësaj ecurie. Norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë periudhë është 43.0 për qind.

Në anën e ofertës agregate, kontribut pozitiv në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 dhanë disa degë, konkretisht: “*Ndërtimi*” me rritje prej 9.23 për qind dhe kontribut prej +1.13 pikë përqindje, “*Aktivitetet*

profesionale dhe Shërbime administrative” me rritje prej 10.28 dhe kontribut prej +0.66 pikë përqindje. *“Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia”* me rritje prej 9.21 përqind dhe kontribut prej +1.1 pikë përqindje, *“Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor”* me rritje 6.08 dhe kontribut prej +0.9 pikë përqindje”, etj. Negativisht kontribuoi grupi *“Industria nxjerrëse, përpunuese; Energjia elektrike”* me rënie prej -8.41 për qind dhe kontribut prej -0.91 pikë përqindjeje, si dhe *“Informacioni dhe komunikimi”* me rënie prej 2.91 përqind dhe kontribut prej -0.07 pikë përqindje. Ndërsa sektori i *“Bujqësisë, pyjet dhe peshkimi”* rezultoi me një rënie marxhinale prej 0.03% dhe një kontribut thuajse neutral prej 0.01 pikë përqindje.

Gjithashtu edhe zhvillimet në tregun e punës deri më tani kanë qenë pozitive. Punësimi gjatë vitit 2023 është rritur mesatarisht me 1.6 për qind në vit, mbështetur kryesisht nga punësimi më i lartë në sektorin e shërbimeve. Nga pikëpamja e ofertës, rritja e punësimit mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së qëndrueshme të normave të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe normës së punësimit, duke arritur përkatësisht 75.1 për qind dhe 66.7 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2023 (krahasuar me me respektivisht 74.8 për qind dhe 66.5 përqind në T4-2022). Evidencat tregojnë se ka një interes të përgjithshëm në rritje për të hyrë në fuqinë punëtore, nxitur nga trendi rritës i pagave, duke intensifikuar kështu tendencat pozitive në ofertën e punës. Në të njëjtën kohë, shkalla e papunësisë vijoi trendin rënës të viteve të fundit dhe është ulur deri në 10.7 për qind në tremujorin e katërt 2023, nga 11 përqind në fund të vitit të kaluar (për moshën 15 vjeç e lart). Kjo paraqet shifrën më të ulët të papunësisë të regjistruar historikisht.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë, një tjetër fundament tejet i rëndësishëm dhe tipikisht vulnerabël përballë goditjeve të tilla, mbeti relativisht solid, përtej pritshmërive fillestare për impaktin që mund të kishte ky fundament i ekonomisë prej goditjes së pandemisë dhe goditjes në ofertën globale të mallrave kryesorë dhe implikimeve negative zinxhir që mund të shkaktonte në fundamente të tjerë. Në vitin 2023 bilanci i pagesave u mbyll me një suficit prej rreth 4.4 për qind të PBB-së. Ndërkohë, në gjysmën e parë të vitit 2024, deficiti i llogarisë korrente shënon 575 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 198 milionë euro ose rreth 52.5 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e dytë të 2023, deficiti i llogarisë korrente shënon 216 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 17 milionë euro (ose 7.5 për qind), në sfondin e zgjerimit të suficitit tregtar në shërbime. Suficiti tregtar në shërbime u zgjerua ndjeshëm në kategoritë shërbime udhëtimi, shërbime transporti dhe shërbime biznesi.

Në gjysmën e parë të vitit 2024, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me *“Turizmin”* shënuan rritje prej +25.4 për qind, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2023. Gjithashtu për këtë periudhë, edhe *“Remitanca”* shënuan rritje prej +15.0 për qind. Këto zhvillime sëbashku me zgjerimin e të ardhurave dytësore dhe ngushtimin e balancës negative të të ardhurave parësore ndikuan pozitivisht ecurinë e deficitit korrent, duke kompensuar thellimin e deficitit tregtar në mallra.

Në gjysmën e parë të vitit 2024, *“Investimet e Huaja Direkte”* shënuan vlerën +749 milionë euro ose +7.9 për qind, krahasuar me +694 milionë euro në gjashtëmujorin e parë 2023. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e dytë të 2023, IHD regjistruan vlerën +395 milionë euro ose +3.4 për qind, krahasuar me +382 milionë euro në tremujorin e dytë të 2023. Këtë gjashtëmujor, flukset valutore hyrëse në formën e investimeve të huaja direkte ishin të përqendruara kryesisht në pasuri të paluajtshme (në masën 24 përqind), sektorin e ndërmjetësimit financiar (në masën 18 për qind), e hidrokarbureve (në masën 13 përqind), e energjitikës (në masën 9 përqind), si dhe komunikacionit (në masën 5 përqind).

Stoku i rezervës valutore, në fund të qershorit 2024 shënoi 5,518 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.4 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.

Këto zhvillime në pozicionin e jashtëm të ekonomisë dhe performancës relativisht mjaft të mirë të ekonomisë në tërësi janë reflektuar edhe në fundamentin tjetër mjaft të rëndësishëm dhe një ndër ekuilibrat agregat kyç të ekonomisë, atë të kursit të këmbimit. Në 5 vitet e fundit, kursi i këmbimit ka ndjekur një trajektore mbiçmuese, e nxitur nga rritja e flukseve hyrëse në turizëm, remitancave dhe investimeve të huaja direkte. Të gjithë këta faktorë të kombinuar me rritjen e produktivitetit, goditjet pozitive të kërkesës së jashtme në sektorin e shërbimeve dhe zvogëlimin e primeve të rrezikut kanë çuar në një tendencë përmirësimi të deficitit të llogarisë korente e rrjeshimisht në tendencë forcuese të Lekut kundrejt monedhave kryesore, veçanërisht kundrejt euros që përfaqëson valutën kryesore të shkëmbimeve tregtare. Shpejtësia e mbiçmimit ka qenë në zbutje gjatë vitit 2024.

Kursi mesatar Lek/Euro për periudhën janar-shtator 2024 ishte 101.5 nga 110.3 që ishte mesatarisht gjatë të njëjtës periudhë të 2023. Ndërsa kursi mesatar Lek/USD për janar-shtator 2024 ishte 93.4 nga 101.9 që ishte mesatarisht gjatë të njëjtës periudhë të 2023.

Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një fundament tjetër i fortë i ekonomisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen duke shënuar në fund të muajit korrik 2024 nivelin prej rreth 4.7 për qind nga rreth 8 për qind që shënonin rreth tre vite më parë. Stoku total i kredive bankare në muajin gusht 2024, pati një rritje me 12.1 për qind krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2023. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 17.8 për qind, ndërsa ai në valutë rritje prej 5.2 për qind, krahasuar me një vit më parë. Kreditimi i sektorit privat të ekonomisë ka pësuar rritje, si për kreditë ndaj bizneseve dhe ndaj konsumatorëve, deri në fund të muajit gusht 2024, ku janë regjistruar rritje respektivisht prej 12.6 për qind dhe 11.5 për qind kundrejt një viti më parë.

Sa i përket depozitave, referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit gusht të vitit 2024 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rritje me 3.7 për qind krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2023. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 9.8 për qind, ndërsa ai në valutë është ulur me 0.8 për qind. Në gusht 2024 rezultoi se rreth 44.6 për qind e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 55.4 për qind përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj.

Inflacioni filloi të ngadalësohej me shpejtësi në janar 2024, duke lëvizur nga 4.0 përqind në dhjetor 2023 në 3.4 për qind dhe ra nën objektiv për herë të parë në muajin shkurt 2024. Trajektorja e mëvonshme reflektoi kryesisht një ulje të çmimeve të mallrave ushqimore në tregjet ndërkombëtare, efekti i të cilit në inflacionin e ushqimeve shqiptare përforcohet nga një peshë relativisht e madhe që kanë këto mallra në shportën e IÇK-së. Një mbiçmim i shpejtë i kursit të këmbimit shkaktoi një efekt shtesë në rënie në inflacionin total, nëpërmjet rënies së çmimeve të importit. Inflacioni total ka qenë mesatarisht 2.1 për qind që nga prilli 2024. Sa i përket të dhënave më të fundit të disponueshme, në muajin shtator 2024 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 1.9 për qind, ndërsa një vit më parë ky ndryshim ishte 4.0 për qind. Inflacioni mesatar për nëntë-mujorin e parë të 2024 është 2.3 për qind.

1.2 KRAHASIMI ME VENDET E RAJONIT

Bazuar në raportet dhe analizat e institucioneve ndërkombëtare, PBB në ekonominë e rajonit të Ballkanit Perëndimor ka vijuar të rritet, pavarësisht pasojave nga lufta në Ukrainë, rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, kushteve të pafavorshme të motit, shtrëngimit të kushteve financiare dhe pasigurive të konsiderueshme. Në tremujorin e parë të vitit 2024, PBB-ja e rajonit u përshpejtua në 3.9% në terma

vjetorë, nga 3.2% që rezultonte në tremujorin paraardhës. Rritja e PBB-së u përshpejtua më së shumti në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi.

Rritja në përgjithësi u ndikua nga kërkesa e brendshme. Shpenzimet konsumatore mbetën një kontribues kryesor në rritjen e prodhimit për tremujorin e parë të vitit 2024. Konsumi i familjeve u mbështet nga rritja e vazhdueshme e pagave nominale në të gjithë rajonin, e cila u përkthye në rritje të konsiderueshme të pagave reale në kushtet e një inflacioni më të ulët. Investimet u rritën ndjeshëm në pothuajse të gjitha ekonomitë, veçanërisht në Maqedoninë e Veriut.

Në tremujorin e parë të vitit 2024, shkalla e papunësisë ra në shumicën e ekonomive të rajonit, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në përputhje me përshpejtimin e aktivitetit ekonomik, punësimi mesatar vjetor në Ballkanin Perëndimor u rrit ndjeshëm në 2.5%, ndërkohë që edhe pjesëmarrja e fuqisë punëtore pati rritje. Në përgjithësi, normat e papunësisë në rajon mbetën në nivelet më të ulëta historike, por krahasimisht më të larta me vendet e BE-së, duke filluar nga 9.4% në Serbi, në 13.5% në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Deficiti i përgjithshëm i llogarisë korrente të rajonit u zgjerua në 3.6% të PBB-së në muajin mars 2024, nga 2.8% që rezultonte gjatë vitit 2023, por ende mbetet i ulët krahasuar me të dhënat historike. Ky përkeqësim erdhi si pasojë e zgjerimit të deficiteve tregtare të mallrave, reduktimit të suficiteve të të ardhurave dytësore (kryesisht remitanca) dhe në disa raste edhe nga rënia e suficiteve tregtare të shërbimeve në raport me PBB-në. Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte si përqindje e PBB-së kanë qenë të qëndrueshme dhe janë rritur në shumicën e vendeve të rajonit, ndërkohë që kanë vazhduar të mbulojnë pjesën më të madhe të deficitit të llogarisë korrente. Ndërkohë, rezervat valutore mbetën përgjithësisht stabël, duke shënuar rritje vetëm në Serbi.

Për tremujorin e parë të vitit 2024, inflacioni mesatar vjetor në rajon u ngadalësua më tej, në 4.1%. Rënia e normave të inflacionit brenda intervalit të objektivit u mundësoi bankave qendrore në Shqipëri dhe Serbi të fillojnë lehtësimin gradual të politikës monetare.

Zgjerimi i vazhdueshëm ekonomik mbështeti rritjen e të ardhurave buxhetore dhe balancat fiskale u përmirësuan pothuajse në të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor për pesë muajt e parë të vitit 2024, me përjashtim të Maqedonisë së Veriut. Për tremujorin e parë të vitit 2024, raporti i borxhit publik ndaj PBB-së u ul në shumicën e ekonomive të rajonit, krahasuar me fundin e vitit 2023, pjesërisht për shkak të rritjes së fortë nominale të PBB-së. Ulja e barrës së borxhit ishte më e theksuar në Serbi dhe Shqipëri. Raporti i borxhit publik mbeti më i larti në Mal të Zi, me 66.4% të PBB-së, i ndjekur nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, respektivisht me 55.8% dhe 50.4% të PBB-së.

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë shfaqur qëndrueshmëri në vitet e fundit. Megjithatë, ato e kanë patur të vështirë të shndërrohen në motorë të rritjes ekonomike, jo vetëm për shkak të efekteve të sfidave strukturore dhe demografike, por edhe për shkak të çënueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike. Investimet në ekonominë e gjelbër mund të jenë një mundësi e mirë për t'i dhënë shtysë rritjes në të ardhmen dhe për të adresuar sfidat kryesore strukturore.

Tabela 1 : Produkti i Brendshëm Bruto (rritja vjetore në %, në terma realë)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024*
	<i>Rritja reale ekonomike, në %</i>					
Shqipëria	2.1	-3.3	8.9	4.8	3.9	3.9
Bosnja dhe Hercegovina	2.3	-2.9	7.3	3.8	1.6	2.3
Kosova	4.8	-5.3	10.7	4.3	3.3	n.a

Maqedonia e Veriut	3.9	-4.7	4.5	2.2	1.0	2.9
Mal i Zi	4.1	-15.3	13.0	6.4	6.0	3.4
Serbia	4.3	-0.9	7.7	2.5	2.5	3.5
Mesatarja e rajonit	3.6	-5.4	8.7	4.0	2.9	n.a

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), Ministria e Financave (2024)

Në Mars 2024, deficitit i përgjithshëm i llogarisë korrente për rajonin u zgjerua në 3.6% të PBB-së, nga 2.8% që rezultoi në vitin 2023, por mbeti ende i ulët krahasuar me të dhënat historike. Përkeqësimi i deficitit të llogarisë korrente u ndikua kryesisht nga zgjerimi i deficiteve tregtare të mallrave, reduktimit të suficiteve të të ardhurave dytësore (kryesisht remitançave) dhe në disa raste edhe nga rënia e suficiteve tregtare të shërbimeve.

Tabela 2: Balanca Korrente (% të PBB)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024*
<i>Balanca e llogarisë korrente, (në % ndaj PBB)</i>						
Shqipëria	-7.9	-8.7	-7.6	-5.9	-1.2	-4.1
Bosnja dhe Hercegovina	-2.6	-2.8	-1.8	-4.3	-2.7	-2.8
Kosova	-5.7	-7.0	-8.7	-10.3	-7.6	n.a
Maqedonia	-3.0	-2.9	-2.8	-6.1	0.7	-1.0
Mal i Zi	-14.3	-26.1	-9.2	-12.9	-11.6	-10.3
Serbia	-6.9	-4.1	-4.2	-6.9	-2.6	-3.6
Mesatarja e rajonit	-6.7	-8.6	-5.7	-7.7	-4.1	n.a

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), Ministria e Financave (2024)

Tabela 3: Bilanci tregtar i mallrave (% të PBB)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024*
<i>Balanca tregtare (në % ndaj PBB)</i>						
Shqipëria	-22.9	-22.4	-25.1	-23.6	-20.7	22.7
Bosnja dhe Hercegovina	-22.3	-18.0	-18.3	-22.3	-20.8	n.a
Kosova	-40.3	-38.0	-44.8	-48.2	-47.6	n.a
Maqedonia	-17.3	-16.6	-19.7	-26.7	-18.9	-19.7
Mal i Zi	-41.7	-39.2	-38.7	-45.1	-43.6	-40.1
Serbia	-12.2	-11.1	-11.3	-15.5	-9.5	-8.2
Mesatarja e rajonit	-26.1	-24.2	-26.4	-30.3	-27.0	n.a

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), Ministria e Financave (2024)

Në përgjithësi, shkalla e papunësisë në rajon ra në shumicën e ekonomive, duke filluar nga 9.4% në Serbi, në rreth 13.5% në Bosnjë Hercegovinë. Normat e papunësisë në rajon shënuan nivelet më të ulëta historike, por mbetën akoma të larta në krahasim me vendet e BE-së.

Tabela 4: Norma e papunësisë (në %)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024*
Shqipëria	12.0	12.2	12.0	11.3	11.2	10.2
Bosnia dhe Hercegovina	15.7	15.9	17.4	15.4	13.2	n.a
Kosova	25.7	25.9	20.7	12.6	n.a	n.a
Maqedonia e Veriut	17.5	16.6	15.6	14.5	13.2	12.9
Mal i Zi	15.4	18.4	16.9	15.1	13.4	11.8
Serbia	11.2	9.7	11.0	9.5	9.4	9.3
Mesatarja e rajonit	16.3	16.5	15.6	13.1	n.a	n.a

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), Ministria e Financave (2024)

Në pesë muajt e parë të vitit 2024, zgjerimi i vazhdueshëm ekonomik mbështeti rritjen e të ardhurave buxhetore dhe balancat fiskale u përmirësuan pothuajse në të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. Ndërkohë, për tremujorin e parë të 2024, raporti i borxhit publik ndaj PBB-së u ul në të gjitha vendet e rajonit, krahasuar me fundin e vitit 2023, pjesërisht për shkak të rritjes së fortë të PBB-së nominale.

Tabela 5: Balanca e përgjithshme e qeverisë (Deficiti fiskal në % të PBB)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024*
	<i>Balanca fiskale, (në % ndaj PBB)</i>					
Shqipëria	-1.9	-6.7	-4.6	-3.7	-1.3	-2.3
Bosnja dhe Hercegovina	1.9	-5.2	-0.3	-0.4	n.a	-1.5
Kosova	-2.9	-7.6	-1.2	-0.5	-0.2	-2.9
Maqedonia	-2.0	-8.0	-5.3	-4.4	-4.9	-3.7
Mal i Zi	-2.0	-11.1	-1.9	-4.2	0.6	-3.7
Serbia	-0.2	-8.0	-4.1	-3.2	-2.2	-2.2
Mesatarja e rajonit	-1.2	-7.8	-2.9	-2.7	n.a	-2.8

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), Ministria e Financave (2024)

Tabela 6: Borxhi publik total (% të PBB)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024*
	<i>Borxhi publik dhe i garantuar (në % ndaj PBB)</i>					
Shqipëria	65.0	73.9	74.1	64.1	57.5	56.3
Bosnja dhe Hercegovina	32.3	36.1	33.9	29.3	26.9	29.3
Kosova	17.6	22.4	21.5	20.0	17.5	n.a
Maqedonia	40.5	50.8	51.4	50.5	53.1	54.6
Mal i Zi	76.5	105.3	82.5	68.0	59.3	61.7
Serbia	52.0	57.0	56.5	55.2	52.0	51.4
Mesatarja e rajonit	47.4	57.7	53.4	47.9	41.8	n.a

Burimi: Komisionit Evropian (DG-ECFIN), Ministria e Financave (2024)

1.3 PARASHIKIMET AFATMESME 2025-2027

Ekonomia e vendit parashikohet të zgjerohet me rreth 3.9 për qind në vitin 2024, e mbështetur nga kushtet e favorshme ekonomike, veçanërisht nga ecuria mjaft e mirë e sektorit të turizmit dhe aktivitetit të ndërtimit. Gjatë periudhës afatmesme 2025-2027, rritja parashikohet të vijojë trendin pozitiv me mesatarisht në nivelin 3.9 për qind në vit, ndikuar nga zhvillimet e ekonomisë së brendshme dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian. Aktiviteti ekonomik do të vazhdojë të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, nga rritja e mëtejshme e konsumit privat, ashtu edhe nga investimet në infrastrukturë si dhe zhvillimi i sektorëve strategjikë si turizmi.

Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, veçanërisht pas rikthimit të inflacionit në nivelet normale, i cili po materializohet tashmë brenda vitit 2024. Qëndrueshmëria në nivelin e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përsheptimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi sërish i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies gradualisht përgjatë afatit të mesëm, pasi të shuhet plotësisht

efektet shtrënguese të shkaktuara nga vala aktuale inflacioniste, priten të jenë faktorë të rëndësishëm i investimeve private.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2025-2027) parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 2.8 për qind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.3 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real me rreth 5.3 për qind në vitet 2025-2027, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.4 pikë përqindje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten gjithashtu të kenë performancë pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2025-2027 parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 5.1 për qind në vit në terma real, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 1.9 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 3.6 për qind në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB me rreth 1.6 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen totale të PBB me mesatarisht rreth 0.3 pikë përqindje në vit.

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten me trende të përafërta të mesatares së tyre historike. Specifikisht, “Industria” me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.2 për qind në vit në terma real përgjatë periudhës 2025-2027 dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.5 pikë përqindje; “Ndërtimi” me rritje mesatare vjetore prej rreth 3.2 për qind dhe kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.4 pikë përqindje; “Shërbimet” me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.0 për qind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.4 pikë përqindje, “Bujqësia” pritet të rritet mesatarisht me rreth 0.2 për qind, duke qenë neutrale sa i takon kontributit në rritjen ekonomike.

Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
						Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.5	2.5	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4
Inflacioni (mesatar)	%	1.6	2.0	6.7	4.8	2.3	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	0.0	3.4	9.9	6.1	1.3	1.2	1.2	1.2
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	108.6	103.5	113.0	100.6	100.6	100.6	100.6	100.6
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	123.8	122.5	119.0	108.8	108.8	108.8	108.8	108.8
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit te Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	41.3	42.5	41.5	41.5	41.0	40.8	40.5	40.3
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit te Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	65.0	66.6	65.5	65.4	65.9	66.4	66.8	67.1
Rritja reale e PBB	%	-3.3	9.0	4.8	3.9	3.9	3.9	4.0	3.9
PBB	Lek miliardë	1,656.0	1,866.7	2,149.7	2,369.9	2,494.2	2,620.7	2,756.7	2,898.1
PBB	USD miliardë	15.2	18.0	19.0	23.5	24.8	26.0	27.4	28.8
PBB	Euro miliard	13.4	15.2	18.1	21.8	22.9	24.1	25.3	26.6
PBB për banor	Lek mijë	655.1	750.9	879.6	986.6	1,041.6	1,098.3	1,159.9	1,224.8
PBB për banor	USD	6,029.4	7,253.6	7,781.1	9,802.7	10,349.3	10,912.8	11,524.5	12,169.7
PBB për banor	Euro	5,292.9	6,131.7	7,392.7	9,067.9	9,573.6	10,094.9	10,660.7	11,257.5
PBB për banor	USD-PPP	15,870.5	17,667.2	21,219.5	23,800.2	25,379.3	26,949.6	28,640.8	30,377.6
PBB për banor	Euro-PPP (EU=27)	10,071.2	11,279.6	13,423.6	15,075.9	15,798.2	16,542.1	17,368.6	18,251.7
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	%	12.2	12.0	11.3	11.2	10.2	9.8	9.5	9.3
Të ardhurat totale	% të PBB	25.7	27.4	26.6	27.2	28.6	28.8	28.8	29.2
Shpenzimet totale	% të PBB	32.4	31.9	30.3	28.5	30.9	31.4	30.8	30.6
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-6.7	-4.6	-3.6	-1.3	-2.3	-2.6	-2.0	-1.4
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-4.6	-2.7	-1.8	0.7	0.3	0.0	0.6	1.2
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	-0.5	2.3	1.6	3.7	3.7	3.5	4.1	4.6
Borxhi publik NETO nga qendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	73.5	70.2	63.5	55.5	54.4	54.4	53.9	52.7
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	73.9	74.1	64.1	57.5	56.3	55.8	55.0	54.1
<i>Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme</i>	% të PBB	71.0	71.1	61.7	55.8	54.8	54.4	53.5	52.5
<i>Borxhi publik jashtë treguesve fiskale</i>	% të PBB	3.0	3.0	2.4	1.7	1.5	1.4	1.5	1.5
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-8.6	-7.7	-5.9	-0.9	-4.1	-3.8	-3.3	-3.7
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-14.4	-13.3	-10.3	-5.1	-7.9	-7.1	-6.3	-6.3
Mallra	% të PBB	-22.3	-25.1	-23.6	-20.8	-22.7	-22.7	-22.1	-22.2
Eksporte	% të PBB	5.9	8.3	10.7	8.4	8.6	8.6	8.7	8.9
Importe	% të PBB	-28.2	-33.4	-34.3	-29.3	-31.3	-31.3	-30.9	-31.1
Bilanci i pagesave	% të PBB	4.9	6.1	-0.4	4.3	2.2	1.9	2.0	1.0
Rezervat valutore	Euro milion	3,942.4	4,972.2	4,952.1	5,888.9	6,389.5	6,845.8	7,358.7	7,633.7
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	9.6	8.8	6.9	7.4	7.3	7.5	7.7	7.6

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore, Eurostat

2. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2025

2.1 PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2025

Programimi i të ardhurave të buxhetit për vitin 2025 mbështet objektivat e Ministrisë së Financave për rritjen e të ardhurave, dhe kryesisht atyre që gjenerohen nga sistemi tatimor, me qëllim mbështetjen e shpenzimeve publike për arsimin, shëndetësinë, mbrojtjen sociale, rritjen e pagave e pensioneve, investimeve në infrastrukturë, bujqësi, energji dhe drejtime të tjera të cilat gjenerojnë zhvillim dhe të ardhura. Njëkohësisht, programimi i drejtë i të ardhurave synon të mbështesë planifikimin e niveleve të duhura të defiçitit buxhetor, atij primar, si dhe mbajtjen nën kontroll dhe reduktimin gradual të borxhit publik.

Ky program bazohet në përmirësimin e politikave tatimore dhe administrimit fiskal, duke zgjeruar bazën e tatimit dhe minimizuar informalitetin në ekonominë e vendit. Programi i të ardhurave merr në konsideratë gjithashtu faktorët që mund të impaktojnë zhvillimet ekonomike në vitin 2025 përfshirë edhe risqet e mundshme që mund të shfaqen (inflacioni, kursi i këmbimit të monedhave dhe ndikimi i tyre mbi importet dhe eksportet, çmimet, investimet, energjia elektrike etj.).

Në programimin e të ardhurave nga tatimet dhe doganat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2025, janë marrë në konsideratë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet, përfshirë efektin e pritshëm të rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve mbi këto të ardhura, politikat e reja fiskale si dhe efektet e përmirësimit të administrimit tatimor e doganor, përfshirë luftën ndaj informalitet, me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin.

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet e njohura të projeksionit, dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë, tatim apo kontribut. Modeli i përdorur bazohet në parashikimet makroekonomike për periudhën 2025–2027 e në vijim në lidhje me rritjen ekonomike nominale të projektuar, indeksin e çmimeve të parashikuar, lëvizjet e mundshme të kursit të këmbimit të monedhave, fluksin e pritshëm dhe analizën e importeve të grup produkteve kryesore, si dhe analizat e serive kohore për çdo taksë. Parashikimet e të ardhurave marrin në konsideratë gjithashtu edhe efektet e politikave fiskale që do implementohen, si dhe efektet e projektuara për rritjen e të ardhurave bazuar në masat dhe aktivitetet që do zbatohen në kuadrin e përmirësimit të administrimit tatimor dhe doganor.

Në planifikimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë të ardhurat e pritshme të vitit 2024, faktorët që kanë ndikuar mbi këto të ardhura të pritshme dhe shkaqet e deviacioneve nga programimi fillestar, si dhe janë harmonizuar faktorët e pritshëm makroekonomikë, me treguesit kryesorë që mund të ndikojnë mbi taksa dhe tatime specifike. Janë analizuar sasisht dhe çmimet e mallrave kryesorë të importit që gjenerojnë deri në 90% të vlerës së të ardhurave totale, si dhe tendenca e ecurisë së tyre të pritshme për vitin në vijim. Treguesit kryesorë për projektimin e të ardhurave përfshijnë:

- Rritjen ekonomike nominale të PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Rritja ekonomike e projektuar është llogaritur që të impaktojë zërat e tatimeve, taksave dhe kontributeve, duke aplikuar koeficientin e elasticitetit si tregues i reflektimit të rritjes ekonomike mbi të ardhurat e buxhetit;
- Indeksi i projektuar i çmimeve, i cili është reflektuar në ato zëra tatimesh që llogariten sipas metodës ad valorem;
- Kursin e pritshëm të vlerësuar të këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe Euro me lekun, me qëllim llogaritjen e bazës së llogaritjes së detyrimeve tatimore për mallrat e importit dhe eksportit;
- Çmimet në bursë të mallrave me peshë si karburantet, energjia, mineralet, etj. të cilat kanë ndikim të ndjeshëm në të ardhurat e buxhetit;
- Vlerësimet mbi bazën e analizave të sasive të pritshme të importit dhe eksportit të mallrave.

Në vitin 2025, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 754,650 milionë lek, nga këto, të ardhurat tatimore 709,854 milionë lekë dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mbliidhen nga tatimet dhe doganat 499,187 milionë lekë. Ndërkohë, të ardhurat nga kontributet për sigurimin shoqëror dhe sigurimin shëndetësor, planifikohen të jenë 168,989 milionë lek.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat dhe të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë projektuar bazuar në analizën e trendit historik shumëvjeçar të tyre, realizimit të pritshëm në vitin 2024 dhe faktorizimit të të gjithë elementeve që do ndikojnë në të ardhurat e vitit 2025

përfshirë efektet nga: rritja ekonomike, indeksi i çmimeve, politikat e reja fiskale, si dhe të ardhurat shtesë nga mirëadministrimi.

Ky parashikim është analizuar dhe korrigjuar me efektet e mundshme të faktorëve të tjerë relevantë përfshirë koeficientin e elasticitetit, tipologjinë e çdo lloji takse e tatimi, etj.

Faktorët që janë marrë në konsideratë, të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2025 përfshijnë:

- Kuadrin makroekonomik për vitin 2025 ku është parashikuar rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto prej 3.9%, dhe indeksi i çmimeve 3%. Këta tregues janë analizuar të kenë efekte në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si tatimi mbi vlerën e shtuar, renta minerare dhe taksa doganore. Në projeksion janë përfshirë, faktorë që lidhen edhe me kursin mesatar të pritshëm të këmbimit EUR/ALL dhe USD/ALL, si dhe çmimet e vlerësuara të bursës për mineralet, nënproduktet e naftës etj.
- Paketa fiskale 2025, me propozime të cilat gjenerojnë të ardhura shtesë në zërin e Akcizës dhe nga Taksat nacionale.
- Të ardhurat që do të gjenerohen në formën e të ardhurave nga tatimi mbi pagën dhe kontributet si rezultat i zbatimit nga qeveria të reformës në fushën e pagave në 1 korrik 2024 dhe që do ketë efekt në muajt e parë të vitit 2025.
- Të ardhurat e projektuara që do gjenerohen nga përmirësimi në administrimin e tatimeve, taksave dhe detyrimeve të kontributeve, hapa të cilat janë parashikuar edhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, 2024-2027.

Baza e programimit të të ardhurave për vitin 2024 janë të ardhurat sipas aktit normativ nr.3, datë 28.8.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar.

Tabela 7. Projeksioni i të ardhurave nga Tatimet dhe Doganat dhe Kontribute

(në milionë lekë)

Projeksioni i të Ardhurave nga tatimet dhe doganat dhe të Ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore Viti 2025		
1	Baza e programimit	617,679
2	One -Off	(2,458)
3	Baza -One Off	615,221
4	Të ardhura shtesë nga rritja ekonomike (Rritja nominale 3.9 % * koeficient elasticiteti) =2.73%	14,863
5	Të ardhura shtesë nga indeksimi i çmimeve (3 % x TVSH dhe TD) *70%=2.1%	5,394
6	Të ardhura shtesë nga masat e reja fiskale (ndryshim politikash tatimore dhe buxhetore)	9,150
7	MirëAdministrimi -Draft SAA (0.54% e PBB-së)	15,163
8	Të tjera	8,384
9	Shuma e Faktorëve (4-8)	52,954

10	Projeksion 2025 (3+9)	668,175
11	Rritja e të ardhurave 2025 krahasuar me 2024	8.18%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Tabela 8: Treguesit makroekonomikë 2025

(në milionë lekë)

1	PBB 2025	2,620,732
2	Rritja ekonomike reale	3,9%
3	Koeficienti i elasticitetit (KE)	70%
4	Rritja e të ardhurave nga rritja ekonomike 3,8% x 70%	2,73%
5	Inflacioni	3%
	Rritja e të ardhurave nga indeksi i çmimeve 3% x 70%	2,1%
6	Efektet e paketës fiskale.	9,150
7	Efektet nga mirëadministrimi 0,54% e PBB-se dhe të tjera	23,547

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Parashikimi i të ardhurave sipas zërave për vitin 2025

Të ardhurat nga “T.V.SH-ja” parashikohet të jetë rreth 236,040 milionë lek, ose 22,235 milionë lekë ose 10.4% më shumë se pritshmëria e vitit 2024. Burimet e rritjes së TVSH-së në vitin 2025 përfshijnë:

- Rritjen e të ardhurave nga TVSH që gjeneron rritja ekonomike shtesë dhe indeksi i çmimeve, rritja e importeve;
- Përmirësimin e administrimit të TVSH-së nga sistemi i fiskalizimit dhe konsolidimi i faturimit elektronik duke përfshirë dhe efektet e draft Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Plani i Veprimit, 2024-2027 për vitin 2025;
- Fokusimi për rritjen e të ardhurave nga sektorë si turizmi, akomodimi, ndërtimi dhe gjithë sektorët e tjerë ekonomik;

Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin Korporativ” programohen të jenë +6 miliardë lek ose +10.1% më shumë krahasuar me të pritshmin e vitit 2024. Parashikimi i tatimit mbi fitimin korporativ për vitin 2025 bazohet në:

- Të ardhura nga mirëadministrimi dhe të ardhura shtesë nga draft Strategjia Afatmesme e të Ardhurave për vitin 2025.
- Forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut.

Të ardhurat nga “Akciza” programohen 66,984 milionë lekë lek, + 2.6 miliardë lekë ose +4.1% më shumë se i pritshmi i vitit 2024. Faktorët kryesorë në parashikimin e të ardhurave nga akciza lidhen me:

- Rritjen e të ardhurave nga akciza që gjeneron rritja ekonomike shtesë; rritjen e sasive të importit dhe konsumi i mallrave si karburante, cigare, pije alkoolike, verë, birra etj;
- Rritja e nivelit të akcizave për shkak të zbatimit të kalendarit të rritjes së niveleve të akcizës për duhanet;

Të ardhurat nga “Tatimi mbi të Ardhurat Personale” parashikohen 70,040 milionë lekë, me rritje prej +5,6 miliardë lekë ose +8.7% më shumë se pritshmëritë për vitin 2024. Baza e të ardhurave për vitin 2024 është ulur me rreth 500 milionë lekë (one off), e cila ka qënë e ardhura nga tatimi mbi fitimin e

profesioneve të lira. Mbi këtë bazë, në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë:

- Rritja e të ardhurave që gjeneron rritja ekonomike;
- Efektet e reformës së pagave në sektorin shtetëror që filloi në 1 korrik 2024, rritja e të cilave do gjenerojë të ardhura shtesë nga tatimi mbi pagat për 7 muajt e parë të vitit 2025;
- Rritja e numrit të punëmarrësve dhe pagës mesatare në sektorin privat, i cili për shkak të lëvizjeve është i detyruar të ndjekë rritimin e rritjes së pagave në sektorin shtetëror;
- Rritja e të ardhurave nga miradministrimi nga zbatimi i masave nën draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave për vitin 2025.

Të ardhurat nga “Taksa Nacionale dhe të tjera” programohen në nivelin 49,296 milionë lek. Baza e të ardhurave për vitin 2024 është ulur me rreth 1,9 miliardë lekë (one off) e cila ka qënë e ardhura nga disa taksa kombëtare që janë mblidhur dhe arkëtuar nga administrata doganore në rolin e agjentit tatimor, por klasifikimi në kontabilitet si të ardhura të tilla tek administrata tatimore u bë muajit gusht 2024. Mbi këtë bazë, në parashikimet për këtë taksë për vitin 2025 janë +3.7% ose +1.7 miliardë lekë më shumë se i pritshmi 2024, efekte që pritet të vijnë nga rritja ekonomike në tërësi, taksat e reja të liçensimit të lojrave të fatit, rritja e konsumit të karburanteve që gjeneron taksat e qarkullimit dhe karbonit etj.

Të ardhurat nga “Taksa Doganore” në vitin 2025 programohet 11,078 milionë lekë, me rritje +1.75 miliardë lekë ose 18.8% më shumë se i pritshmi për vitin 2024. Në programimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë efektet e rritjes ekonomike dhe indeksimi si dhe efektet e rritjes së importeve të tatueshme nga vendet jashtë BE-së.

Të ardhurat gjithsej nga “Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore” janë programuar të jenë 168,989 milionë lekë, në rritje krahasuar me vitin 2024 prej + 10.53 miliardë lekë, ose +6.6%.

Rritja e programuar e të ardhurave mbështetet në këta faktorë:

- rritjen ekonomike të projektuar me efekt në punësim dhe kontribute;
- efekteve nga rritja e pagave dhe kontributeve si rezultat i zbatimit të reformës së pagave në administratë;
- forcimit të kontrollit të punës në të zezë, nivelit të pagës të deklaruar dhe deviacionit të saj nga paga reale që përfitohet;
- Të ardhura nga miradministrimi dhe efektet e draft Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave për vitin 2025.

Tabela 9: Tabela e të ardhurave të planifikuara (në milionë lekë)

Lloji i taksave	I Pritshmi 2024	Projeksion i 2025	Ndryshim i 2025/2024 në vlerë	Ndryshimi 2025/2024 në %
TVSH Neto (import+brenda vendit)	213,805	236,040	22,235	10.4%
Tatimi mbi fitimin	59,719	65,749	6,030	10.1%
Akciza	64,375	66,984	2,609	4.1%
Tatimi mbi të ardhurat personale	64,438	70,040	5,602	8.7%
Taksat Nacionale	47,555	49,296	1,741	3.7%
Taksë doganore	9,328	11,078	1,750	18.8%

Total të Ardhura nga Tatimet dhe Doganat	459,221	499,187	39,966	8.7%
Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	158,458	168,989	10,531	6.6%
Total të Ardhurat nga Tatimet dhe Doganat dhe Kontributet	617,679	668,175	50,496	8.2%

2.2 SHPENZIMET PUBLIKE

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2025 është planifikuar **822.7 miliardë lekë** ose **31.4% e PBB-së**.

Shpenzimet e personelit për vitin 2025, reflektojnë koston aktuale të administratës publike, si dhe koston e plotë të politikës së rritjes së pagave (+40 miliardë lekë) të nisur në prill të vitit 2023 dhe të finalizuar në korrik të vitit 2024. Shpenzimet totale për pagat në administratën publike në nivel qendror për 86,038 punonjës planifikohen në masën **127.6 miliardë lekë** ose **4.9% e PBB-së**.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin **68.5 miliardë lekë** ose **2.6% të PBB-së**, duke përfshirë në të dhe një rezervë prej 5.8 miliardë lekë për të mitiguar risqet e mundshme nga luhatjet e normave të interesit, kursit të këmbimit etj.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2025 *(pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit)*, janë parashikuar në masën **71.3 miliardë lekë** ose rreth **2.7% e PBB-së**. Në këtë zë është programuar mbështetja me prioritet e politikave ekzistuese të qeverisjes qendrore si: skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrugëve nacionale, mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit, programet e nxitjes së punësimit, skemat për mbështetje dhe zhvillimit ekonomik dhe mbështetje për arsimin dhe sportin.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2025, janë parashikuar në masën **89.9 miliardë lekë**, me një rritje prej 13.2% më shumë se buxheti i vitit 2024. Këto shpenzime për vitin 2025, zënë **3.43% të PBB-së** nga 2.9 që zinin në vitin 2024 ose nga 2.3% në vitin 2015. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 është **1.8 miliardë lekë më shumë** ose rreth 7.6% më e lartë, dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale), është **13.9 miliardë lekë më shumë ose mbi dy herë më e lartë**. Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2025, 26.2 miliard lekë, do të shtohen edhe fondet prej 13.2 miliardë lekë transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, 200 milione lekë grant performance i cili përdoret për herë të parë si mekanizëm financiar në qeverisjen vendore si dhe 3.5 miliard lekë transfertë sektoriale për rritjen e pagave. Në total, në vitin 2025, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 43.1 miliardë lekë nga 36.5 miliardë në 2024 me një rritje prej 6.6 miliardë lekësh ose me një rritje prej 18%.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej **263.8 miliardë lekë**. Niveli i shpenzimeve për *Skemën e Sigurimeve Shoqërore* për vitin 2025, parashikohet në masën **192.3 miliardë lekë** ose **7.3% e PBB-së**. Nga ky fond, për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej **1.6 miliardë lekë** dhe **3.75 miliardë lekë** për bonusin e fundvitit për pensionistët. Ndërsa,

shpenzimet e *Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor* për vitin 2025 janë parashikuar në masën **63.1 miliardë lekë** ose **2.4% e PBB-së**.

Së fundi, shpenzimet për **fondin e kompensimit në vlerë të pronarëve** parashikohen në total në masën **3 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB-së.

Shpenzime të tjera sociale përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin **800 milionë lekë**;
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin **23.7 miliardë lekë** ose 0.9% e PBB-së. Krahasuar me vitin 2024, totali i këtij zëri rezulton me ulje pasi reflekton në tërësi një rialokim prej rreth 2.8 miliardë lekë tek shpenzimet për fondin e sigurimeve shoqërore, në mënyrë që të gjithë përfituesit që gëzojnë statusin e invalidit të punës të mund të marrin pensionet e tyre si dhe përfitimet e tjera që burojnë nga ky status nëpërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, pra një institucioni të vetëm.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej **1.4 miliardë lekë** ose 0.05% e PBB-së.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej **2.25 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB-së.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën **1.85 miliardë lekë** ose rreth 0.1% e PBB-së. Subvencionet shtetërore për vitin 2025 janë përqëndruar në financimin e skemave të nxitjes së punësimit, mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve bazuar në performancën e tij, si dhe në mbulimin e një pjese të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore dhe veprimtarisë së shërbimeve qeveritare.

Investimet Publike për vitin 2025 janë planifikuar në masën **6.2% e PBB-së** ose **161.8 miliardë lekë** (duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 5 miliardë lekë dhe 4.5 miliardë lekë financime të pritshme mbi bazë projektesh nga *Plani i Rritjes me BE*). Në planifikimin e investimeve për vitin 2025 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm dhe do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Në raport me buxhetin e rishikuar të vitit 2024, vëllimi i investimeve publike në vitin 2025 parashikohet me rreth **11 miliardë lekë më shumë**.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2024, planifikohet në masën **5.9 miliardë lekë**, i përbërë nga:

- 2.7 miliardë lekë fond rezervë i Këshillit të Ministrave;
- 2 miliardë lekë fond rezervë për zgjedhjet e përgjithshme;
- 1.2 miliardë lekë fond rezervë për financimin e masave që do të ndërmerren në kuadër të zbatimit të agjendës së planit të rritjes me BE-në.

2.3 DEFICITI BUXHETOR

Pas një stimuli të lartë, për të kryer një politikë fiskale ekspansioniste të domosdoshme dhe njëkohësisht të paevitueshme gjatë viteve 2020 dhe 2021 me qëllim amortizmin e goditjeve negative (nga tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale u rikthye qartësisht drejt konsolidimit duke filluar prej vitit 2022. Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2025-2027, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Me synimin për të ruajtur të pa cenuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, politika fiskale do

të targetojë një trajektore rënëse të përvitshme të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të jetë së paku neutrale ose në nivel pozitiv prej vitit 2024 dhe e në vijim, duke përbërë objektivin kryesor operacional që do të ankorojë politikën fiskale në afatin e mesëm dhe të gjatë, në përputhje edhe me rregullat fiskale respektivë në LOB.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, synojmë që të ruajmë një raport të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) për periudhën 2025-2027 parashikohet të jenë mesatarisht rreth 6.1 për qind e PBB-së në çdo vit buxhetor, duke përfshirë këtu edhe investimet e reja publike që potencialisht do të mundësohen në kuadër të planit të ri të rritjes i vënë në jetë nga Bashkimi Evropian me synimin final të një zhvendosjeje substanciale më lartë të rritjes potenciale në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Defiçiti buxhetor për vitin 2025 planifikohet të jetë në nivelin 2.6 për qind të PBB-së nga rreth 2.3 për qind i pritshëm për vitin 2024. Balanca primare pritet të jetë e balancuar në vitin 2025, në zbatim të rregullit fiskal të parashikuar në LOB, ku përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare nuk mund të rezultojë më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive).

Kuadrat shpjegues 1: Balanca primare, ankora kryesore e politikës fiskale

Balanca primare është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, për të cilën, në korrik të 2020 u ndëmorri një tjetër iniciativë ligjore duke përfshirë një rregull të ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE dhe me parimet kryesore të “acquis” të BE, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë që duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrimit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimësisht rënëse të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarë-vajtjes së ekonomisë së vendit.

Balanca korrente fiskale (diferenca midis investime publike dhe deficit fiskal) do të jetë pozitive në vitin e ardhshëm 2025, në nivelin prej 3.5 për qind të PBB-së nga një nivel i pritshëm përsëri pozitiv prej 3.7 për qind i targetuar këtë vit, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal (rregullin “e artë” të buxhetit). Gjithashtu edhe borxhi publik bruto do vijojë trajektoren rënëse në përputhje me rregullin respektiv fiskal (rregullin “borxh-frenues” të qëndrueshmërisë së borxhit publik). Në vitin 2024 parashikohet që borxhi publik bruto të bjerë në rreth 56.3 për qind të PBB-së dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth 55.8 për qind në vitin 2025. Sipas skenarit bazë, borxhi publik bruto pritet të bjerë në rreth 55.0 për qind në vitin 2026 dhe më tej në rreth 48.5 për qind në vitin 2031.

Shtojcë: Pajtueshmëria me rregullat fiskale

Në përputhje të plotë me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Organik i Buxhetit (LOB) Nr. 9936/2008, i ndryshuar, ligji i buxhetit 2025, ku projeksionet shtrihen deri në vitin 2027, materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. **Rregulli i "Qëndrueshmërisë së borxhit":** Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të PBB-së.

Në përputhje me këtë rregull fiskal të LOB-së, ligji i buxhetit 2025 (-2027) **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total (bruto) në përqindje të PBB-së më të ulët se niveli i vitit pararendës.**

2. **Rregulli i "Balancës primare":** Duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk mund të jetë negative; duhet të jetë së paku zero ose pozitive (tepricë primare).

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull të ri fiskal) të LOB, **balanca primare në ligjin e buxhetit 2025 (-2027) targeton një balancë primare të balancuar ose pozitive.**

3. **"Rregulli i artë":** Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – "rregulli i artë") të LOB, deficit i targetuar në ligjin e buxhetit 2025 (-2027) është **çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.** Rrjedhimisht, balanca fiskale korrente e targetuar është pozitive çdo vit.

4. **Parashikime makroekonomike të kujdesshme:** Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva Ekonomike Botërore" (World Economic Outlook - WEO), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me rregullin fiskal të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB), projektligji i buxhetit 2025 - (2027) mbështetet në projeksionet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nominal, të cilat paraqiten në mënyrë krahasuese me projeksionet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Në këtë cikël të programimit makroekonomik dhe fiskal për projekt-buxhetin 2025, krahasimi i projeksioneve të PBB nominal, siç kërkohet nga ky rregull fiskal, është realizuar kundrejt projeksioneve më të fundit dhe të përshtatshme të FMN-së. Këto projeksione u dërguan zyrtarisht (nëpërmjet postës elektronike zyrtare) në Ministrinë e Financave më datë 9 tetor 2024.

Kjo qasje specifike u adoptua për shkak se projeksionet e FMN-së për Raportin "Perspektiva Ekonomike Botërore" (World Economic Outlook - WEO) të tetorit 2024 ishin finalizuar përpara se Instituti i Statistikave (INSTAT) të publikonte statistikën e rishikuara të Llogarive Kombëtare Vjetore (PBB vjetore) për periudhën 2018-2023 (të publikuara nga INSTAT më 30 shtator 2024).

Duke qenë se rishikimet e statistikave të PBB nominal ishin të konsiderueshme (veçanërisht për vitin bazë 2023) dhe projeksionet e FMN-së për WEO të tetorit 2024 bazoheshin në statistikën e mëparshme të INSTAT-it (shifrat "e vjetra" të PBB), projeksionet e FMN-së të përgatitura për WEO të tetorit 2024 humbën relevancën për qëllimin e këtij rregulli fiskal të LOB-it.

Për këtë arsye, në këtë rast të veçantë, FMN-ja i dërgoi zyrtarisht Ministrisë së Financave projeksionet e përditësuara të PBB nominal për vitet 2024 dhe 2025, të cilat reflektojnë dhe bazohen në statistikën më të fundit të rishikuara të INSTAT-it për Llogaritë Kombëtare Vjetore për periudhën historike 2018-2023. Tabela e mëposhtme paraqet krahasueshmërinë e projeksioneve të Ministrisë së Financave me ato përkatëse të FMN-së, **duke demonstruar përputhshmërinë me këtë rregull fiskal të LOB-it.**

Parashikimet nominale të MF dhe FMN	(miliardë lekë)				
	2021	2022	2023	2024 Para.	2025 Para.
MF	1,866.7	2,149.7	2,369.9	2,494.2	2,620.7
FMN	1,866.7	2,149.7	2,369.9	2,519.9	2,681.3
Diferenca MFE - FMN	0.0	0.0	0.0	-25.7	-60.6
(diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)					

5. **Planifikim kontigjence:** Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontigjencë e veçantë, prejjo më pak se 0.7 përqind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji i buxhetit 2025 - (2027) përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar "Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj." **një kontigjencë prej mbi 0.7 përqind e shpenzimeve totale.**

6. **Të ardhurat nga privatizimi:** Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rast se arkëtohen, ato përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa e mbetur për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 4/1 të Ligjit Organik të Buxhetit nr 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji i buxhetit 2025 - (2027) **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.**

3. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2024 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (*SAMB*). Në fund të muajit qershor 2024, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,356.5 miliardë lekë.

Periudha janar-qershor 2024 ka qenë mjaft pozitive për sa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2024 si edhe në linjë me planin e huamarrjes së vitit 2024. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 250.5 miliard lekë, nga të cilat 95.6% (ose 239.6 miliard lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 4.4% (ose 10.9 miliard lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, strukturat e Ministrisë së Financave përgjegjëse për menaxhimin e borxhit kanë vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm. Gjatë periudhës janar-qershor 2024, të gjithë indikatorët e riskut kanë evoluar në drejtim të objektivave strategjik. Përmirësimi i mëtejshëm i strukturës së borxhit, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit, do të vijojë të mbetet fokusi kryesor në menaxhimin e borxhit, në mënyrë që tregues të këtyre risqeve të tregojnë përmirësim të mëtejshëm në periudhat në vijim.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë kësaj periudhe është vijuar me praktikatat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it. Në drejtim të krijimit të madhësive benchmark është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandeve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2024 dhe vitit 2025, menaxhimi i borxhit do të synojë plotësimin e nevojave të qeverisë për financim në kohë si dhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët duke mundësuar njëkohësisht ulje të ekspozimit ndaj risqeve. Në tregun e brendshëm do të synohet sigurimi i huamarrjes nëpërmjet gjithë gamës së instrumenteve duke u orientuar drejt rritjes së peshës së instrumenteve afatgjata dhe afatmesme, dhe uljes së atyre afatshkurtra. Financimi i huaj do të shërbejë si plotësues i burimeve të brendshme dhe përveç të tjerash edhe si optimizues i kostove të borxhit.

4. POLITIKAT SEKTORIALE DHE PËRFITIMET PËR QYTETARIN

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL

- **Prioritetet 2025-2027**

Prioritetet e sektorit të bujqësisë, për periudhën afatmesme 2025-2027, janë si më poshtë:

- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë;
- Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin;
- Mbështetje për agroindustrinë;
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmblytjeve;
- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

• **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2025-2027**

Në fushën e “*Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit*”, synohet të realizohet:

- Rritja e % së fermerëve që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës ujitëse dhe kulluese ndaj totalit të fermerëve në sipërfaqen potencialisht të ujitshme nga 75% në vitin 2024, në 78% në vitin 2027;
- Përqindja e sipërfaqes ujitëse ku fermerët kanë akses për ujë për ujitje, kundrejt sipërfaqes potencialisht të ujitshme (360 000 ha) nga 75% në vitin 2024, në 78% në vitin 2027;
- Përqindja e hidrovoreve të rehabilituara/ndërtuara/rikonstruara, kundrejt totalit të nevojshëm (14 hidrovorë) nga 75% në vitin 2024, në 80% në vitin 2025, në 85% në vitet 2026-2027;
- Përqindja e sipërfaqes kulluese, që i kryhet procesi ciklik normal i pastrimit të rrjetit kryesorë kullues (1 herë në 5-6 vjet) , kundrejt sipërfaqes potencialisht të kullueshme (280 000 ha) nga 20% në vitin 2024, në 22% në vitin 2027;
- Rritja e numrit të veprave të mbrojtjes nga përmblytja të rehabilituara/ndërtuara (argjinatura gjatësore dhe penele terthorë), nga 38 vepra në 2024, në 48 vepra në 2027.

Në fushën e *zhvillimit rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun* synohet të realizohet:

- Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe atij rural në Shqipëri, për të përmirësuar performancën e tyre ekonomike dhe kushtet e jetesës në zonat rurale, për t'i përgatitur këta sektorë për anëtarësimin e ardhshëm në BE, duke rritur:
 - ✓ Numrin e të punësuarëve në bujqësi dhe agropërpunim (nga 459 068 të punësuar të parashikuar në vitin 2025 në 495 073 të punësuar në vitin 2026).
 - ✓ Aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim.

- ✓ Rritja e volumit të eksportit të produkteve bujqësore dhe të agropërpunimit nga 55.8 miliardë lekë në vitin 2025 në 59.7 miliardë lekë në vitin 2026.
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe industrisë agro-ushqimore si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale, nëpërmjet:
 - ✓ Shtimit të numrit të përfituesëve nga masat mbështetëse në bujqësi. (parashikohen rreth 13.900 përfitues në periudhën 2025-2026 dhe 14.000 në vitin 2027), si dhe rritja e numrit të përfituesve nga Skema e Subvencionit të naftës për bujqësinë nga 31.500 përfitues në vitet 2024-2025 në 32.500 dhe 33.000 përfitues në vitet 2026-2027.
 - ✓ Rritjes së numrit të çertifikimeve dhe testeve të farave dhe fidanëve që hidhen në treg, për të siguruar inpute cilësore për bujqësinë në tregun shqiptar.
 - ✓ Rritjes së numrit të fermave organike të mbështetura nga 100 në vitin 2025 në 105 në vitin 2027.

Në fushën e *“Sigurisë ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”* synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë nëpërmjet:

- Kontrolleve dhe monitorimeve të sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e gjalla duke ulur në këtë mënyrë numrin e kafshëve të prekura nga Bruceloza, nga plasja nga tuberkulozi, dhe nga LSD.
 - ✓ Do të vijojë zbatimi i politikave të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të legjislacionit veterinar, nëpërmjet:
 - ✓ Kryerjes mesatarisht së rreth 317 mijë gjurmimeve dhe kontrolleve tek kafshët përgjatë viteve 2024-2027;
 - ✓ Kryerjes së rreth 460 mijë vaksinimesh tek kafshët në periudhën 2025-2026.
- Rritja e numrit të çertifikatave të unifikuara për eksport nga 60 të parashikuara në vitin 2024 në 65 në vitin 2025 dhe 75 përgjatë viteve 2026-2027.
- Rritjes së numrit të jokonformiteteve të konstatuara nga 350 në vitin 2024 dhe 2025, në 400 në vitin 2026 dhe 450 në vitin 2027.
- Uljes së numrit të rasteve të sëmundshmërisë së njerëzve nga kafshët nga 50 raste në vitin 2025 në 40 raste në vitet 2026-2027.

Në fushën e *“Mbështetjes për peshkimin”* synohet:

- Menaxhimi i peshkimit dhe akuakulturës duke mbështetur sektorin me politika strukturore për tregjet, politikat tregtare dhe politikat ndërkombëtare me qëllim zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në përputhje me standardet e BE-së duke garantuar konkurueshmërinë, mbrojtjen e resurseve, nëpërmjet:
 - ✓ Rritjes së numrit të kontrolleve të inspektoriatit të peshkimit në subjektet e peshkimit nga 2300 në vitin 2024 në 2400 në vitin 2025 dhe 2450 në vitin 2026.
 - ✓ Menaxhimit të 7 porteve dhe ekonomive duke bërë të mundur rritjen e produktivitetit të resurseve nëpërmjet menaxhimit të programeve të ripopullimit me raste.
 - ✓ Kryerjen e raporteve për një monitorim sa më të saktë të aktiviteteve të lidhur me peshkimin, akuakulturën dhe molusqet.

- Rritja e sasisë së prodhimit të molusqeve (në ton) nga 650 tonë në vitin 2025 në 700 tonë në vitin 2026.
- Rritja e numri të subjekteve të mbështetura për peshkimin dhe akuakulturën nga 50 në vitin 2025 në 80 në vitin 2026.

ZHVILLIMI EKONOMIK

Gjatë periudhës 2025-2027 prioritetet në fushën e mbështetjes së zhvillimit ekonomik do të jenë:

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në mesatarisht 45 panairë ndërkombëtare dhe road shoë promovuese, vizita në kompani (after care), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS) 2021-2027;
- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve “*Made in Albania*”;
- Mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke i ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues ose potencialë;
- Nxitja e eksporteve dhe rritjes së konkurrueshmërisë së SME-ve nëpërmjet promovimit të eksporteve, ofrimit të shërbimeve mbështetëse si dhe, programet mbështetjes financiare me anë të granteve;
- Zhvillimi i një qasje holistike në mbështetje të SME-ve në integrimin e zinxhirit të vlerave globale përmes pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin Evropian të Tregut të Përbashkët 2021-2027, në shtyllën e SME-ve.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

Prioritetet 2025-2027

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: (i) një portofoli të investimeve publike; dhe (ii) përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2025-2027

Programi “Transporti rrugor”

- Për tre vitet e ardhshme, kontratat koncesionare që do të mbështeten me fonde nga buxheti i shtetit janë:
 - Kontrata e koncesionit për ndërtimin e Rrugës së Arbrit;
 - Kontrata e koncesionit për ndërtimin e rrugës Milot – Morinë;
 - Kontrata e koncesionit për ndërtimin e rrugës Orikum – Dukat, *By-Pass*-Porti i Jahteve;
- Projektet kryesore për periudhën afatmesme janë sa vijon:
 - Elbasan - Lekaj;
 - By Pass i Elbasanit;
 - Elbasan – Qafë Thanë;
 - Zgjjerimi i Autostradës Tiranë - Durrës;
 - Berat – Ballaban;
 - Projekti i përmirësimit dhe rehabilitimit të urave me kredi të Bankës Botërore;
 - Aeroporti i Vlorës (PPP);
 - Porti i Ri Porto Romano – Durrës;
 - Porti i Triportit - Vlorë (PPP);
 - Hekurudha Tiranë-Durrës dhe Tiranë – Rinas ;
 - Hekurudha Vorë - Hani i Hotit;
- 3532 km rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitet 2025-2027 në të gjithë territorin;

Programi “Ujësjiellës-kanalizime”

- Reduktimi i humbjeve në rrjet në nivel kombëtar në masën 52% në vitin 2027 nga 60% që parashikohet në vitin 2025;
- Orët mesatare të furnizimit me ujë të pijshëm synohet të rritet në 20 orë/ditë në vitin 2027 nga 18 orë/ditë në vitin 2025;
- Orët e furnizimit me ujë në zonat bregdetare synohet të arrihet në 22 orë/ditë në vitin 2027 nga 20 orë/ditë në vitin 2025;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë urbane në 96% në vitin 2027 nga 95% në vitin 2025;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë rurale 70% në vitin 2027 nga 64% në vitin 2025;
- Mbulimi me kanalizime në zonat urbane në 87% në vitin 2027 nga 84.5% në vitin 2025;
- Mbulimi me kanalizime në zonat rurale 20% në vitin 2027 nga 15% në vitin 2025;
- Sasia e ujit të faturuar synohet të arrihet në 120 litër/ frymë/ditë në vitet 2025- 2027;
- Mbulimi me shërbimin e ITUN (kanalizime+gropa septike) synohet të arrihet në nivelin 20% në vitin 2027 nga 16.5% në vitin 2025;
- Përqindja e mbulimit të kostove të ujësjiellës-kanalizimeve me të ardhurat synohet të arrihet në vlerën 80% në vitin 2027 nga 72% në vitin 2025;

Programi “Mbështetje për Energjinë”

- Rritjen e përdorimit të Energjive të Rinovueshme në 46% në vitin 2027 nga 39% që parashikohet në vitin 2024;

- Rritja e efencës së energjisë në 7.9% në vitin 2027;
- Reduktim i mëtejshëm i humbjeve të energjisë elektrike në 16.9% në vitin 2027 nga 18.9% që parashikohet në vitin 2024;
- Rritja e prodhimit vendas së energjisë elektrike me 80.44% në vitin 2027;
- Rritja e përdorimit të biokarburanteve në sektorin e transportit në 3% në vitin 2027 nga 1% që parashikohet në vitin 2025;

Programi “Mbështetje për rrjetet e komunikacionit”

- Rritjen e zhvillimit të infrastrukturës broadband në Republikën e Shqipërisë në 60% në vitin 2027 nga 40% që parashikohet në vitin 2025;
- Rritja e penetrimit broadband në nivel Republike të Shqipërisë në 50% në vitin 2027 nga 35% që parashikohet në vitin 2025;
- Rritja të penetrimit broadband fiks në nivel popullsie në 50% në vitin 2027 nga 40% që parashikohet në vitin 2025;

Programi “Transporti Ajror”

- Rritjen e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të Incidenteve /Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve;
- Integrimi i aviacionit civil shqiptar në sistemet evropiane të transportit ajror, ku synohet përafrimi i legjislacionit 100% përgjatë periudhës 2025-2027;

Programi “Transporti Detar”

- Rritja e volumit të përpunimit të mallrave tregtare në porte në 35 000 ton në vitin 2027 nga 25 000 ton që parashikohet në vitin 2025;
- Rritja e numrit të pasagjereve që udhëtojnë në/nga Shqipëria në rruge detare në 1 725 477 pasagjerë në vitin 2027 nga 1 667 307 pasagjerë që parashikohen në vitin 2025;
- Vijon financimi i projektit “Porti i ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano, faza I”

Programi “Transporti Hekurudhor”

- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Terminali pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë – Rinas;
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vore - Hani i Hotit;
- Rritja volumit të transportit të mallit eksport në 100% në vitin 2027;

Programi “Mbështetje për burimet natyrore”

- Synohet nxitja e rritjes së sektorit përmes promovimit dhe inkurajimit të zbulimit të burimeve të reja potenciale mineralmbajtëse, nëpërmjet kompanive vendase e të huaja, të vogla dhe të mesme;
- Rritja e lejeve minerare aktive në të cilat zhvillohet aktivitetet minerar konform standarteve në 595 leje në vitin 2027 nga 585 leje në vitin 2025;
- Studime për promovimin e burimeve natyrore si dhe studimeve mbi parandalimin e rreziqeve gjeologo-mjedisore dhe hidrologjike, duke parashikuar 23 studime përgjatë periudhës 2025-2027;
- Përmirësimi i transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit.

Programi “Mbështetje për Industrinë”

- Rritja e sigurisë së pajisjeve/instalimeve elektrike dhe enëve nën presion nëpërmjet inspektimeve periodike përgjatë 2025- 2027;
- Rritja e standardeve të produkteve dhe sigurisë së pajisjeve/instalimeve me 20% për vitet 2025-2027;
- Reduktimi i rrezikut nga kimikatet e rrezikshme me 15% për vitet 2025-2027.
- Rritja e numrit të mostrave të analizuara të naftës dhe nënprodukteve të saj, të prodhuara në vend dhe të importuara në masën 14 500 në vitin 2027;
- Rritja e standardeve të naftës dhe nënprodukteve të saj nëpërmjet përdorimit të aparaturave specifike testuese;

Programi “Planifikimi urban”

- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, duke zbutur pabarazinë rajonale, për garantimin e ekuilibrit midis interesave publike dhe private, në zhvillimin e territorit;
- Hartimin e rregullave dhe standardeve të projektimit në disa fusha si dhe përafrimit të legjislacionit me standardet e BE-së;

SHËNDETËSI

Prioritetet 2025-2027

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në sektorin e shëndetësisë do të prioritetizojë:

- ✓ Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore);
- ✓ Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit me efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve;
- ✓ Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave e pajisjeve të rimbursueshme;
- ✓ Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike;
- ✓ Pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
- ✓ Intensifikimi i punës për kostimin e shërbimeve të reja shëndetësore, në kujdesin shëndetësor, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore;
- ✓ Financimi i shërbimit të kontrollit bazë mjekësor bazë për të paktën 50% të numrit të shtetasve të moshës 35-70 vjeç.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2025-2027

- Mbulimi universal i popullsisë me shërbim shëndetësor duke parashikuar mesatarisht 6.81 milionë numër vizitash në periudhën 2025-2027, mbështetur në treguesit e sëmundshmërisë nga 6.7 milion vizita që parashikohen në vitin 2024;
- Ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë (*check-up*) për mesatarisht 475 mijë pacientë në vit;
- Trajtimi me recetë rimbursimi mesatarisht 400 mijë pacientëve në vit, bazuar në treguesit e sëmundshmërisë si dhe politikat e përfitimit nga lista e rimbursimit të barnave, përgjatë periudhës 2025-2027.
- Mbështetja e politikës së rimbursimit të fishave të diabetit, ku synohet rritja e përfituesve të rimbursimit të fishave të diabetit në 57 000 përfitues në vitin 2027 nga 47 700 përfitues që parashikohen në vitin 2024;

- Numri i pacientëve të trajtuar mesatarisht 317-327 mijë pacientë për periudhën 2025-2027;
- Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë nga 9 720 pacientë që parashikohen në vitin 2024 në 10 433 pacientë në vitin 2027;
- Numri i pacientëve përfitues nga shërbimi i dializës për vitin 2027 parashikohet rreth 1 480 pacientë përfitues. Mesatarisht çdo pacient kryen 13 seanca në muaj. Për periudhën 2025-2027 parashikohet rritje e ndjeshme e numrit seancave për pacientët që përfitojnë nga trajtimi me dializë nga 225 mijë seanca në vitin 2024, në 231 mijë në vitin 2027;
- Trajtimi mesatarisht në rritje e 1250-1350 pacientë në vit shërbimi i kryerjes së analizave për Sindromën Down, me një fond prej 25 milion lekë përgjatë periudhës 2025-2027 nga 25 raste të parashikuara në vitin 2024.
- Financimi i politikës së re të paketave të fertilitet për çiftet që kanë nevojë për aplikuar procedurën e fertilizimit in-vitro, me një fond mesatarisht prej 25 milion lekë përgjatë periudhës 2025-2027 duke parashikuar mesatarisht 150 pacientë përfitues.
- Depistimi për kancerin e gjirit mesatarisht 5 500 gra me anë të mamografisë së lëvishme, për vitet 2025-2027, me synim parandalimin e rasteve duke rritur depistimin për kancerin e gjirit kundrejt totalit të grave (grup- moshë 50-60 vjeç) nga 20.3% në vitin 2025 në 30% në vitin 2027;
- Depistimi për kancerin e qafës së mitrës nga 11 000 gra në 13 000 përgjatë 2025-2027 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës, me një fond mesatarisht prej 28.5 milionë lekë përgjatë periudhës 2025-2027.
- Gjatë periudhës 2025-2027 parashikohen të vaksinohen për gripin sezonal rreth 250,000 persona/çdo vit me një fond respektivisht prej 170 milionë lekë.
- Rritja e numrit të thirrjeve për urgjencë mjekësore të adresuara në njësitë e Urgjencës mjekësore nga 350 mijë thirrje në vitin 2024 në 450 mijë thirrje në vitin 2027, duke synuar me një kohë reagimi në 14 minuta për vitin 2027 nga 17 minuta në vitin 2024.

Investimet Publike në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitet 2025-2027:

- Vijon financimi i projektit rikonstruksion në Maternitetin nr.1 Tiranë, faza II, në vitin 2025 parashikohet rreth 158 milionë lekë;
- Vijon financimi i projektit rikonstruksion në Spitalin Psikiatrik Elbasan me vlerë totale 448 milionë lekë.
- Vijon financimi për rehabilitimin e 100 objekteve të tjera të Qendrave Shëndetësore dhe ambulanca, me një fond prej 186 milionë lekë për vitin 2025;
- Në vitin 2025 parashikohet të nis rikonstruksioni i Maternitetit Shkodër me vlerë të plotë 200 milionë lekë;
- Në vitin 2025 parashikohet të nis rikonstruksioni i Maternitetit Fier me vlerë të plotë 443 milionë lekë;
- Parashikohet financimi i projektit rikonstruksion i godinës shtëpia e fëmijës “Zyber Hallulli” Tiranë me vlerë të plotë 237 milionë lekë;

MBROJTA SOCIALE

Në fushën e mbrojtjes sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij: Ndhimja ekonomike, aftësia e kufizuar dhe shërbimet sociale. Më konkretisht synohet:

- Numri i familjeve dhe individëve në nevojë që pritet të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike parashikohet të jetë mesatarisht 62 000 përfitues në vit, ku për vitet 2026-2027 parashikohet të ulet me 1000 familje, ku synohet punësimi i anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese.
- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre parashikohet të shkojë në 162 mijë përfitues në vitin 2027 nga 164 mijë përfitues në vitin 2025, në zbatim të skemës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar pra sipas modelit bio-psiko-social, bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit, synohet krijimi i një sistemi shërbimesh integruese, të cilat kombinojnë pagesat me shërbimet e përkujdesit social;
- Mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale synohet të punësohen mesatarisht 148 persona çdo vit nga 60 persona që parashikohen për vitin 2024, me qëllim integrimin në tregun e punës të kategorive të ndryshme të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike;
- Rritja e numrit të personave të punësuar në ndërmarrjet sociale në raport me numrin e anëtarëve në moshë pune në skemën e ndihmës ekonomike në 2% në vitin 2027;
- Mbështetjen e fondit social për njësitë e vetqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve të reja sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE me paketa sociale shëndetësore, duke synuar ofrimin e 80-90 shërbime në bashkitë e vendit, me një fond mesatarisht prej 350 milion lekë për periudhën 2025-2027. Parashikohet të përfitojnë 61 njësi të vetqeverisjes vendore në vitin 2027 nga 30 NJVV që parashikohen të përfitojnë në vitin 2024.
- Financimi i politikës për mbrojtjen e veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëindjeje, duke synuar të përfitojnë 8 500 gra në vitin 2027 nga 8 000 gra që janë parashikuar në vitin 2024, me një fond mesatarisht prej 850 milionë lekë për periudhën 2025-2027.
- Rritja e grave dhe vajzave në nevojë të ri-integruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social në 55 gra dhe vajza në vitin 2027 nga 45 gra/vajza që parashikohen në vitin 2025;
- Mbështetja e grave të dhunuara që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike kundrejt totalit të kategorive të veçanta në 51% në vitin 2027 nga 45% që parashikohen në vitin 2024;

SIGURIMI SHOQËROR

Në fushën e Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 2025-2027 synohet:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme.
- Vazhdimi e implementimi i reformës së pensioneve dhe përmirësimi i eficiencës së ISSH-së në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, suplementare dhe programore.

- Përsosja e menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhjes së të ardhurave kontributive si dhe shpërndarjes së drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta.
- Vendosja e personave të siguar dhe e përmirësimit të shërbimit ndaj tyre, në qendër të veprimtarisë së ISSH. Thellimi i procesit të modernizimit dhe lehtësimit të dhënies së shërbimeve. Në këtë kontekst, plotësimi i kërkesave të aplikantëve jo më vonë 30-35 ditë nga data e aplikimit.
- Mbështetje aktive për shqiptarët që jetojnë dhe studiojnë jashtë vendit, duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh.

❖ **Rezultatet e synuara për t'u arritur në periudhën 2025-2027:**

- Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve sipas rritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve, të përcaktuar në shportën e pensionistëve. Fondet kontigjencë sipas viteve janë; Viti 2025 – 5,368 milionë lekë; Viti 2026 – 5,503 milionë leke; Viti 2027 – 5,903 milionë lekë.
- Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve sipas rritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve, të përcaktuar në shportën e pensionistëve. Për vitin 2025, efekti i rritjes së pensione në vitin 2024 në masën 4.1% është 5,122 milionë lekë.
- Mbulimi i efekteve financiare të shtesës natyrale të numrit të përfituesve, e cila për vitin 2025 parashikohet të jetë një shtesë neto prej 17 mijë persona, me një efekt financiar 2,275 milionë lekë.
- Sistemi do të vazhdojë të mbështesë me të ardhura mesatarisht 780 mijë persona që kanë përfituar dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare, si dhe një sërë të ardhura të tjera të parashikuara me ligje si dhe, vendime të veçanta dhe vendime kompensuese të Këshillit të Ministrave.
- Shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë punë (kontribues / popullsi në moshë pune) do të jetë mbi 44.6%.
- Pjesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore ndaj totalit të fondeve të alokuara për skemat e sigurimeve shoqërore do të arrijë të mbulojë mesatarisht rreth 78 % të totalit;
- Raporti kontribues/përfitues për pensione pleqërie për vitin 2025 pritet të jetë 1.17.

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore

Sistemi i sigurimeve shoqërore është fokusuar dhe synon:

- ✓ përmirësimin e vazhdueshëm të skemave aktuale, nëpërmjet forcimit të shtyllës publike të pensioneve e forcimit të një lidhje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme,
- ✓ futjen graduale të skemave të përfitimeve suplementare të menaxhuar nga subjekte jo publike,
- ✓ zhvillimin e forcimit të skemave të sigurimeve suplementare profesionale dhe vullnetare,
- ✓ rritjen e efikasitetit dhe përmbushjes së funksioneve të ISSH-së nëpërmjet shtimit të kapaciteteve drejtuese, informatizimit të sistemit në përgjithësi të proceseve të punës dhe të informacionit arkivor,
- ✓ përmirësimin e shërbimit proklient.

Realizimi i objektivave të sipërcituar bëhet përmes menaxhimit me efikasitet dhe efektivitet të tre skemave:

✓ **Skema e Sigurimit të Detyrueshëm:**

Mbulon me fonde transfertat për individët nga pensionet publike, rastet e paaftësisë së përkohshme në punë, rastet e barrëlindjeve, rastet e aksidenteve në punë, në momentin e lindjes së të drejtës dhe nevojës për to. Gjithashtu, mbulon mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarve vullnetarisht, administrimi i kontributeve dhe i transfertave me destinacion nga buxheti i shtetit në buxhetin e ISSH-së, si dhe administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me të drejtat e fituara të kontribuesve në skemën e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.

✓ **Skema e sigurimit suplementar**

Mbulon transfertat fondeve shtetërore për individët që kanë kryer funksione kushtetuese, ish ushtarakët dhe policisë së rendit, si dhe mbështetje për ata individë që kanë statusin e profesorit, naftëtarit, metalurgut, si dhe punonjësve që kanë punuar në miniera.

✓ **Skema kompensuese të shtetit dhe trajtimeve të veçanta**

Mbulon transfertat fondeve shtetërore në buxhetet individuale të pensionistëve dhe personave të tjerë rezidentë që përfitojnë nga programe kompensuese shtetërore ose trajtime të veçanta financiare si personat nën statusin "Dëshmor i Atdheut", punonjësit e ndërmarrjeve ushtarake, për pilotët fluturues në pension, etj.

Buxheti i ISSH-metodologjia e përgatitjes

Llogaritjet për përgatitjen e buxhetit të ISSH-së kalon nëpër të gjitha hapat e kryerjes së një parashikimi. Kjo konsiston në:

- ✓ mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- ✓ hartimin e bashkësisë së supozimeve për periudhën që parashikohet;
- ✓ plotësimin e të dhënave në periudhën bazë dhe supozimet në periudhën e parashikimit;
- ✓ ekzekutimin e modelit dhe kryerjen e parashikimeve;
- ✓ marrjen e rezultateve dhe analizën e tyre.

Prioritetet 2025-2027

Ministria e Arsimit dhe Sportit do të vijojë zhvillimin e reformave në arsim, mbështetjen e arsimit bazë, të mesëm të lartë, orientimin e kurikulave ndaj nevojave të tregut të punës dhe modernizimin e tyre, zhvillimin profesional të mësuesve nëpërmjet trajnimit, promovimit dhe zgjerimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në edukim si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në aktivitete rinore dhe sportive.

- **Rritjen e numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor**, si dhe përfshirjes së klasës përgatitore në arsimin e detyrueshëm;
- **Reduktimin e numrit të klasave kolektive**;
- **Sigurimin i shërbimit të transportit, si dhe mbulimin e shpenzimeve të transportit për rreth 33,000 fëmijë dhe nxënës që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe transportin për rreth 17,300 mësues që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë**;
- **Ofrimi i teksteve shkollore falas për rreth 240 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe tekste shkollore falas për rreth 16 mijë nxënës nga shtresa sociale në nevojë në arsimin e mesëm të lartë**;
- **Ofrimin e bursave financiare apo kuotë ushqimore/financiare për 3800-4000 nxënës me nevoja të veçanta si dhe fëmijëve më me ndikim në uljen e braktisjes shkollore, të nxënësve të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë**;
- **Hartimin e programeve specifike për arsimimin e grupeve të pa favorizuara**. Deri në vitin 2027, çdo fëmijë rom dhe egjiptian, do të regjistrohet në shkollë, 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyruar dhe 70% më shumë vajza e djem romë dhe egjiptianë do të përfundojnë të arsimin e mesëm të lartë.
- **Përmirësimin e infrastrukturës shkollore**, shkolla dhe konvikte të reja sipas standardeve të miratuara;
- Zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së, nëpërmjet: zbatimit të kurrikulës së re në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar si dhe përgatitjes së teksteve specifike për nxënësit e pakicave kombëtare;
- **Fuqizimin e TIK-ut në arsim**, nëpërmjet: hartimit të një platforme dhe plani kombëtar veprimi për zbatimin e TIK-ut në arsim si dhe krijimit të një infrastrukture të qëndrueshme, gjerësisht të përdorshme të burimeve digjitale në shkolla;
- **Përfshirja e gjuhës së huaj (gjuhës angleze) që në klasën e parë të arsimit fillor dhe nga klasa e tretë dy gjuhë të huaja, nga të cilat gjuha angleze si dhe një gjuhë tjetër e huaj me zgjedhje**;
- Rritja e fondeve grant për IAL publike **“Pakti për universitetet”**, përmes financimit me përparësi për ngritjen e infrastrukturës dhe investimeve në kampuse universitare, garantimin e fondeve për

mbështetjen studentore/bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, studentë që ndjekin degët në programet prioritare të përcaktuara me VKM si dhe studentëve ekselentë në IAL publike;

- **Financimi me bursa financiare në masën e pagës minimale të miratuar me VKM i studentëve ekselentë** si dhe ato që studiojnë në programe të përcaktuara **prioritet kombëtar**, si dhe mbështetja e IAL-ve publike me fonde grant në kuadër të programeve të ndërkombëtarizimit; MAS do të mbështesë hapjen e programeve të studimit në gjuhë angleze në të gjitha universitetet shqiptare.
- **Edukimi nëpërmjet sportit** si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetarët përmes sigurimit të një shërbimi cilësor nëpërmjet sportit elitare dhe sportit në tërësi në institucionet arsimore duke kontribuar kështu dhe në forcimin e statusit të të rinjve shqiptarë në të gjitha fushat e jetës.
- **Klasat e profilizuara sportive** - Do të rritet numri i klasave të profilizuara sportive në mënyrë progresive në të gjithë vendin.
- Plani për zhvillimin e sistemit arsimor do të pajisë studentët shqiptarë me dije dhe aftësi të konkurrese me bashkëmoshatarët e tyre në BE.
- Me investimet në laboratorë për kërkimin shkencor dhe me sigurimin e integritet akademik dhe shkencor të universiteteve, do të përmirësohet cilësia e produktit universitar, ndërsa diploma e secilit student do të mbartë vlerën që duhet të ketë.
- Me investimet infrastrukturore në kampuset universitare, do të përmirësohet eksperiencia studentore dhe do të inkurajohen të rinjtë të ndjekin ëndrrat e tyre në kampuset universitare shqiptare.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2025-2027

Për arsimin parauniversitar për periudhën 2025-2027 synohet si më poshtë:

- Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve 3-6 vjeçarë në masën 82% në arsimin parashkollor deri në vitin 2027.
- Të realizohet trajnim çdo vit i mesatarisht 40% i mësuesve në AB dhe rreth 208 mësuesve nga diaspora si dhe mesatarisht 1650 mësues ndihmës për fëmijët me AK;
- Të sigurohet standardi 3.5 - 5m² për nxënës dhe sigurimi i të gjitha standardeve;
- Të rritet përqindja e nxënësve Romë dhe Egjiptian, që u ofrohen tekste shkollore falas 100% për çdo vit;
- Të rritet numri i psikologëve dhe punonjësve socialë të trajnuar në 500 deri në vitin 2027;
- Të rritet numri i nxënësve romë e egjiptianë që ndjekin arsimin parashkollor nga 2200 në vitin 2024 në 2300 nxënës në vitin 2027, si dhe atyre që ndjekin arsimin 9-vjeçar nga 10350 në vitin 2024 në 10930 nxënës në vitin 2027;

- Do të ndërtohen ose rikonstruktohen rreth 70-80 objekte arsimore të arsimit bazë me rreth 1000-1200 klasa/laboratorë ku parashikohet të përfitojnë rreth 20 000 -25 000 nxënës dhe 1500-2000 punonjës mësimorë;
- Deri në vitin 2027, 87% e nxënësve që mbarojnë arsimin bazë të regjistrohen në një nga format/llojet e arsimit të mesëm;
- Rreth 16 mijë nxënës të arsimit të mesëm të lartë ju sigurohen tekstet shkollore falas (klasa 10 deri në klasën 12) çdo vit përgjatë 2024-2027;
- Raporti mësues/nxënës në arsimin e mesëm krahasuar me mesataren e rajonit deri në vitin 2027 të shkojë 11.5.
- Të rritet përqindja e nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm publik nga 82% në vitin 2024 në 85% në vitin 2027;

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për periudhën 2025-2027 parashikohet sa më poshtë:

- 120 programe studimore të akredituara në tre ciklet e studimit në IAL, çdo vit përgjatë periudhës 2024-2027;
- Të sigurohet standardi, një vend pune për dy studentë në laborator kërkimorë shkencorë, në përputhje me Kodine Cilësisë si dhe parimet e barazisë gjinore;
- 100% e të dhënave të stafit akademik, të studentëve, të karrierës akademike, diplomimit, të përfshihen në rregjistrin elektronik kombëtar, brenda vitit 2025-2027;
- 90% e stafeve me kohë të plotë të departamenteve të jenë me grada/tituj në 2026, në përputhje me parimet e barazisë gjinore;
- Raporti mesatar student/pedagog për të tria ciklet e studimit të arrijë 18.5, në vitin 2027;
- Numri i kërkuesve shkencorë për 1000 banorë deri në vitin 2027 të arrijë në nivelin e mesatares së vendeve të OECD-së;
- Rritja e aplikimeve me 15-20% me shume në programin “Horizon Europe”, program për Kërkimin dhe Inovacionin 2021-2027;
- Realizimi i 20 projekteve inovative për çdo vit për periudhën 2024-2027.

Për sportin dhe rininë për periudhën 2025-2027 parashikohet sa më poshtë:

- Mbështetje financiare për rreth 25 federata sportive gjithsej në vit,
- Rritje e numrit të sportistëve të licencuar në federata shqiptare të sportit, në 30 000 deri në vitin 2027, në përputhje me parimet e barazisë gjinore;
- Numri i pjesëmarrjeve në aktivitetet ndërkombëtare, 320 aktivitete ndërkombëtare në vitin 2027 nga 300 të parashikuar në vitin 2024;

- Numri i medaljeve në aktivitetet ndërkombëtare, mesatarisht 47 medalje përgjatë viteve 2025-2027;
- Mbështetje financiare me investime në sport për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale në ekipet sportive kombëtare.

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030 është dokumenti kryesor i politikës në fushën e punësimit dhe zhvillimin e aftësive në vend me objektiv kryesor në fushën e AFP-së, “Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune”. Objektivat strategjike të periudhës 2023-2030 renditen si më poshtë vijon:

1. Zhvillimi i ofertës së arsimit dhe formimit profesional (AFP) më relevant, fleksibël, qeverisur bazuar në fakte e që garanton vijueshmëri;
2. Forcimi i mekanizmave të garantimit dhe zhvillimit të cilësisë në sistemin e AFP-së;
3. Përfshirja në mënyrë sistemike dhe të vijueshme e sektorit privat në qeverisjen, zhvillimin dhe ofrimin e AFP-së;
4. Nxitja e mundësive gjithëpërfshirëse për të nxënëit gjatë gjithë jetës;
5. Njohja e të nxënëit të mëparshëm joformal dhe informal;
6. Transformimi digjital dhe i gjelbër i sistemit të AFP-së.

Aktualisht arsimit profesional ofrohet në 29 shkolla publike të arsimit profesional nga 35 që ishin më një vit më parë, kjo ka ardhur si rezultat i implementimit të planit të optimizimit në qarqet Durrës, Elbasan dhe Korçë. Në këto institucione të AFP-së ofrohen rreth 90 kualifikime nivelit II-IV të KSHK (drejtime mësimore, profile dhe programe pas të mesëm). Arsimit profesional përbën rreth 17.9% të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë. Numri i nxënësve që ndjekin në arsimin profesional publik për vitin 2023-2024 është 14 944 nxënës nga të cilët 2 433 janë vajza. Trendi i regjistrimeve në arsimin profesional vijon në rritje për nxënësit që ndjekin arsimin profesional në krahasim me nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm të lartë (nga 13-14% që ishte në vitin 2013 në vitin 2024 përlllogaritet në 17.9 %.)

Prioritetet për periudhën afatmesme 2025-2027:

- Modernizimi i infrastrukturës së ofruesve publik të AFP-së, në përputhje me parimet e ekonomisë së gjelbër dhe transformimit digjital ;
- Konsolidimi i kontekstit ligjor dhe institucional për një model të alokimit dhe disbursimit të buxhetit për ofruesit publikë të AFP-së;
- Rioriganizimi i rrjetit të ofruesve publikë të AFP-së, në kontekstin e zhvillimit të ekosistemit të ofertës së AFP-së;
- Përditësimi i Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, në përputhje me kërkesat për aftësitë dhe profesionet e të ardhmes;
- Promovimi dhe nxitja e pjesëmarrjes së grupeve të veçanta në AFP (vajza, PAK, romë dhe egjiptianë etj.)
- Zbatimi i plotë i procesit të akreditimit për të gjithë ofruesit publikë të AFP-së, si dhe ofrues privatë që ofrojnë kualifikime profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së, bazuar në standardet dhe kriteret e cilësisë sipas modelit të akreditimit;

- Zhvillimi i qasjes dhe modelit të inspektimit në AFP të harmonizuar me kornizën e garantimit dhe zhvillimit të cilësisë;
- Konsolidimi i sistemit të kualifikimit fillestar dhe zhvillimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve për të përmirësuar aftësitë teknike (profesionale) dhe në shërbim të tranzicionit të gjelbër dhe digjital, në shërbim të mësimdhënies cilësore;
- Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmit të garantimit të cilësisë të ofruesve në zhvillimin e vazhduar profesional për mësimdhënësit e kulturës profesionale;
- Angazhimi i sektorit privat në Këshilli Kombëtar i AFP-së për të lehtësuar kontributin aktiv të komunitetit të biznesit dhe partnerëve socialë në reformën e AFP-së;
- Vlerësimi i nevojave të individëve të rritur për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Akreditimi i ofruesve të njohjes së të nxënësve të mëparshëm;
- Zbatimi i sistemit të njohjes së të nxënësve të mëparshëm joformal dhe informal;
- Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të njohjes së të nxënësve me qëllim përmirësimin e tij;
- Zhvillimi dhe operacionalizimin i autonomisë financiare të ofruesve AFP-së;
- Krijimi i qasjes së ofrimit të AFP-së me kohë të pjesshme;
- Zbatimi i ofertës së AFP-së në formë të kombinuar .

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2025-2027

- Rritja e aksesit në arsimin e mesëm profesional duke synuar që në vitin 2026 të tërhiqen 20% e nxënësve që ndjekin ciklin e arsimit të mesëm, nga 17.9% që parashikohet të arrijë në fund të vitit 2024;
- Rritja e përqindjes së të diplomuarëve/certifikuarve të punësuar 1 vit pas diplomimit nga 47.25% në vitin 2024, në 57.7% në vitin 2025, në 58% në vitin 2026 dhe 58.7% në vitin 2027.
- Rritjes së numrit të të diplomuarve në agjencitë e formimit profesional nga 3000 në vitin 2024, në 3200 në vitin 2025, në 3300 në vitin 2026 dhe 3350 në vitin 2027.
- Rritjen e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 40% e totalit në vitin 2024 në 47% e totalit në vitin 2027;
- Rritjen e numrit të nxënësve me romë dhe egjiptian që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 630 nxënës në vitin 2024 në 670 nxënës në vitin 2027.
- Vijon financimi i ndërtimit të shkollës “Karl Gega”, Tiranë dhe shkollës “Pavarësia”, Vlorë;

TURIZMI DHE MJEDISI

Prioritetet për periudhën 2025-2027

Në fushën e turizmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë ç'ka është unike në vendin tonë. Ndërsa për fushën e mjedisit, synohet sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Prioritetet për periudhën 2025-2027:

- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor duke promovuar gjerësisht Shqipërinë në komunitetin ndërkombëtar si një destinacion i denjë për të konkurruar globalisht;
- Sigurimi e zhvillimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, me qëllim rritjen e turistëve të huaj;
- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i imazhit të vendit duke promovuar produkte lokale;
- Përdorimin e burimeve pyjore në mënyrë të qëndrueshme duke e kthyer në element qendror në vlerën e paketës turistike në bregdet, mal, historik e kulturor;
- Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura;

Rezultatet që synohen të arrihen gjatë periudhës 2025-2027:

- Rritja e kontributit direkt që ka turizmi në produktin e brendshëm bruto;
- Rritja e përpjesës së punësimit në sektorin e turizmit ndaj totalit të të punësuarve në vend;
- Rritja e numrit të bizneseve në sektorin e agriturizmit;
- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor;
- Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në 24% deri në fund të vitit 2027;
- Rritja e përqindjes së mbetjeve që shkojnë në landfille sanitare kundrejt mbetjeve të hedhura në venddepozitime të hapura në 69%;
- Rritja në përqindje e mbetjeve të ricikluara në 19% në vitin 2027;
- 67% e grave në fund të vitit 2027 informohen mbi ndryshimet klimaterike në zonat e mbrojtura;
- Niveli i punësimit në sektorin e turizmit deri në 8.7% deri në vitin 2027;
- Kontributi i turizmit në PBB të shkojë në 33% në vitin 2027.

KULTURA

Prioritetet 2025-2027:

Në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të prioritetizohet:

- Përmirësimi dhe zgjerimi i tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike e kulturore dhe trashëgimisë kulturore, si dhe hartimi i paketës së re të skemës së mbështetjes së projekteve të Ministrisë të Kulturës;
- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza;
- Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve;
- Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, materiale dhe shpirtërore në eventet e rëndësishme ndërkombëtare;

- Zbatimi me sukses i platformës kombëtare “Edukimi përmes artit” nga të gjitha institucionet e artit dhe trashëgimisë dhe në sistemin parauniversitar.
- Forcimi i partneritetit publik dhe privat për realizimin e projekteve rijetëzuese në qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve, kryesisht të rinj nga Universiteti i Arteve, Tiranë (UART), në zbatim edhe të paktit për universitetin/ studentët.
- Përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin, përmirësimi i infrastrukturës në muzetë kombëtarë, parqe arkeologjike si dhe përmirësimin i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin.
- Edukimi përmes librit dhe veprimtarive bibliotekare, pasurimi i fondit bibliotekar në të gjithë rrjetin e bibliotekave në mbarë vendin, me qëllim rritjen dhe edukimin e lexuesit.
- Rritja e aksesit të publikut në muze, monumentet e kulturës, ansamblet arkitektonike, qytetet muze, qendrat historike, zonat dhe parqet arkeologjike në funksion të turizmit kulturor.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2025-2027

Për Trashëgiminë kulturore

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Rritja e numrit të objekteve të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura nga 155 në vitin 2024 në 156 në periudhën 2025-2027.
- Rritja e aksesit të publikut në muze, monumentet e kulturës dhe parqe arkeologjike në funksion të turizmit kulturor (nr. vizitorësh), nga 230 mijë vizitorë në vitin 2024 në 235 mijë turistë në vitet 2025-2027.
- Rritja e numrit të objekteve të regjistruara në databazën kombëtare të trashëgimisë, nga 130 mijë objekte në vitin 2024 dhe 140 mijë në vitet 2025 – 2027.
- Rritja e mbështetjes për aktiviteteve të fushës së trashëgimisë kulturore nga 107 aktivitete në vitin 2024 në 110 aktivitete në vitet 2025-2027.

Për Artin dhe Kulturën

- Rritja e aksesit në kulturë, e cila parashikon një rritje të vazhdueshme të numrit dhe cilësisë së aktiviteteve në të gjitha zhanret. Rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e artit shqiptar në arenën ndërkombëtare, mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës librit dhe përkthimit.
- Prioritet do të jetë integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe.
- Nxitja e konkurrencës artistike përmes audicioneve dhe konkurrimit publik krahasuar me një vit më parë.
- Rritja e numrit të aktiviteteve të zhvilluara nga kalendarët artistik nga Institucionet qendrore publike të art – kulturës nga 650 aktivitete në vitin 2024, në 700 aktivitete në vitin 2025, në 750 aktivitete në vitin 2026 dhe 800 aktivitete në vitet 2027.

- Mbështetja e skenës së pavarur për të mundësuar edukimin përmes kulturës si dhe përfaqësimin e produktit artistik në arenën elitare ndërkombëtare.
- Rritja e numrit të projekteve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi nga 220 në vitin 2024, në 240 në vitin 2025, 260 në vitin 2026 dhe 280 në vitin 2027.
- Rritja e numrit të studentëve të punësuar të angazhuar në shfaqje dhe programe kulturore në rang vendi (Pakti i studentit) nga 4 studentë në vitin 2024 në 7 studentë deri në vitin 2027.

Investimet Publike në sektorin e kulturës për vitet 2025-2027:

- Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i linjës muzeore në Muzeun Historik me qëllim funksionimin komod dhe me nivele standarde evropiane, të aktiviteteve që do të zhvillohen në këtë objekt.
- Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të bukura (Galerisë Kombëtare të Arteve).
- Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave;
- Ndërtimi i godinës së Teatrit Tiranë.
- Përfundon financimi i rikonstruksionit të teatrit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

DREJTËSIA

Prioritetet 2025-2027:

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Në funksion të përparësive kryesore të Ministrisë së Drejtësisë, janë përcaktuar dhe objektivat për realizimin e tyre për periudhën 2025-2027, të cilat janë:

- ✓ Jetësimi i reformës në drejtësi
 - a) Funksionalizimi i organeve të reja të drejtësisë.
 - b) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e reformës në drejtësi.
 - c) Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin.
 - d) Reformimi i shërbimeve publike, rritja e efikasitetit të tyre.
 - e) Ndërmarrja e masave konkrete për një reformim legjislativ, institucional dhe strukturor për të gjithë ato institucione ligj zbatuese që mundësojnë që shqiptarët të marrin shërbime ligjore në kohë, sa më cilësore, profesionale dhe në mënyrë dinjitoze.
 - f) Përmirësimi i sistemit të ndihmës juridike falas që çdo qytetar në pamundësi financiare dhe grupet në nevojë, të përfitojë nga ky shërbim në mënyrë cilësore.

- ✓ Forcimi i luftës kundër korrupsionit në administratë përmes përmirësimit të trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2025-2027

Ministria e Drejtësisë për periudhën 2025-2027 synon:

- Të ofrojë ndihmë juridike për rreth 3,000 gra e vajza në nevojë të cilat plotësojnë kushtet.
- Të realizojë rreth 18,500 akte ekspertimi të klasifikuara si; mjeko-ligjore, toksikologjiko-ligjore, biologjiko-ligjore dhe psikiatriko-ligjore, në përputhje me standartet evropiane për vitin 2025, 19,000 për vitin 2026 si dhe 19,200 për vitin 2027.
- Të përmirësojë kushtet në sistemin penitenciar dhe të ulë mbipopullimin në burgje. Përqindja e IEVP-ve që garantojnë kushtet e sigurisë, trajtimit dhe rehabilitimit të të dënuarve parashikohet të ruajë trendin 50% në fund të vitit 2027.
- Të mbahen në kushte të përshtatshme rreth 5,500 të dënuar burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe të trajtohen me shërbim shëndetësor 438 të dënuar të sëmurë;
- Të riintegrohen nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standartet europiane, rreth 360 të dënuar burra, 2 të dënuara gra dhe 6 të dënuar të mitur;
- Norma e recidivitetit (burra) të ketë një trend konstant 18% ndër vite;
- Norma e recidivitetit (gra) të ketë një trend konstant 1% ndër vite;
- Norma e recidivitetit (të mitur) të ketë një trend konstant 1% ndër vite;
- Përqindja e të dënuarve të cilët punësohen pasi fitojnë lirinë, të ketë trend konstant përgjatë viteve, konkretisht në 11%;
- Të mbikëqyrë në mënyrë efektive nga 7,000-9,000 burra, nga 800-850 gra dhe nga 200-250 të mitur gjatë shërbimit të provës.
- Realizimin e skemës së shpërndarjes së fondit special të kompensimit nga 1 760 vendime të trajtuara me kompensim kundrejt totalit të vendimeve të regjistrimit elektronik të ATP-së të parashikuar për vitin 2025, në 2,130 për vitin 2027.
- Rritjen e numri të titujve të ekzekutuar brenda afateve ligjore nga 11,658 në 2025, në 12,852 në vitin 2027.
- Garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve, nëpërmjet vendosjes në familje të përhershme që përshtaten me nevoja specifike të secilit prej tyre, me synimin që 100% e totalit të biësimeve të rezultojnë të suksesshme.

POLITIKA E JASHTME

Prioritetet 2025-2027:

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme formulon, përpunon dhe është zbatuesi kryesor i politikës së jashtme të shtetit shqiptar, në zbatim të programit të qeverisë. Ajo drejton dhe bashkërendon procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. MEPJ në dialog dhe marrëdhënie me të gjithë partnerët ndërkombëtare pasqyron të gjitha zhvillimet në Shqipëri, përfaqëson e mbron interesat kombëtare si dhe punon për interesat e shtetasve shqiptarë kudo që ata ndodhen, në të mirë të lirisë, sigurisë dhe mirëqënies së tyre.

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nga aktiviteti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2025-2027 janë:

- Vijimi i angazhimit politik e diplomatik të MEPJ dhe përfaqësive në shtetet anëtare të BE-së për avancimin e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Forcimi i dialogut me institucionet e BE-së, në të gjitha nivelet dhe formatet, lidhur me çështje të politikës së përbashkët të jashtme e të sigurisë, përfshirë sanksionet e BE dhe zbatimin e tyre në territorin shqiptar;
- Kryerja me sukses e procesit të negociatave të anëtarësimit për të gjitha çështjet në grup kapitujt e acquis të BE-së, ku MEPJ është kryesuese (kapitulli 31) apo kontribuuese (kapitulli 24 dhe kapitulli 30);
- Rritja e kontributit dhe rolit aktiv të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, në zbatim të prioriteteve të politikës sonë të jashtme dhe në funksion të paqes, sigurisë dhe adresimit të sfidave të përbashkëta, me qëllim realizimin e një përfaqësimi sa më dinjitoz në OKB;
- Angazhim dhe kontribut i shtuar/intensiv e strukturave në MEPJ dhe misioneve të Përhershme të RSH në Gjenevë, Nju Jork dhe Vjenë, në funksion të mandatit si anëtar i Këshillit të Drejtave të Njeriut (KDNJ) të OKB-së për periudhën 2024-2026; si anëtar i Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s për periudhën 2023-2027 (mandati ka filluar që nga 1 janar 2024); si anëtar i Komisionit për parandalimin e Krimit dhe Drejtësinë Penale (CCPCJ) për periudhën 2025-2027 dhe si anëtar i Bordit të **UN Women** për periudhën 2025-2027.
- Vijimësi e angazhimit proaktiv të vendit, pas përfundimit të mandatit si anëtar jo i përhershëm i KS të OKB-së për periudhën 2022-2023;
- Si anëtare e NATO-s, Shqipëria do vijojë të jetë pjesë aktive e vullnetit të palëkundur të Aleancës Atlantike për të siguruar dhe mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit aleat, duke kontribuar ushtarakisht në përforcimin më të madh të NATO-s në lindje të territorit aleat që nga Lufta e Ftohtë. Ajo do të kontribuojë aktivisht në unitetin e Aleancës dhe në rëndësinë thelbësore të lidhjes Transatlantike, në mënyrë që NATO-ja të mbetet kolonë stabiliteti për gjeneratat e ardhshme.
- Forcimi i marrëdhënieve me vendet e rajonit dhe bashkëpunimit rajonal;
- Konsolidim i marrëdhënieve me Kosovën, përmes G2G, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, etj.
- Forcimi i kohezionit të shqiptarëve në rajon; zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjikë, vendet mike dhe aleate; hapja e ambasadave në Ukrainë, Bosnjë e Hercegovinë, Azerbajxhan, Indi, Indonezi e Kenia;
- Forcimi i dimensionit të diplomacisë ekonomike në strukturë, përmbajtje dhe mekanizma të reja për një qasje pro-aktive dhe gjithëpërfshirëse, me krijimin e Bordit të Investimeve dhe Eksporteve dhe Rrjetit të Atasheve Tregtarë nderi/këshilltarë të jashtëm, për të maksimizuar përfitimet kombëtare në tregti dhe investime, rritur bashkëveprimin ekonomik me botën e jashtme, promovuar dhe mbrojtur interesat kombëtare ekonomike, nxitur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe gjetur në arenën ekonomike botërore tregje e partnerë të rinj për tregti, eksport, biznes dhe know-how; promovimin dhe rritjen e imazhit të Shqipërisë jashtë kufijve, si dhe forcimin e *brand*-it të saj si destinacion turistik.
- Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur mundësi dhe zbatuar projekte që i sjellin shqiptarët e diasporës gjithmonë e më afër vendit të tyre. Marrëveshje me vende të ndryshme që

synojnë të ndihmojnë dhe të lehtësojnë jetën e përditshme të diasporës (marrëveshje për njohjen e lejeve të drejtimit dhe ato për sigurimet shoqërore);

- Modernizimi i shërbimeve konsullore në përmbushje të detyrave që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Diasporën, duke synuar përafrimin e diasporës me vendin, identifikimin e nevojave dhe problemeve të tyre dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e tyre në vendin pritës;

MBROJTJA

Prioritetet 2025-2027:

Ministria e Mbrojtjes synon të përmbushë reformat e nisura dhe realizimin e detyrave kushtetuese të Forcave të Armatosura (FA), angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, angazhimeve të FA-ve në kuadër rajonal dhe në aftësitë trajnuese të vetë FA-ve.

Me këtë buxhet, Ministria e Mbrojtjes synon:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA-ve:
 - duke zhvilluar kapacitetet e FA-ve në përputhje me planin afatgjatë të zhvillimit;
 - duke vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
 - duke zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
 - duke modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA-ve, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO-ja mund të ndërmarrë.
- Zhvillimin dhe mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve të FA-ve për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-së dhe BE-së.
- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Prioritetet 2025-2027

Ministria e Brendshme synon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritetet për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, ‘kontrollin e territorit’ dhe ‘policimin në komunitet’, të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor,

në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit. Gjithashtu, synon sigurimin e rendit publik, pronës publike e private, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, krijimin e një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të performancës.

Ministria e Brendshme synon të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së personaliteteve vendas dhe të huaj, të objekteve të rëndësisë së veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standardet evropiane në fushën e sigurisë. Gjithashtu, Ministria e Brendshme synon konsolidimin e mëtejshëm të një sistemi bashkëkohor të digjitalizuar të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), të sistemit të Regjistrimit Kombëtar të Adresave (RKA) dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2025-2027

Përgjatë 3 viteve 2025-2027, Ministria e Brendshme do të përmbushë objektivat e saj si vijon:

- Rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet duke synuar shpejtësinë e reagimit të shërbimeve policore në 13 minuta për vitet 2025-2027;
- Rritja e operacioneve policore të hetuara dhe shërbime të kryera mesatarisht në 43 718 operacione përgjatë periudhës 2025-2027;
- Rritja e operacioneve të posaçme konvencionale mesatarisht 241 operacione përgjatë periudhës 2025-2027;
- Rritja e sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimi i kontrollit të territorit me policimin në komunitet. Synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë si dhe ulja e numrit të aksidenteve rrugore me pasojë vdekjen;
- Rritja e Operacioneve të forcave speciale për kapjen e autorëve të veprave të rënda kriminale në 250 operacione në vitin 2027 nga 235 operacione që parashikohen në vitin 2024;
- Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje 13 minuta në vitin 2027;
- Rritja e hetimeve proaktive në fushën kundër korrupsionit dhe veprave penale në detyrë nga 413 hetime në vitin 2024 në 437 hetime në vitin 2027;
- Rritja e hetimeve proaktive për pastrimin e produkteve (PP) të veprës penale ndaj totalit të hetimeve, nga 248 hetime në vitin 2024 në 270 hetime në vitin 2027;
- Parandalimit i veprave të rënda kriminale (vrasje), duke synuar uljen e rasteve me 2% krahasuar një vitin paraardhës;
- Rritja e hetimeve proaktive për individë dhe grupe me tendenca terroriste me 8% në vitin 2027;
- Rritja e numrit të punonjësve të policisë të pajisur me shërbimet dhe pajisje IT sipas standardeve teknologjike, duke synuar në 100% në vitin 2027, nga 90% parashikuar në vitin 2024;
- Ulja e rasteve të trafikimit të lëndëve të parregullta në kufi, duke synuar në 30 raste për vitin 2027;
- Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së personaliteteve vendas dhe të huaj si edhe sigurisë së objekteve të rëndësisë së veçantë në përputhje me standardet evropiane, konkretisht në zbatimin e standardin gjerman;
- Përdorimi në mënyrë efektive i përditësimit të ngjarjeve në regjistrin civil, në autorizimin dhe certifikimin i aplikimeve për lëshimin e dokumenteve të identitetit. Synohet reduktimi i kohës për trajtimin e kërkesës nga sistemi i RKGJ-së (nga 0.4 orë në vitin 2025 në jo më shumë se 0.35 orë në vitin 2027);

- Rritja e numrit të shërbimeve *on-line* të ofruara nga Gjendja Civile në 31 shërbime *on-line* në vitin 2027 nga 25 shërbime *on-line* që parashikohen në vitin 2025;
- Rritja e numrit të çështjeve të përfunduara nga institucioni i prefektit kundrejt numrit total të çështjeve të prezantuara nga institucionet/qytetaret në 66% në vitin 2027 nga 65% në vitin 2025;
- Në kuadër të rritjes së sigurisë dhe rendit publik do të financohet projekti i “Sistemi i kamerave në administrim të Policisë së Shtetit - *Smart City*” me vlerë të plotë 60 milionë euro me Abu Dhabi.

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR

Për vitin 2025 qeveria shqiptare do të vijojë zbatimin e angazhimeve të saj në adresimin e problematikave me bazë gjinore në sektorë të ndryshëm. Vëmendje u është dhënë përmbushjes së objektivave afatmesëm të parashikur në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030, të shprehur në 5 shtylla kryesore veprimi afatgjatë dhe që kanë të bëjnë në pjesën më të madhe të tyre me fuqizimin e grave dhe vajzave në Shqipëri. Arritja e këtyre objektivave synon jo vetëm krijimin e mundësive dhe kushteve të përshtatshme për gratë dhe vajzat që të mund të jetojnë dhe kontribuojnë në mënyrë të barabartë me burrat dhe djemtë, por sigurisht edhe ruajtjen e balancave dhe ekuilibrave të qendrueshëm mes tyre në shoqëri. Ofrimi i shërbimeve publike të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, është jo vetëm në linjë me objektivat gjinor duke të qeverisë shqiptare, por edhe në përputhje të plotë të objektivave të zhvillimit të qendrueshëm të OKB-së me qëllim që askush të mos mbetet pas.

Trendi i parashikimeve buxhetore që adresojnë çështje të ndjeshme gjinore ka një rritje kryesisht të reflektuar në programe buxhetore për të gjithë sektorët në nivel qendror në: mbrojtje sociale, arsim, shëndetësi, rend publik, bujqësi, drejtësi, etj. Konkretisht, 77 programe buxhetore nga 131 programe buxhetore kanë përfshirë në mënyrë efektive buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në kërkesat e tyre, ose 11 ministri linje dhe 26 institucione qendrore, kanë kryer analiza gjinore të politikave dhe buxheteve të tyre si dhe kanë parashikuar të adresojnë çështje me rëndësi për barazinë gjinore në Shqipëri. Konkretisht:

- Në sektorin e ***mbrojtjes sociale dhe punësimit*** do t’i kushtohet vëmendje e veçantë financimit të pagesave për gratë nga grupet në nevojë të të gjitha grupmoshave, duke filluar nga gratë e moshuara, nënat e më shumë se tre fëmijëve, gratë kryefamiljare të vetme, etj, me qëllim zbutjen e efekteve ekonomike dhe sociale të rritjes së inflacionit si dhe ndryshimeve në tregun e mallrave. Riintegrimi i grave dhe burrave në tregun e punës duke përmirësuar dhe shtuar programet e punësimit, arsimin profesional, si dhe nxjerrjen e këtyre individëve nga skema e pagesës së papunësisë.
- ***Arsimimi*** i vajzave, sidomos atyre nga zonat rurale, vijon të mbetet një prioritet i politikave të arsimit, sidomos gjatë vitit 2025, ku vërehet një ulje e ndjeshme e nxënësve në të gjitha ciklet e studimit, kryesisht për shkak të uljes së numrit të lindjeve dhe emigracionit. Do të vijojnë të ndihmohen me libra falas vajzat dhe djemtë nga grupet në nevojë - rreth 240 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe 16 mijë në arsimin e mesëm të lartë;
- Në sektorin e ***shëndetësisë*** do të vijojnë të mbështeten nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor dhe dytësor, për veten e tyre dhe për bebet që do të vijnë në jetë, duke përmirësuar shërbimet shëndetësore në institucionet e shëndetit parësor dhe dytësor publik. Investimet në maternitete, si dhe mbulimi i kostove për trajtimin e nënave dhe bebeve në këto institucione,

synojnë përmirësimin e kushteve të ofrimit të shërbimeve si dhe rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj shërbimeve shëndetësore publike. Do të shtohet numri i grave dhe vajzave që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës.

- Parandalimi i rasteve të dhunë në familje, mbrojtja e viktimave të dhunës me bazë gjnore dhe asaj në familje si dhe rritja e rolit të grave në strukturat e **rendit publik** do të vijojnë të jenë prioritetet e sektorit edhe për vitin 2025, si një nga elementet e ndërhyrjes së shtetit për krijimin e mundësive të fuqizimit të grave.
- Politikat e **zhvillimit rural** për vitin 2025 synojnë gjithashtu rritjen e numrit të grave që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor si dhe rritjen e numrit të grave fermere që përfitojnë nga skemat kombëtare të mbështetjes.
- Për sektorin e **kulturës** do të vijohet t'i jepet përparësi grave dhe vajzave artiste që promovojnë skenën e pavarur si dhe grave artizane që ruajnë dhe trashëgojnë më tej vlerat dhe traditat e kulturës shqiptare.
- Sektori i **drejtësisë** do të vijojë të mbështesë krijimin e kushteve të përshtatshme të vuajtjes së dënimit, rehabilitimin dhe ri-integrimin në jetën social-ekonomike të grave dhe vajzave që vuajnë dënimin në IEVP apo me shërbim alternativ. Ofrimi i ndihmës ligjore falas për të gjitha gratë dhe vajzat në nevojë që e kërkojnë atë do të vijojë të jetë gjithashtu në fokusin e prioritetëve të buxhetuara në këtë sektor.

Informacione më të hollësishme rreth politikave me bazë gjnore dhe shpenzimeve të parashikuara gjatë 2025 për realizimin e tyre jepen në kapitullin 9.6 më poshtë.

PLANI I RITJES SË BASHKIMIT EUROPIAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Komisioni Evropian miratoi më 8 nëntor të vitit 2023 planin e ri të rritjes për Ballkanin Perëndimor me synim për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të reduktuar pabarazinë e zhvillimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, krahasuar me vendet anëtare të BE-së. Plani i ri i rritjes për Ballkanin Perëndimor përmban prioritetet të organizuara sipas katër shtyllave, si më poshtë vijon:

- Shtylla 1: Rritja e integritit ekonomik me tregun e vetëm të Bashkimit Evropian
- Shtylla 2: Integrimi në Tregun e Përbashkët Rajonal
- Shtylla 3: Përshtetimi i reformave themelore
- Shtylla 4: Instrumenti financiar lehtësuesi për reformën dhe rritjen

Plani i rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor është një hap i rëndësishëm drejt një të ardhmeje më të mirë dhe është një mundësi premtuese për Shqipërinë dhe gjithë Ballkanin Perëndimor. Ky plan synon të mbështesë zhvillimin ekonomik, të nxisë investimet, të krijojë vende pune dhe të përmirësojë standardet e jetesës.

Instrumenti “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor” mbështet shtyllën e tretë dhe të katërt të planit të rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor. Kjo iniciativë e re zhvillimore do të ofrojë mbështetje financiare deri në 6 miliardë euro për periudhën 2024-2027, për të gjashta vendet e Ballkanit Perëndimor.

Synimi është përshtetimi i konvergencës socio-ekonomike të Ballkanit Perëndimor krahasimisht me vendet anëtare të Bashkimit Evropian, ndikuar sidomos nga pasojat që erdhën nga kriza ekonomike si pasojë e pandemisë COVID-19, si dhe kriza energjitike globale, si pasojë e agresionit rus në Ukrainë, përmes nxitjes, me objektiv dyfishimin, e rritjes ekonomike.

Ky instrument është miratuar më 14 maj 2024, përmes rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian “Për miratimin e facilitetit të reformave dhe rritjes për Ballkanin Perëndimor”.

Dokumenti i politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” (AKR 2024-2027) konsiderohet si një instrument i rëndësishëm që do të nxisë përgatitjet ekonomike të orientuara nga tregu për përshejtimin e integrimit të ekonomisë shqiptare në tregun e vetëm të Bashkimit Evropian, drejt progresit në konvergencë me vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vjen si kërkesë e kreu III të rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian.

Prioritetet e reformave të përcaktuara në AKR 2024-2027 janë në përputhje me drejtimit prioritar që përcakton plani i ri i rritjes për Ballkanin Perëndimor, me qëllim përshejtimin e integrimit të ekonomisë shqiptare në Tregun Unik të Bashkimit Evropian, përshejtimin e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian, si dhe thellimin e integrimit ekonomik rajonal, me objektiv kryesor mbështetjen për dyfishimin e rritjes ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

AKR 2024-2027 është një dokument politike reformash thelbësore të nxitjes së rritjes dhe transformimit ekonomik dhe konsolidimit të vlerave të shtetit të së drejtës. Dokumenti i politikës AKR 2024-2027 ofron një përmbledhje masash të përzgjedhura nga dialogu institucional Shqipëri – Bashkim Evropian, dhe hapash për krijimin e mjedisit të favorshëm për konsolidimin e transformimin ekonomik të vendit, i cili është i domosdoshëm për të rritur ritmin e rritjes dhe konvergencës socio-ekonomike me vendet anëtare në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

AKR 2024-2027 përfshin masa që lidhen me prioritetet në fushat/shtyllat e politikave si më poshtë vijon:

1. Klima e biznesit
2. Kapitali njerëzor
3. Energjia / Tranzicioni i gjelbër
4. Tranzicioni digjital
5. Shteti i së drejtës / Themeloret

Në tabelën më poshtë paraqitet një informacion i përmbledhur me financimin e pritshëm nga zbatimi i masave për Agjendën e Reformave, ku janë të përfshira kredi dhe grant:

Tabela 10

	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	TOTAL (Euro)
Impakti total (i pritshëm) në PBA nga Agjenda e Reformave (Kredi +grant) (EURO)	76,715,139	279,784,625	314,381,648	251,204,475	922,085,888

5. BUXHETI VENDOR 2025

Menaxhimi financiar publik në nivel vendor vazhdon të mbetet një prioritet i rëndësishëm i Ministrisë së Financave në kuadër të thellimit të decentralizimit fiskal dhe fuqizimit të rolit të pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve publike. Përgjatë viteve të fundit, Ministria e Financave ka ndërmarrë reforma të rëndësishme të cilat kanë rritur dhe përmirësuar kuadrin rregullator për burimet e financimit të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Pushteti vendor pas reformës administrativo-territoriale dhe miratimit të ligjit bazë për financat e vetëqeverisjes vendore hyri në një fazë të rëndësishme të konsolidimit fiskal të menaxhimit financiar publik.

Reforma në modernizimin e menaxhimit të financave publike në nivel vendor është një proces i iniciuar tashmë prej disa vitesh, e cila mori një dimension të ri zhvillimi pas reformës administrativo-territoriale, duke dhënë rezultate në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore. Në këtë drejtim, janë ruajtur treguesit pozitivë të rritjes së rolit të pushtetit vendor në forcimin e kapacitetit fiskal. Në mbështetje të strategjisë kombëtare të decentralizimit dhe në zbatim të parimeve të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, Ministria e Financave ka punuar për të forcuar rolin financiar të pushtetit vendor, duke konsoliduar procesin e administrimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pushteti vendor ka bërë progres të dukshëm në konsolidimin e menaxhimit financiar, por gjithashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në nivel vendor. Reformat e zhvilluara në vite për modernizimin e financave vendore, kanë dhënë rezultate në përmirësimin e treguesve fiskalë, në konsolidimin financiar dhe përmirësimin metodologjik të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.

Ministria e Financave do të vijojë punën në drejtim të reformimit të financave publike vendore, duke u fokusuar në investimet, rritjen e të ardhurave nga taksat vendore, si dhe në reformimin e skemave të financimit të qeverisjes vendore në përputhshmëri me performancën e tyre duke mbështetur ato bashki që performojnë mirë dhe duke ekspozuar ato me performancë të dobët.

Financat vendore janë një shtyllë e rëndësishme e agjendës së decentralizimit, duke krijuar mundësi që qeveritë vendore të kenë më shumë burime financiare, që ato të kryejnë funksionet dhe kompetencat e tyre në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme. Përgjegjësitë në rritje të qeverisjes vendore sjellin nevojën e rritjes së peshës së të ardhurave dhe shpenzimeve vendore ndaj PBB-së dhe shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, në veçanti rritja e të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar, të ardhurat e veta dhe taksat e ndara.

Reforma në financat vendore është fokusuar edhe në reformimin e sistemit buxhetor vendor me synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për fondet publike vendore. Kjo do të vijojë edhe me fillimin e punës për ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Financiar në nivel vendor (AFMIS).

Disa prej arritjeve më të rëndësishme në proceset e menaxhimit të financave vendore janë:

- Forcimi i sistemeve të menaxhimit të financave publike dhe të informacionit financiar, nëpërmjet reformimit të sistemit buxhetor duke e bërë atë instrumentin kryesor të mirëmenaxhimit të shërbimeve publike për komunitetet vendore;
- Forcimi i disiplinës financiare duke ngritur një sistem monitorues dhe alertues për mirëmenaxhimin e financave publike vendore me qëllim paralajmërimin në kohë për njvqv-të që krijojnë detyrime të prapambetura;
- Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor, një tregues i rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike;
- Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale);
- Rritja e nivelit të pagave për pushtetin vendor me një mbështetje buxhetore për mbulimin e efekteve financiare shtesë si rezultat i rritjes së kufirit minimal.

- Shpërndarja e tatimit mbi të ardhurat personale dhe taksës së rentës minerare duke i dhënë mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të rritur efektshmërinë në ofrimin e shërbimeve;
- Konsolidimi i procedurave të buxhetimit dhe sistemit të menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njvqv-ve, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Zbatimi i metodologjisë së re për hartimin e PBA-së në nivel produkti; Monitorimi i pilotimit të bashkive në përgatitjen e buxhetit me një numër të reduktuar programesh dhe detajimin deri në nivel produkti; Aplikimi i metodologjisë së re të buxhetimit në nivel produkti në 12 bashki pilot;
- Prezantimi i një sistemi të ri (*soft on-line*) për përgatitjen e PBA-së dhe buxhetit vjetor, për të ndihmuar njvqv-të dhe ministrinë në përgatitjen e buxhetit vendor, PBA-në vendore dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit.
- Përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;
- Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor “Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Forcimi i sistemit të mbikëqyrjes financiare të njvqv-ve nga qeveria qendrore me qëllim mbështetjen e njësive vendore në probleme/vështirësi financiare.
- Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm, por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme me njvqv-të në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.

Të gjitha arritjet e mësipërme në drejtim të qeverisjes vendore janë një tregues i rëndësishëm për rritjen e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët. Në funksion të reformimit dhe modernizimit të financave publike dhe kryesisht atyre vendore, në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike është parashikuar që në vitet e ardhshme sistemi i AFMIS-it të jetë i zgjeruar dhe në nivel vendor duke sjellë një vlerë të shtuar të menaxhimit financiar publik në nivel vendor.

OBJEKTIVAT E TREGUESVE TË FINANCAVE PUBLIKE VENDORE PËR VITIN 2025

Financat vendore mbeten një komponent i rëndësishëm i decentralizimit duke krijuar mundësi që njësitë e vetëqeverisjes vendore të kenë më shumë burime financiare, që të kryejnë funksionet dhe kompetencat e tyre në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme. Fokusi kryesor në buxhetin e vitit 2025 për Ministrinë e Financave do të jetë vazhdimi i zbatimit të procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të konsolidimit të decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Duke ju referuar paktikave dhe asistencës më të mirë ndërkombëtare të menaxhimit të financave publike në nivel vendor, Ministria e Financave do të vazhdojë të krijojë hapësirën e nevojshme për orientimin e politikave

publike vendore mbi bazën e performancës buxhetore. Disa tregues të reformës së financave publike në nivel vendor me një efekt pozitiv në buxhetin e vitit 2025 pritet të jenë si më poshtë vijon:

- Buxheti vendor i vitit 2025, do të jetë **rreth 13.2%** më i lartë se buxheti i pritshëm vendor për vitin 2024.
- Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave ku më e rëndësishmja është rritja e transfertës së pakushtëzuar në **26.2 miliardë lekë** në vitin 2025, e cila në krahasim me vitin 2024 është rritur në vlerën **1.8 miliardë lekë**, dhe krahasuar me vitin 2015 është rritur me **13.9 miliardë lekë**.
- Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore përmes rritjes së peshës së taksave lokale në të ardhurat vendore. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor nga viti 2015 në vitin 2025 parashikohen me një rritje të ndjeshme me rreth **20 miliardë lekë**, ndërkohë krahasuar me vitin 2024 parashikohet të rriten me rreth **3.6 miliardë lekë, ose 10% më shumë**.
- Transferta e pakushtëzuar për çdo bashki në vitin 2025, do të jetë me rritje mesatare në nivelin **rreth 8.2% dhe për qarqet me një rritje mesatare në nivelin rreth 3%** krahasuar me një vit më parë.
- Vazhdimi i financimit të funksioneve të transferuara në pushtetin vendor në vitin 2016, në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale në **vlerën 13.2 miliardë lekë**.
- Rritja e pagave në buxhetin e vitit 2025 për funksionet e transferuara arsimit parashkollor dhe shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, me një fond shtesë prej **1.6 miliardë lekë**.
- Rritja e pagave në buxhetin vendor 2025 për të mbuluar efektin financiar shtesë për rritjen e kufirit minimal të nivelit të pagave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me një fond shtesë prej **3.5 miliardë lekë**. (Vendimi i Këshilli të Ministrave nr.328 datë 31.5.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar).
- Financimi i grantit të performancës në shumën **200 milionë lekë** me qëllim nxitjen e bashkive për të përmirësuar performancën e tyre në qeverisje, menaxhimin më të mirë të financave publike vendore dhe rritjen e transparencës.
- Plotësimi i standardit ligjor për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (një zjarrfikës për 1500 – 2000 banorë) për 15 bashki, me një fond shtesë prej **221.1 milionë lekë**.
- Financimi i shpenzimeve operative për funksionet e transferuara, me një fond shtesë prej **444.8 milionë lekë, ose rreth 4 % më shumë se një vit më parë**.
- Financimi shtesë i funksioneve të arsimit parashkollor, administrimit të pyjeve dhe mbrojtjes sociale, në shumën **20 milionë lekë** për disa bashki.
- Të ardhurat e bashkive nga taksat e ndara, krahasuar me vitin 2015, para reformës administrativo-territoriale, do të rriten me rreth **1.5 miliardë lekë** për vitin 2025, duke përfshirë shpërndarjen e tatimit mbi të ardhurat personale dhe taksën e rentës minerare.
- Reforma e iniciuar nga qeveria në taksën e pasurisë do të vazhdojë të reflektohet në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor. Në buxhetin e vitit 2025 taksa e pasurisë është parashikuar në vlerën **8.6 miliardë lekë** dhe krahasuar me vitin 2024, **rreth 2 miliardë lekë** më shumë të ardhura për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Shtesë e planit të financimit të huaj në shumën **500 milionë lekë**, për zbatimin e projekteve me skemë të plotë thesari nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

❖ **Transferta e pakushtëzuar 2025 dhe formula e shpërndarjes së saj**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit për financat vendore përfitojnë të ardhura në formën e transfertave nga qeveria qendrore, ku një rol të rëndësishëm e zë transfertat e pakushtëzuar.


Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2025, bazohet në një formulë mbi kritere që garantojnë funksionimin normal të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar do t'u sigurojë njësisë të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2025, transfertat e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: a) pjesa e përgjithshme dhe b) pjesa sektoriale. Formula e shpërndarjes së transfertës garanton një sistem më të drejtë ekualizimi fiskal duke ndihmuar bashkitë me kapacitet më të ulët fiskal. Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrativo-territoriale. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale dhe rajonale. Gjithashtu, formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia rezidente, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi mbi të ardhurat personale, nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Censusi i vitit 2023 rezultoi me ulje të numrit të popullsisë krahasuar me Censusin e vitit 2011 me 397,852 banorë ose 14.21% më pak. Pavarësisht humbjeve të popullsisë me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar, në formulën e vitit 2025 është vendosur një rregull fiskal që asnjë njësi e vetëqeverisjes vendore nuk do të marrë më pak se 105% të fondeve që i janë akorduar në vitin 2024. Si rrjedhojë, bashkitë të cilat rezultojnë me numër popullsie më të lartë sipas Censurit 2023 krahasuar me Censusin e vitit 2011 do marrin më shumë fonde.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024 është **1.8 miliardë lekë** më shumë ose rreth **7.6 për qind** më e lartë dhe krahasuar me vitin 2015 (viti para reformës administrativo-territoriale) është **13.9 miliardë lekë** më shumë (siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm). Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar, tregon rëndësinë që i është kushtuar procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore gjatë këtyre viteve.

Figura 1: Transferta e pakushtëzuar 2015-2025 (në mln lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2024);

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale përbëjnë një burim të rëndësishëm për financimin e funksioneve të pushtetit vendor. Gjatë vitit 2025, pushteti vendor do të përfitojë në total **43 miliardë lekë** në formën e transfertave, nga të cilat **26.2 miliardë lekë** ose 60% është transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme e cila shpërndahehet përmes formulës, **13.2 miliardë lekë** ose 30% është në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për financimin e funksioneve të transferuara në nivel vendor, **200 milionë lekë** grant performance dhe **3.5 miliardë lekë** ose 10% në formën e transfertës sektoriale për rritjen e pagave.

❖ Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore

Detyrimet e prapambetura janë një ndër risqet potenciale fiskale për funksionimin e njvq-ve, pasi rritja e nivelit të tyre mund të shoqërohet me probleme likuiditeti për njësitë vendore. Në këtë drejtim Ministria e Financave gjatë viteve të fundit i ka kushtuar vëmendje nxitjes së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në nivel vendor. Në funksion të menaxhimit të financave publike vendore, Ministria e Financave në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore përgatit një raport vjetor mbi statusin e gjëndjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, mbi të cilin njvq-ve hartojnë edhe një plan veprimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Në kuadër të masave të marra stoku i detyrimeve të prapambetura nga **12.1 miliardë lekë** që ishte në fillim të vitit 2016, në fund të vitit 2023 është reduktuar në **4.8 miliardë lekë** ose ulur **mbi 60 për qind**.

Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit qershor 2024, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave është rreth **4.2 miliardë lekë**. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth **0.6 miliardë lekë**, krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2023.

Ministria e Financave në muajin maj 2024, ka përgatitur dhe publikuar raportin e gjëndjes financiare për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023, ku ka rezultuar se tetë bashki dhe një këshill qarku janë me probleme financiare dhe katër bashki dhe 2 këshilla qarqesh me vështirësi financiare. Për këto bashki/këshilla qarqesh është hartuar një plan shlyerje/rehabilitimi për daljen nga situata e problemeve/vështirësisë financiare i cili do të vijojë të zbatohet edhe në buxhetin e vitit 2025.


Gjatë vitit 2024, janë realizuar vlerësime dhe raportime periodike mbi ecurinë financiare të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, mbështetur mbi treguesit fiskalë janë dhënë rekomandime ndaj njësive të cilat kanë një ecuri jopozitive në drejtim të rritjes së stokut të detyrimeve ndaj të tretëve. Ky proces monitorimi do të vazhdojë periodikisht edhe në vitin 2025, duke zbatuar me

përpikmëri detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

❖ Treguesit fiskalë e buxhetorë të pushtetit vendor

Buxheti vendor i vitit 2025, parashikohet të jetë rreth **13 për qind** më i lartë se plani i vitit 2024, ose në nivelin prej **3.43 për qind** i produktit të brendshëm bruto. Me buxhetin e vitit 2025 do të financohen funksionet e transferuara në pushtetin vendor, si dhe të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, të cilat njësitet e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë t'i ushtrojnë në shërbim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Figura 2: Buxheti Vendor 2024-P/Buxhet 2025




Burimi: Ministria e Financave (2024);

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2025, janë parashikuar në masën **89.861 milionë lekë** ose **3.43 për qind e PBB-së**. Buxheti vendor për vitin 2025 krahasuar me buxhetin vendor 2024, parashikohet me një rritje me **rreth 10.5 miliardë lekë**. Në këtë zë është përlogaritur transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për njësitet e vetëqeverisjes vendore, financimi i funksioneve të reja, financimi i shtesës për të mbuluar një pjesë të efektit financiar të rritjes së pagave, financimi i grantit të performancës, si dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.

Të ardhurat nga taksat vendore për vitin 2025 parashikohet të kenë një rritje rreth **3.6 miliardë lekë** më shumë se sa plani i vitit 2024, ose e thënë ndryshe me një **rritje prej 10%**, ndërkohë krahasuar me vitin 2015 si viti para reformës administrative, të ardhurat vendore parashikohen me një rritje të konsiderueshme me rreth **20 miliardë lekë**. Gjithashtu, pushteti vendor gjatë vitit 2025, parashikohet që **4 miliardë lekë** t'i akumulojë nga të ardhurat jostatimore, të cilat parashikohen me një rritje prej 3% krahasuar me një vit më parë. Të dyja këto burime financimi për buxhetin vendor kanë ndjekur një trend rritës si rrjedhojë e ndarjes më të drejtë dhe transparente të fondeve për njësitet e vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta si dhe rritjes së burimeve të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, ndryshimet në taksën e pasurisë, parashikohet të ndikojnë në peshën e rritjes së të ardhurave në buxhetin vendor.

Referuar grafikut të mëposhtëm konstatohet se pesha specifike e të ardhurave vendore ndaj produktit të brendshëm bruto është rreth 1.56 %, ose 0.8 % më shumë se pesha që zinte në vitin 2015. Ndërkohë, të ardhurat e pushteti vendor për vitin 2025 zënë 5.4 % të totalit të të ardhurave totale të buxhetit të shtetit.


Figura 3: Peshë specifike e të ardhurave të buxhetit vendor ndaj të ardhurave të buxhetit qendror dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Rritja e shpenzimeve të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë periudhës 2015-2025, konstatohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto shpenzime si ndaj shpenzimeve buxhetore në total, ashtu edhe ndaj produktit të brendshëm bruto. Peshë specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj buxhetit të shtetit është rritur ndjeshëm në vitin 2025 (10.92 përqind), krahasuar me vitin 2015, ku shpenzimet e buxhetit vendor zinin vetëm 7.79 për qind të shpenzimeve të buxhetit shtetit. Ndërkohë, siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, për vitet 2020-2025, peshë specifike e buxhetit vendor ndaj produktit të brendshëm bruto është rritur me rreth 1.05 për qind më shumë se peshë që zinte në vitin 2015.


Figura 4: Peshë specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave (2024);

Tendenca e rritjes së buxhetit vendor do të vazhdojë edhe në buxhetin e vitit 2025 (figura 5), ku buxheti vendor parashikohet të jetë rreth 3.43% i produktit të brendshëm bruto. Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2025, do të zënë rreth 10.92 % të shpenzimeve publike, me një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë.

Figura 5: Tendenca e buxhetit vendor 2015-P/Buxhet 2025



Burimi: Ministria e Financave (2024);

❖ Objektivat kryesorë për buxhetin vendor të vitit 2025

Duke u mbështetur mbi treguesit pozitivë të ecurisë së decentralizimit fiskal dhe rritjes së cilësisë së menaxhimit financiar publik në nivel vendor, Ministria e Financave, gjatë vitit 2025 do të ndjekë me prioritet thellimin e reformave në nivel vendor. Gjatë vitit 2025 synohet të ruhen treguesit pozitivë të rritjes së rolit të pushtetit vendor në forcimin e kapacitetit fiskal si dhe trendi pozitiv i ecurisë së konsolidimit financiar në nivel vendor.

Ministria e Financave gjatë vitit 2025 do të vijojë me reformimin e financave publike vendore, duke u fokusuar në rritjen e investimeve, digjitalizimin e operacioneve të menaxhimit financiar në nivel vendor, rritjen e të ardhurave nga taksat vendore si dhe në reformimin e skemave të financimit të qeverisjes vendore në përputhje me performancën e tyre. Fokusi kryesor do të jetë në drejtim të ruajtjes së qëndrueshmërisë së transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale, si dhe forcimit të disiplinës financiare për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen, të cilat mund të kthehen në një rrezik serioz potencial për njësitë vendore, me ndikim negativ në ekonominë e vendit në tërësi. Rritja e cilësisë së përdorimit të buxhetit si një instrument të rëndësishëm politikë bërës në nivel vendor përbën një fokus të vecantë për ngritjen e kapaciteteve vendore në menaxhimin financiar.

Në vitet në vazhdim, do të implementohet sistemi AFMIS edhe për nivelin vendor duke iu ofruar njësitë të vetëqeverisjes vendore digjitalizimin dhe automatizimin e shumicës së operacioneve financiare si, përgatitjen e PBA-së, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, integrimin e strategjive në buxhetim, menaxhimin e investimeve publike dhe menaxhimin e mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.

Disa nga objektivat për vitin 2025 për buxhetin vendor paraqiten si më poshtë:

- Rishikimi dhe përditësimi i formulës së transfertës së pakushtëzuar, duke përdorur të dhëna të reja të bazuara në regjistrimin e popullsisë sipas CENSUS-it.

- Forcimi i sistemeve të menaxhimit të financave publike dhe informacionit financiar në nivelin vendor përmes përdorimit të Sistemit të ri të Menaxhimit të Buxhetit Vendor. Harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësisë të vetëqeverisjes vendore, sipas standardeve ndërkombëtare;

Gjatë vitit 2025, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të konsolidojnë ecurinë e përdorimit të standartit të unifikimit të shpenzimeve vendore në nivel produkti, programi e funksioni. Ministria e Financave do të monitorojë zbatimin e metodologjisë së re për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor për 12 bashkitë pilot, si dhe do të shtojë numrin e bashkive të cilat do të aplikojnë metodologjinë e re të buxhetimit. Përdorimi i treguesve të performancës në Programin Buxhetor Afatmesëm do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor. Ministria e Financave do të vijojë punën për të konsoliduar buxhetimin në nivel produkti tek të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetimi në nivel produkti, është një ndër objektivat e rëndësishme përmes së cilit synohet që njësitë e vetëqeverisjes vendore të kostojnë produktet e shërbimeve që ofrojnë për qytetarët.

- Forcimi i burimeve të qëndrueshme të të ardhurave të veta vendore, si një burim i rëndësishëm i autonomisë dhe aftësisë së pushtetit vendor për të ofruar shërbime cilësore publike për qytetarët.

Rritja e të ardhurave të veta të njësisë të vetëqeverisjes vendore është tregues i rëndësishëm i kapacitetit fiskal jo vetëm për konsolidimin financiar por edhe për aftësinë për të ofruar shërbime publike në interes të qytetarëve. Gjatë viteve 2023-2024, pushteti vendor ka siguruar një rritje të konsiderueshme të nivelit të të ardhurave në raport me planin e treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar, tregues ky i kapacitetit në rritje të njësisë për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të funksioneve. Taksa mbi pasurinë, është një burim i rëndësishëm i të ardhurave vendore përmes së cilës njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Në këtë drejtim, Ministria e Financave do të ndjekë me prioritet ruajtjen e qëndrueshmërisë së rritjes së të ardhurave vendore edhe gjatë vitit 2025.

- Forcimi i rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale në menaxhimin e vështirësive financiare;

Në buxhetin e vitit 2025 do të synohet rritja e kapacitetit fiskal të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe gjithashtu përmirësimi i shërbimeve publike të ofruara për qytetarët. Ministria e Financave në mënyrë të vazhdueshme do të ndjekë e do të monitorojë procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tij vlerësimin e treguesve të performancës së NJVQV-ve.

- Granti i performancës për bashkitë

Akordimi i grantit të performancës për vitin 2025, bazuar në kritere dhe tregues performance, me qëllim nxitjen e bashkive për të përmirësuar performancën e tyre në qeverisje, menaxhimin më të mirë të financave publike vendore dhe rritjen e transparencës.

- Zgjerimi i AFMIS në nivel vendor

Implementimi i sistemit të AFMIS-it edhe për nivelin vendor do të sjellë për pushtetin vendor digjitalizimin dhe automatizimin e shumicës së operacioneve financiare si: përgatitjen e PBA-së, zbatimin

dhe monitorimin e buxhetit, integrimin e strategjive në buxhetim, menaxhimin e investimeve publike dhe menaxhimin e mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. Gjithashtu, ky sistem do të unifikojë të gjithë punën dhe operacionet financiare në të gjitha fazat dhe ciklet e menaxhimit financiar, do të mundësojë një komunikim të efektshëm midis institucioneve dhe njësive qendrore me ato vendore dhe do të jetë një garanci më shumë për përdorimin e fondeve publike me efikasitet, ekonomi dhe efektshmëri.

- Zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për 61 bashkitë dhe 12 qarqet për ngritjen e kapaciteteve për përgatitjen e dokumentit të buxhetit vjetor, Programit Buxhetor Afatmesëm, raportimit e zbatimit të buxhetit.
- Monitorimi i mekanizmave që nxisin rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin.

Një sfidë e rëndësishme për t'u thelluar në qeverisjen vendore mbetet rritja e transparencës dhe llogaridhënies përmes pjesëmarrjes qytetare në proceset e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor. Gjatë vitit 2025, Ministria e Financave do të synojë nxitjen e njësive të vetëqeverisjes vendore për të bërë pjesë të politikave publike sa më shumë qytetarët, duke përmirësuar kështu transparencën edhe nëpërmjet hartimit të buxhetit të qytetarit.

6. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2025

6.1 PAKETA FISKALE

Për vitin 2025 nuk është hartuar një paketë e re fiskale, e cila do të gjenerojë të ardhura shtesë për buxhetin e vitit 2025.

Ndër masat e politikave fiskale të parashikuara në këtë buxhet janë ligje tatimore të miratuara në paketat e mëparshme dhe që sjellin efekte në të ardhura në vitin 2025, si dhe të ardhura nga efekti i politikave buxhetore dhe konkretisht:

1. Në zbatim të ligjit për akcizat, lidhur me cigaret dhe duhanet, ka një kalendar 2022-2026 lidhur me rritjen e nivelit të akcizës çdo vit. Për vitin 2025 janë parashikuar të ardhura shtesë nga zbatimi i kalendarit të rritjes së akcizës në shumën prej 852 milionë lekë si dhe 20% TVSH mbi këtë shumë të rritur akcize.
2. Në buxhetin e të ardhurave të vitit 2025, janë parashikuar të gjenerohen 2 miliardë lekë shtesë nga zbatimi i ndryshimeve në ligjin "Për lojrat e fatit dhe kazinotë". Të ardhurat shtesë të parashikuara, përfshijnë si taksat nacionale të programuara të regjistrimit të operatorëve që do operojnë në fushën e basteve sportive, edhe të ardhurat nga tatimi mbi lojrat e fatit-baste sportive online që do paguajnë subjektet që do liçensohen.
3. Nga data 1 korrik 2024 u zbatua reforma e dytë buxhetore e rritjes së pagave në administratën shtetërore. Rritja e fondit të pagave për administratën shtetërore ka efekt në të ardhurat nga tatimi mbi pagën dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për vitin 2025, janë parashikuar që 7 muajt e parë, efekti në të ardhura do të jetë 6,299 milionë lekë, nga të cilat 2,002 milionë lekë janë të ardhura nga tatimi mbi pagën dhe 4,297 milionë lekë janë të ardhurat nga kontributet.

6.2 DRAFT STRATEGJIA AFATMESME E TË ARDHURAVE (SAA) DHE PLANI I VEPRIMIT, 2024-2027

Prej datës 20 shtator 2024, Ministria e Financave ka hedhur për konsultim publik draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave dhe Plani i Veprimit (SAA), 2024-2027. Miratimi i kësaj draft strategjie është programuar të bëhet brenda muajit dhjetor 2024 dhe përbën një parakusht që Shqipëria duhet ta plotësojë në kuadër të dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”.

Miratimi i kësaj strategjie është kusht për disbursimin e shumës prej 5,977,866 eurosh nga BE-ja.

Objektivi i draft Strategjisë është rritja e të ardhurave tatimore me +2.5 % e PBB-së, krahasuar me vitin 2023, duke arritur në vitin 2027 mbi 27.7 % e PBB-së, bazuar në rishikimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2022-2026, duke e përditësuar për periudhën 2024-2027.

Nga zbatimi i masave të parashikuara në draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave për periudhën 4 vjeçare parashikohen të gjenerohen rreth 64.9 miliardë lekë të ardhura, ku peshën kryesore e kanë masat që do të ndërmerren nga mirëadministrimi tatimor.

Draft SAA është e ndërtuar mbi tri shtylla me komponentët përkatës që parashikohet se do të gjenerojnë të ardhura shtesë në buxhet si vijon:

1. Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore me 3 komponentë, nga e cila do të ketë rritje të të ardhurave tatimore me 9.28 miliardë lekë, përgjatë 2024-2027;
2. Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor me 7 komponentë, nga e cila do të ketë rritje të të ardhurave tatimore me rreth 51 miliardë lekë, përgjatë 2024-2027;
3. Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor me 9 komponentë, nga e cila do të ketë rritje të të ardhurave doganore 4.5 miliardë lekë, përgjatë 2024-2027.

Në tabelën më poshtë është një përmbledhje e tri shtyllave, komponentevë dhe synimeve që synojnë të adresojnë çdo komponent.

Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	Shtylla 3 : Mirëadministrimi doganor
Rishikimi i politikës tatimore të taksave mbi konsumin <i>Synohet që brenda vitit 2027 të kemi një analizë e detajuar e të gjitha përjashtimeve, normave të reduktuara për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe akcizën</i>	Zvogëlimi i hendekut të pajtueshmërisë në lidhje me TVSH-në.. <i>Synimi është që brenda vitit 2027 të rritet përpushmëria tatimore e TVSH, me rritje të deklarimit të qarkullimit të 14% të tatimpaguesve deklarues tvsh.</i>	Modernizimi i proceseve të biznesit, duke përfshirë centralizimin e funksionit të profilizimit të rrezikut <i>Synimi i këtij objekti është zhvillimi i sistemeve/ moduleve të IT dhe kapaciteteve të administratës doganore për të rritur efektivitetin në mbledhjen e të ardhurave doganore</i>
Rishikimi i politikës tatimore të taksave direkte <i>Synohet që brenda vitit 2027 të kemi një analizë të detajuar e të gjitha përjashtimeve, normave të reduktura për tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin korporativ</i>	Ulja e pagesave me para në dorë në ekonomi. <i>Synimi në 2027 është që të ulet përdorimi i cash nëpërmjet masave tatimore dhe shumica e tatimpaguesve</i>	Zhvillimi i aftësive të zgjeruara analitike të të dhënave. <i>Synimi është që brenda vitit 2027 administrata doganore të ketë zhvilluar modele makroekonomike që rrisin aftësitë analitike dhe parashikuese të fenomeneve</i>

	<i>të pranojnë pagesa me kartë.</i>	<i>ekonomike që prekin Administratën Doganore.</i>
Rishikimi i politikës tatimore të taksës mbi pasuritë e paluajtshme. Miratimi i ligjit të ri dhe fillimi i zbatimit të tij në vitin 2026.	Hetimi i pasurisë së pajustificuar. <i>Synimi në 2027 është që të jenë krijuar sistemet, regjistrat dhe kapacitetet për hetimin e pasurisë së pashpjeguar dhe të jenë kryer mbi 500 hetime tatimpaguesish dhe mbi 200 hetime të individëve</i>	Rritja e investimeve në zhvillimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit <i>Synimi i këtij komponenti është që brenda vitit 2027 të jenë kryer zhvillime teknologjike IT për përmirësimin e infrastrukturës aktuale të administratës doganore.</i>
	Zvogëlimi i shmangies tatimore. <i>Synimi në 2027 është që jenë krijuar instrumentat për të investiguar rastet e shmangieve tatimore</i>	Zhvillimi dhe zbatimi plotësisht i një kornizë integriteti për të ndihmuar në ndërtimin e besimit të komunitetit <i>Synimi është që brenda vitit 2027 të jetë hartuar dhe të jetë në zbatim i një plan gjithëpërfshirës integriteti me qëllim që të rritet besimi i komunitetit tek administrata doganore.</i>
	Reduktimi i punës së padeklaruar dhe te nëndeklarimit të pagës reale. <i>Synimi është që brenda vitit 2027 të jetë përfshirë në listë pagesë 40 mijë të punësuar të rinj si dhe të rritet deklarimi i pagës reale për 120 mijë të punësuar.</i>	Rritja e numrit të operatorëve ekonomikë të autorizuar. <i>Synimi i këtij komponenti është zhvillimi i programit të Operatorit Ekonomik të Autorizuar, me qëllim rritjen e numrit të autorizimeve të dhëna për AEO dhe rritje e flukseve të shkëmbimeve tregtare dhe nënshkrim i një marrëveshjeve për njohje reciproke me BE.</i>
	Reduktimi i kostove të përmbushjes dhe rritja e sigurisë tatimore dhe besimit te administrata tatimore. <i>Synimi në 2027 është që rritet pajtueshmëria vullnetare e tatimpaguesve dhe besimi tek administrata tatimore</i>	Zbatimi i Dritares së Vetme Kombëtare (National Single Ĕindoë) <i>Synimi i këtij komponenti është që brenda vitit 2026 të jetë krijuar Dritarja e Vetme Kombëtare (National Single Ĕindoë-NSĔ).</i>
	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore (AT) nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të administratës tatimore. <i>Synimi në 2027 është që administrata tatimore të jetë efektive dhe të jetë rritur cilësia e ofrimit të shërbimit.</i>	Përmirësimi i përdorimit të Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transimit (SRKT). <i>Synimi i këtij komponenti është që Shqipëria të bëhet pjesë e tranzitit European brenda vitit 2027.</i>
		Rritja e bashkëpunimit në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara <i>Synimi në 2027 është që brenda vitit 2027 të jetë rritur bashkëpunimi në luftën kundër informalitetit, kontrabandës, korrupsionit dhe importit të mallrave të falsifikuara</i>
		Zgjerimi i shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e rrezikut. <i>Synimi në 2027 është që jetë zgjeruar shkëmbimi i informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë për të përmirësuar profilin e rrezikut.</i>

Sikurse është shpjeguar edhe më lart, të ardhurat e parashikuara për vitin 2025 nga zbatimi i masave nën këtë draft SAA, në shumën 15,963 milionë lekë, janë programuar në buxhetin e vitit 2025, sipas zërave të taksave.

Tabela 11: Të ardhurat që do të gjenerohen nga zbatimi i draft SAA

në milion Lekë

Shtyllat e Strategjisë	2024	2025	2026	2027	Totali 2024-2027
Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	1,010	800	1,000	6,473	9,283
Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	16,577	13,755	10,069	10,665	51,067
Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor	1,265	1,408	1,171	664	4,508
Totali	18,852	15,963	12,240	17,802	64,858

6.3 PËRJASHTIMET NGA TAKSAT (“TAX EXPENDITURES”)

Shpenzimet tatimore, apo “*tax expenditures*” konsiderohen paksim i të ardhurave të buxhetit si rezultat i lehtësirave fiskale ose normave preferenciale të vendosura për kategori të caktuara tatimpaguesish, veprimtarish apo industri të caktuara. Koncepti i “shpenzimit tatimor” përdoret dhe shuma e këtij shpenzimi llogaritet dhe deklarohet me qëllim që të gjithë aktorët ekonomikë dhe publiku, të kuptojnë dhe ta kenë të qartë sa reduktohen të hyrat nga tatimet dhe taksat në buxhetin e shtetit për shkak të lehtësive dhe favoreve tatimore të dhëna me ligj. “Shpenzimet tatimore” vlerësohen duke përdorur një metodologji të re bazuar mbi disa modele për vlerësimin e shpenzimeve tatimore sipas llojit të tatimeve. Analiza e përjashtimeve ligjore dhe përcaktimi i benchmark-ut (përjashtime që janë normë në të gjithë vendet) u krye me asistencë të Bankës Botërore.

Për vlerësimin dhe matjen e “përjashtimeve nga taksat” janë marrë në konsideratë tatimet dhe taksat e mëposhtme:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar, përkatësisht në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Tatimi mbi të ardhurat, përkatësisht në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.
- Akciza, përkatësisht në ligjin nr.61/2012 “Për akcizën në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë indeksin zinxhir të rritjes reale ekonomike, si dhe efektet e veçanta që prodhohen si pasojë e ndryshimeve në politikat fiskale, përcaktohet vlera totale paraprake e shpenzimeve tatimore për zërat e mëposhtëm:

- Shpenzime tatimore nga tatimi mbi vlerën e shtuar
- Shpenzime tatimore nga akciza
- Shpenzime tatimore nga tatimi mbi fitimin.

Duhet theksuar se pjesën më të madhe të vlerës së shpenzimeve tatimore e zënë ato shpenzime të cilat rrjedhin si efekt i përjashtimeve nga secili prej tatimeve të mësipërme. Pjesën dërrmuese të totalit të shpenzimeve tatimore e zë shpenzimi tatimor që vjen prej TVSH-së dhe diferenca e mbetur si shpenzim tatimor nga akciza dhe tatimi mbi fitimin.

b. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)

Shpenzimet tatimore që vijnë nga TVSH-ja llogariten sipas metodologjisë së re, duke shfrytëzuar tabelat e Burim – Përdorimeve që prodhohen prej INSTAT-it. Duke nxjerrë për secilën nga 35 llojet e aktiviteteve (të ndara sipas kodeve dy- dhe katërshifrore NACE) pjesën e aktivitetit që tatóhet me normën standarde, normën e reduktuar dhe përjashtimin arrihet të vlerësohet se sa janë shpenzimet tatimore prej TVSH-së.

c. Akciza

Shpenzimet tatimore prej akcizës, llogariten duke bërë diferencat në normat më të larta për çdo kategori mallrash të akcizueshëm me normat reale që janë akcizuar, pasi për disa kategori mallrash nën regjimin e akcizës, ekzistojnë disa norma akcize (për verën, birrën, etj).

Shpenzimet tatimore = (Norma më e lartë e përcaktuar me ligj – Normën efektive) * Sasinë e hedhur në konsum

d. Tatimi mbi Fitimin

Shpenzimet tatimore që vijnë nga tatimi mbi fitimin llogariten me supozimin që në vitin 2022 tatimpaguesit të mos paguajnë 5% por 15% mbi fitimin e tatueshëm, të gjitha subjektet me xhiro vjetore nën 8 milionë lekë.

Sipas raportit përfundimtar për shpenzimet tatimore, për vitet 2021 dhe 2022 shpenzimet tatimore janë si më poshtë:

Tabela 12

(në miliardë lek)

Lloji i Tatimit	Viti 2021		Viti 2022	
	Shpenzimi Tatimor	% e PBB	Shpenzimi Tatimor	% e PBB
TVSH	76.59	4.13	84	3.93
Akciza	1.39	0.07	1.08	0.06
TF + TTHF (CIT)	13.02	0.7	2.52	0.77
TOTALI	91	4.9	101.68	4.76

(Burimi: Ministria e Financave, 2024)

Në çdo vit, shpenzimi tatimor rritet apo zvogëlohet në varësi të politikave të reja tatimore, pra heqjes/përfundimit të incentivave tatimorë ekzistues apo shtimit të incentivave apo përjashtimeve të reja. Tendenca duhet të jetë reduktimi gradual i shpenzimit tatimor, me qëllim rritjen e të ardhurave për përballimin e shpenzimeve.

Theksojmë gjithashtu se në vitet 2019 dhe 2020, për shkak të problematikës së njohur e të lidhur me tërmetin e nëntorit 2019 dhe pandeminë globale 2020 janë bërë ndryshime fiskale, të cilat kanë rritur shpenzimin tatimor për shkak të rritjes së përjashtimeve dhe tarifave të reduktuara, ndërkohë që në vitet

në vijim janë ndërmarrë masa për reduktimin dhe mbylljen e incentivave fiskalë, të cilët do të ndikojnë edhe në reduktimin e shpenzimeve tatimore.

7. RREZIQET FISKALE DHE MASAT MBROJTËSE

Risku i normave të interesit

Gjatë viteve të fundit, deri në fund të vitit 2021, ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit ka ardhur duke u zbutur, kryesisht për shkak të rikompozimit të portofolit të borxhit të brendshëm në drejtim të titujve afatgjatë me norma interesi fikse, si edhe bazuar në normat e interesit në nivele të ulëta në tregun e brendshëm dhe atë të huaj. Në periudhën nga viti 2021 deri në fund të vitit 2023, risku i normave të interesit ka qenë në nivele të konsiderueshme, duke marrë në konsideratë zhvillimet në tregjet e huaja dhe atë vendas. Normat e interesit në tregun e brendshëm pësuan rritje të ndjeshme në 2022 dhe vijuan edhe gjatë 2023. Banka e Shqipërisë ka rritur 5 herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2022 duke arritur në nivelin prej 2.75%, krahasuar me 0.5% që ishte në fund të vitit 2021. Më pas, gjatë vitit 2023, BSH ka rritur 2 herë normën bazë të interesit, duke arritur në nivelin prej 3.25% në nëntor 2023. Në vitin 2024, BSH-ja për herë të parë uli normën bazë të interesit nga 3.25% në 3.0%. Rritja e normave të interesit të tregut referencë përbën një ndikim të rëndësishëm në zërin e shpenzimeve për interesa. Ky ndikim është zbutur nga struktura ekzistuese e normave të interesit, ku më shumë se 98% e stokut të borxhit të brendshëm përbëhet nga instrumente me normë interesi fikse si dhe në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 60% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Në këtë aspekt, përveç masave për reduktimin e peshës së titujve afatshkurtër, do të vijojë të mbahet nën kontroll pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme, në linjë me hapësirat e tregut dhe preferencat e investitorëve.

Projeksionet në lidhje me shpenzimet e interesave në buxhetin e vitit 2025 vlerësohen të jenë realiste, bazuar në zhvillimet më të fundit të tregjeve. Megjithatë, duke filluar nga viti 2017 në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në ligjin organik të buxhetit, në buxhetin e shtetit janë programuar kontingjenca të veçanta për të absorbuar rritjen e shërbimit të borxhit që mund të burojë nga rritja e normave të interesit përtej pritshmërive. Në këtë drejtim, në buxhetin e vitit 2025 janë parashikuar 5.78 miliardë lekë kontingjenca, një nivel ky i mjaftueshëm për të përballuar rritje të normave të interesit në krahasim me normat e supozuara në llogaritjet e bëra nga Ministria e Financave.

Risqet në krahun e të ardhurave

- *Mosarritja e objektivit të rritjes ekonomike*

Në projektbuxhetin 2025 është parashikuar rritja e të ardhurave si rezultat i rritjes ekonomike reale për 3.9%. Reduktimi i kësaj rritje poshtë programimit do të tkurrë edhe të hyrat e buxhetit të projektuara për shkak të këtij faktori.

- *Devijimet në ulje nga projeksionet e nivelit të inflacionit të projektuar*

Në projeksionet për tatimet indirekte për të cilat zbatohen tarifa *ad valorem* janë parashikuar të ardhurat shtesë nga rritja e indeksit të çmimeve për 3%. Nëse niveli i projektuar do të rezultojë më i ulët, nuk do të realizohen të ardhura shtesë në nivelin e projektuar.

- *Ndryshimet e paparashikuara në kurset e këmbimit të lekut me monedhat e tjera*

Përgjatë vitit 2024, të ardhurat doganore janë ndikuar negativisht nga ulja e kursit të këmbimit si të euros dhe të dollarit në krahasimi me vitin 2023. Për 8 muajt e parë të vitit efekti negativ ka qenë rreth -12 miliardë lekë. Ulja e kursit të këmbimit të monedhave euro apo USD tej nivelit të parashikuar do të impaktojë TVSH-në mbi importet e mallrave për shkak të uljes së vlerës së mallrave.

- *Çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare*

Luhatjet në çmimet ndërkombëtare të produkteve me ndikim në të hyrat e buxhetit, në rastet kur këto çmime ulen.

- *Mosmiratimi i ndonjë elementi të paketës fiskale mbi bazën e së cilës është ndërtuar buxheti 2025*

Mosmiratimi i ndonjë mase të propozuar do të ulë të ardhurat në atë masë që nuk miratohet.

- *Moszbatimi i ndonjë mase të parashikuar në draft Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave 2024-2027.*

Për vitin 2025 janë parashikuar rreth 15,9 miliardë lekë nga zbatimi i masave nën draft SAA. Moszbatimi i ndonjë mase e cila ka efekt në parashikimin e të ardhurave do të ndikojë në uljen në atë masë të parashikimit për atë taksë apo tatim.

Kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore

Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontratat koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Aktualisht, janë aktive 11 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), përkatësisht sipas tabelës 13 të mëposhtme:

Tabela 13: Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emertimi i Kontrates PPP	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Programi	Lloji i shpenzimit	në mijë Lekë						
							2021 Fakt	2022 Fakt	2023 Fakt	2024 I rishikuar	2025 Parashikimi	2026 Parashikimi	2027 Parashikimi
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë		Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit (jo-aktive)	2015	2021	06220	Investime	40,292	0	0	0	0	0	0
		Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Fier (jo-aktive)	2016	2022	06220	Investime	690,040	376,385	0	0	0	0	0
		Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Ballëdren (jo-aktive)	2018	2031	04520	Investime	3,100	0	0	0	0	0	0
	1	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit	2018	2031	04520	Investime	3,392,727	2,940,000	2,844,000	3,504,000	3,360,000	3,360,000	3,360,000
	2	Subvencionimi i kontratës koncesionare për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë	2019	2032	04520	Investime	790,027	740,978	666,563	720,000	720,000	720,000	720,000
3	Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Onikum - Dukat	2021	2034	04520	Investime	47,069	224,698	726,787	947,000	956,000	956,000	956,000	
4	Ndërtimi dhe Mirëmbajtja e Portit të Integruar të Triportit Vlore	2023	2032	04520	Investime	0	0	0	0	0	0	0	
Ministria e Financave	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Korrente	1,660,686	1,925,903	1,540,310	1,542,100	1,573,698	1,620,909	1,669,537
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Konçesioni/PPP Kontrolli baze i popullsisë 35-70 vjeç (check up)	2015	2027	07220	Korrente	219,021	876,083	876,083	876,090	876,090	876,090	876,090
	2	Konçesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2016	2026	07330	Korrente	1,500,924	1,699,975	1,749,982	1,756,104	1,900,000	500,000	0
	3	Konçesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës në 5 spitale rajonale)	2016	2026	07330	Korrente	747,195	802,583	849,129	920,000	960,000	0	0
	4	Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	07330	Korrente	1,103,199	1,612,914	1,718,879	1,850,000	1,900,000	1,950,000	2,000,000
Bashkia Tiranë / Ministria e Arsimit dhe Sportit	1	Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë	2018	2026	09120	Investime	0	395,074	698,074	722,926	715,142	685,286	655,426
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit / Bashkia Tiranë	1	Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimit ekzistues Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike	2017	2047	06220	Korrente	1,249,399	1,046,397	989,797	1,185,360	1,270,200	1,270,200	1,270,200
TOTALI							11,443,679	12,640,991	12,659,602	14,023,580	14,231,130	11,938,485	11,507,253
Totali i të Ardhurave Tatimore për periudhën 2021-2027							475,611,880	541,342,220	598,661,930	655,698,569	709,854,478	748,349,269	789,954,889
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)							2.9%	2.7%	2.3%	2.3%	2.2%	1.7%	1.5%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Për sa i përket respektimit të nenit 4/2 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “... shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor...”, rezultojnë se:

- Për vitin 2025, kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore të pritshme të vitit 2024, është rreth 32.8 miliardë lekë.
- Për vitin 2025, pagesat vjetore neto që parashikohet të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare/PPP, kapin vlerën rreth 14.2 miliardë lekë.
- Rrjedhimisht, në buxhetin 2025 respektohet kufizimi ligjor i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e parashikuar prej rreth 14.2 miliardë lekë për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare apo PPP për vitin 2025, përbën vetëm 2.2% të totalit të të ardhurave tatimore të pritshme për vitin 2024 prej rreth 655.7 miliardë lekë.

Gjatë vitit 2024, Ministria e Financave ka vijuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, duke monitoruar ecurinë e pagesave faktike buxhetore për secilën kontratë. Monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar përmes përfshirjes në udhëzimin plotësues nr.1, datë 24.1.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim është kryer në bazë të rregullit mujore.

Për sa i përket ecurisë faktike të pagesave koncesionare në nivel 9-mujor për vitin 2024, në vijim jepet një tablo përmbledhëse:

- Fondet buxhetore të alokuara sipas planit me ndryshime për vitin 2024 të raportuar nga autoritetet kontraktore përkatëse, me destinacion mbështetjen buxhetore për kontratat koncesionare/PPP,

rezultojnë në total rreth 14 miliardë lekë. Nga këto, rreth 5.9 miliardë lekë investime dhe rreth 8.1 miliardë lekë shpenzime korente.

- Krahasuar me pagesat faktike të vitit 2023, të cilat arritën vlerën rreth 12.7 miliardë lekë, pagesat e planifikuara për vitin 2024 janë rreth 10.8% më të larta ose rreth 1.4 miliardë lekë më shumë.
- Pagesat faktike për periudhën 9-mujore 2024 rezultojnë në masën rreth 9.3 miliardë lekë ose 66.5% e planit vjetor me ndryshime të vitit 2024. Nga këto, niveli më i lartë i pagesave është realizuar në muajin gusht me rreth 1.9 miliardë lekë ose 20.6% të pagesave faktike 9-mujore:
 - *Pagesa më e lartë e realizuar në muajin gusht është pagesa prej rreth 1 miliard lekësh për kontratën “Përmirësimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit”, pagesë e cila përbën 52.4% të totalit të pagesave faktike të realizuara në muajin gusht.*
- Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, pagesat faktike për 9-mujorin 2024 rezultojnë rreth 1.4 miliardë lekë më të larta ose rreth 17.3% më shumë, rritje e cila i dedikohet pagesës më të lartë të realizuar kryesisht për kontratën:
 - *“Përmirësimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit”, ku pagesat faktike për 9-mujorin 2024 rezultojnë 1.5 miliardë lekë më të larta se 9-mujori 2023. Ky realizim i referohet skedulit të pagesave, sipas përcaktimeve të kontratës koncesionare në fjalë, pasi në terma vjetorë, i gjithë plani i pagesave të kësaj kontrate për vitin 2024 është rreth 48.4% më i lartë ose 660 milionë lekë më shumë se totali i pagesave faktike të saj në vitin 2023.*

Nga ana tjetër, për disa kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, për periudhën 9-mujore të vitit 2024 ka pasur rënie të pagesave buxhetore krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku veçojmë kontratën:

- *Subvencioni i kontratës koncesionare “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë”, ku pagesat faktike për 9-mujorin 2024 rezultojnë 355.7 miliardë lekë më të ulëta se 9-mujori 2023. Ky realizim ndikohet nga periudha e pagesës së kësteve, të cilat ndjekin skedulën e pagesave sipas përcaktimeve të kontratës koncesionare në fjalë. Në terma vjetorë, i gjithë plani i pagesave të kësaj kontrate për vitin 2024 është rreth të njëjtës vlerë me totalin e pagesave faktike të saj në vitin 2023.*

Sektori Energjetik

Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm të tij në ekonomi. Ky monitorim, i cili kryhet periodikisht mbi bazë tremujore, konsiston në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tri kompanive energjetike, KESH, OST dhe OSHEE Group.

Në mbështetje të nenit 4/2 të ligjit nr.57, datë 2.6.2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, sipas së cilit: “...Planë financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujore të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme dorëzohen në Ministrinë e Financave...”, Ministria e Financave, periodikisht mbi bazë tremujore, mbledh, përpunon dhe analizon informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjetik dhe ndërmarrjeve shtetërore të cilat mund të kenë një impakt të mundshëm në buxhetin e shtetit. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjetik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikën sensitive që e karakterizojnë.

Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur tabelat e ekspozimit ndaj sektorit të energjisë elektrike dhe madhësia aktuale e detyrimeve kontingjente në lidhje me këtë sektor.

Tabela 14 Fondet për përballimin e krizës energjetike 2021-2023 (në milionë lekë)

Viti buxhetor	Akti ligjor/nënligjor	Fonde të akorduara	Total
Viti 2021	Akti Normativ nr.31 datë 27.10.2021	10,000	10,000
	<i>Mbështetje për energjinë nëpërmjet instrumentit të garancisë sovrane</i>	10,000	
Viti 2022	Buxheti Fillestar nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022"	8,000	28,000
	<i>Hua për sektorin energjistik</i>	8,000	
	Akti Normativ nr.3 datë 12.03.2022	20,000	
	<i>Mbështetje buxhetore për sektorin energjistik</i>	20,000	
Viti 2023	Buxheti Fillestar nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023"	12,000	12,000
	<i>Mbështetje buxhetore për sektorin energjistik</i>	12,000	

Burimi: MF 2024

Tabela 15 Të dhëna mbi financimin e sektorit të energjisë nga buxheti i shtetit (plan/fakt) për periudhën 2021- 8M 2024 (në milionë lekë)

	2021		2022		2023		8M 2024	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Financim nga buxheti i shtetit	11,900	3,041	30,100	28,474	14,000	873	2,000	308
<i>Garancitë Sovrane për Sektorin e Energjisë (OSHEE Group sh.a)</i>	10,000	1,504	-	-	-	-	-	-
<i>Hua e dhënë për Sektorin e Energjisë</i>	-	-	8,000	7,907	-	-	-	-
<i>Mbështetjen buxhetore për sektorin energjistik</i>	-	-	20,000	20,000	12,000	-	-	-
<i>Financimi i huaj për sektorin e energjisë</i>	1,900	1,537	2,100	567	2,000	873	2,000	308

Burimi: MF 2024

Tabela 16 Të dhëna mbi impaktin e sektorit të energjisë në financat publike për periudhën 2020- 7M 2024 (në milion lekë)¹

	2020	2021	2022	2023	7M 2024
Ndikimi në financat publike:	5,240	5,504	33,017	5,286	2,108
1. Garancitë dhe nënhatë e paguara nga MF	5,240	5,407	12,973	5,285	2,107
<i>Garanci të paguara nga MF</i>	2,069	1,504*	2,989	1,149	745
<i>Projekte me financim të huaj të nënhuazuara</i>	3,172	3,903	2,077	4,136	1,362
<i>Hua e dhënë për energjinë</i>	-	-	7,907**	-	-
2. Mbështetje buxhetore për sektorin energjistik	-	-	20,000**	-***	-
3. Detyrimet Tatimore (të papaguara vjetore)	0.1	97.2	43.4	0.1	0.5

Burimi: MF 2024

Në terma të riskut fiskal, impakti i sektorit si kosto apo të ardhura të munguara në financat publike deri në përdhën 7M 2024, vlerësohet rreth 2.1 miliardë lekë, nga rreth 5.3 miliardë lekë në vitin 2023, duke treguar një përmirësim të gjendjes së detyrimeve. Kjo situatë është ndikuar nga kushtet e favorshme atmosferike që rritën ndjeshëm nivelin e prodhimit të energjisë vendase nga KESH, sh.a.-ja. Projektet e investimeve me financim të huaj për sektorin e energjisë për vitin 2024 u miratuan në nivelin 2 miliardë lekë sipas buxhetit fillestar të miratuar me ligjin nr.97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", dhe nuk pësuan rishikime gjatë vitit buxhetor.

¹ *Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë (OSHEE Group sh.a.) nëpërmjet instrumentit të garancisë sovrane në shumën 10,000 milionë lekë për vitin 2021 me anë të aktit normativ nr.31, datë 27.10.2021.

**"Hua e dhënë për energjinë" planifikuar në shumën 8,000 milionë lekë për vitin 2022 (realizimi faktik 7,907 milionë lekë) dhe "Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë" planifikuar në shumën 20,000 milionë lekë për vitin 2022 (realizimi faktik 20,000 milionë lekë).

***Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë" planifikuar në shumën 12,000 milionë lekë për vitin 2023, nuk u përdor dhe, nëpërmjet Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023, u rishpërnda për zërat e tjerë të shpenzimeve publike, bazuar në situatën e qëndrueshme të sektorit.

Për sa i përket performancës së sektorit në tërësi vlen të theksohet se:

Përgjatë periudhës 8-mujore janar-gusht 2023, sektori ka shënuar një ecuri pozitive të performancës financiare të tij, si rezultat i kushteve të favorshme meteorologjike në vend, duke rezultuar me një nivel fitimi operativ pozitiv, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e pozicionit financiar të sektorit. Konkretisht, niveli i basenit të Fierzës deri në muajin gusht 2024 ishte në kuotën 280.6m, nivel ky më i lartë sesa kuota mesatare prej 279.3m e 30 viteve të fundit, për të njëjtën periudhë.

Kështu, krahasuar me 8-mujorin 2023 vërehet se:

- Niveli i përgjithshëm i prodhimit vendas, edhe pse më i lartë sesa mesatarja e 30 viteve të fundit, ka pësuar një rënie me rreth 12.0 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Konkretisht, për periudhën 8M 2024 prodhimi neto vendas rezultoi në rreth 5.44 TWh, krahasuar me 6.18 TWh që ishte për të njëjtën periudhë të një viti më parë
- Gjatë 8M 2024, KESH sh.a realizoi një nivel prodhimi neto publik prej rreth 3.01 TWh, krahasuar me 3.66 TWh realizuar në 8M 2023.
- Ky tregues edhe pse më ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, dëshmon që deri në 8M e vitit 2024, situata hidrike është në kushte të favorshme dhe si rrjedhojë, shoqëria KESH, sh.a., deri në këtë periudhë ka arritur një situatë pozitive financiare.
- Sa i përket humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike ato rezultuan në nivelin 17.56 për qind për 8M 2024, duke shënuar një rënie të mëtejshme të nivelit të humbjeve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku humbjet rezultonin 19.15 për qind.
- Niveli i arkëtimeve të OSHEE Group, sh.a., për 8M 2024 arriti në nivelin 99.3 për qind, duke rezultuar me një rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ku niveli i arkëtimeve rezultonte në nivelin 97.4 për qind, gjë që dëshmon stabilitetin e shoqërisë në këtë drejtim.

Parashikimet deri në fund të vitit 2024 dhe problematika të tjera

Nisur nga raportimet më të fundit të ndërmarrjeve energjitike, parashikimet për risqet financiare të cilat potencialisht mund të ndikojnë në aktivitetin e sektorit, deri në fund të vitit 2024, janë si më poshtë:

- ✓ **Risku i tregut të energjisë:** Edhe pse fillimi i vitit 2024 i gjen tregjet e energjisë më të stabilizuar krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, situata delikate gjeopolitike, veçanërisht ecuria e konfliktit Rusi-Ukrainë, krijon pasiguri të lartë në projeksionet e çmimit të energjisë në bursë.
- ✓ **Risku hidrik:** Mungesa e prurjeve hidrike për periudhën deri në fund të vitit 2024, rrjedhimisht do të ndikonte negativisht në prodhimin e brendshëm neto të KESH sh.a.
- ✓ **Risku i portofolit të prodhimit:** Ky risk lidhet me mungesën e burimeve të diversifikuara, si dhe me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Diversifikuar të sektorit elektroenergjetik, që ka për synim heqjen e varësisë së vendit nga importet e energjisë dhe kthimin e tij në eksportues neto të energjisë elektrike.
- ✓ **Risku i likuiditetit:** Lidhet potencialisht me ekspozimin ndaj mungesës së likuiditeteve/cashflowë hyrëse në përballimin e detyrimeve, veçanërisht atyre afatshkurtra dhe investimeve, duke ulur aftësinë paguese të shoqërive. Gjithashtu, sa i takon specifikisht shoqërisë OSHEE Group, sh.a., ky risk kushtëzohet kryesisht nga detyrimet e konsiderueshme të trashëguara për shkak të performancës jo të mirë financiare gjatë periudhës 2009-2014. të trashëguara për shkak të performancës jo të mirë financiare gjatë periudhës 2009-2014.
- ✓ **Risku nga ndryshimi në kursin e këmbimit:** Lulatjet në kurset e këmbimit gjatë periudhës në fjalë, kanë ndikim në vlerësimet kontabël të mbylljes së pasqyrave financiare për këtë periudhë.

Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjetik, ML/IB, MF dhe DPT

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, në muajin dhjetor të vitit 2020 u finalizua me sukses plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike. Ky plan masash, sipas urdhrin të përbashkët të MF dhe MIE nr.304/2020 “Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, i vënë në zbatim që prej Janarit 2021 e në vijim, shërben si instrument kryesor për realizimin e një prej elementeve kryesore të reformës në këtë sektor jetik për ekonominë e vendit, siç është arritja e konsolidimit financiar të sektorit elektroenergjetik. Ky plan ofron një seri masash për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe disiplinimin e pagesave ndërmjet kompanive të sektorit energjetik dhe palëve kryesore të lidhura me to. Me qëllim zbatimin me sukses të këtij plani, Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëfirmosën urdhrin e përbashkët nr.379, datë 30.9.2021, “Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike”, që ngarkon ndërmarrjet e sektorit energjetik për raportim mujor mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe statusin e detyrimeve ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë tabelare detyrimet e ndërsjella në sektorin e energjisë elektrike:

Tabela 17 Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarrjeve të sektorit energjetik, ML/IB, MF dhe DPT

Deri në Shtator 2024 (në mld Lekë)	KESH	OST	OSHEE	MF	DPT	Total
KESH ndaj:		0		36.82*		36.82
OST ndaj:	11.15		0.90	8.03*		20.08
OSHEE ndaj:	46.9	8.7		2.76*	4.39*	62.75
Ndërmarrjet UK ndaj:			36.70	10.39*		47.09
ML/IB			6.00			6.00
Total	58.05	8.70	43.60	58.00	4.39	172.73

Burimi: KESH, OST, OSHEE Group, AKUK 2024

*Detyrimet ndaj MF-së dhe DPT-së janë raportuar për periudhën deri më 31.07.2023.

Detyrimet e shoqërive të ujësjellës - kanalizimeve ndaj OSHEE Group, sh.a.

Deri në muajin shtator 2024, OSHEE Group, sh.a., raporton se detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën rreth 36.7 miliardë lekë. Nga të cilat, rreth 21 miliardë lekë janë detyrime të faturuara ndaj kompanisë dhe rreth 16 miliardë lekë janë detyrime për kamatëvonesa. Në tabelën e mëposhtme listohen pesë ndërmarrjet që kanë pjesën më të madhe të detyrimeve (principal pa kamata) ndaj OSHEE Group sh.a, deri në 8-mujorin e parë të vitit 2024:

Tabela 18 Ujësjellësit me stokun më të lartë të detyrimeve të prapambetura (principal pa kamata) ndaj OSHEE Group sh.a për 8M 2024 (në mld lekë).

	(miliardë/lekë)
Ndërmarrjet U-K kryesore me detyrime ndaj OSHEE Group sh.a	9.85
Njësia Durrës UK sh.a	5.64
Njësia Vlorë UK sh.a	1.78
Njësia Patos UK sh.a	0.87
Njësia Fier UK sh.a	0.80
Njësia Kavajë UK sh.a	0.77

Burimi: AKUK 2024

Një problematikë e rëndësishme mbetet stoku i detyrimeve të akumuluar nga ndërmarrjet UK, sh.a., ndaj sektorit të energjisë (OSHEE Group), kryesisht për shkak të performancës së ulët të pjesës më madhe të shoqërive UK, sh.a. Nisur nga sa më sipër, procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të ujit, i

startuar në 2022, vazhdon në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë e Kanalizime 2020-2030. Në zbatim të VKM nr.302/2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, synohet ridimensionimi i 58 ndërmarrjeve U-K aktuale nëpërmjet rigrupimit të tyre në 15 shoqëri SKP-UK (*Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta*) rajonale. Kjo, me qëllim rritjen e mirëmenaxhimit dhe performancës financiare, që pashmangshmërisht do të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme në dobi të mbarëvajtjes së proceseve të punës dhe sidomos shlyerjes së detyrimeve të akumuluar, duke siguruar kështu mos krijimin e tyre në të ardhmen. Ndërkohë, subvencioni nga buxheti i shtetit për sektorin e Ujësjellës-Kanalizimeve i planifikuar në programin përkatës të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për vitin 2024 në vlerën 350 milionë lekë, deri në fund të 8M 2024 ka pasur një realizim faktik në rreth 4 milionë lekë. Ky subvencion shkon kryesisht për ndërmarrjet të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes.

Të tjera ndërmarrje shtetërore (NSH) të monitoruara gjatë 6M 2024:

Përveç sektorit të energjisë, Ministria e Financave monitoron në mënyrë periodike ndërmarrje të tjera shtetërore të cilat kanë impaktin më të lartë financiar për buxhetin e shtetit apo që mund të paraqesin rrisje të konsiderueshme fiskale, duke analizuar mbi baza tremujore performancën e tyre. Referuar analizës mbi raportimin më të fundit të treguesve financiarë të miratuar zyrtarisht për ndërmarrjet shtetërore në monitorim, vlen të veçojmë:

- **UKT sh.a (Ujësjellës- Kanalizime Tiranë sh.a):**

Gjatë T2 2024, të ardhurat e UKT, sh.a., (Ujësjellës- Kanalizime Tiranë) arritën në rreth 2.31 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 1.90 miliardë lekë. Për rrjedhojë, shoqëria regjistroi një fitim neto pozitiv për periudhën prej rreth 411 milionë lekë, duke treguar një vazhdimësi të ecurisë pozitive. Në nivel vjetor, për vitin 2023 nëpërmjet pasqyrave financiare, UKT, sh.a.-ja, ka raportuar se të ardhurat arritën në rreth 5.02 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 3.97 miliardë lekë, duke regjistruar një fitim neto pozitiv prej 1.05 miliardë lekë. Subvencionimi buxhetor për NSH-të e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve për vitin 2023 ishin të planifikuara në vlerën 310 milionë lekë dhe e gjithë vlera prej 310 milionë lekësh është disbursuar në vitin 2023.

- **Hekurudha Shqiptare, sh.a:**

Gjatë T2 2024, të ardhurat e Hekurudhës Shqiptare, sh.a., arritën në rreth 285 milionë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 467 milionë lekë. Për rrjedhojë, shoqëria rezultoi me një humbje neto për periudhën prej rreth 182 milionë lekë, duke vijuar një trend negativ. Në fund të vitit 2023, Hekurudha Shqiptare, nëpërmjet pasqyrave financiare ka raportuar se të ardhurat arritën në rreth 1.04 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 1.05 miliardë lekë, duke regjistruar një humbje neto prej rreth 6 milionë lekë. Subvencionimi buxhetor për Hekurudhën Shqiptare sh.a për vitin 2023 ishte planifikuara në vlerën 490 milionë lekë dhe e gjithë vlera prej 490 milionë lekësh është disbursuar në vitin 2023.

- **AlbGaz sh.a:**

Gjatë T2 2024, të ardhurat e AlbGaz arritën në rreth 4 milionë lekë ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 74 milionë lekë, duke regjistruar një humbje neto për periudhën prej rreth 70 milionë lekësh. Në fund të vitit 2023, të ardhurat e AlbGaz rezultojnë në rreth 65 milionë lekë ndërsa shpenzimet në rreth 396 milionë lekë, me një humbje neto prej 331 milionë lekësh.

- **Albcontrol sh.a:**

Gjatë T2 2024, të ardhurat e Albcontrol arritën në rreth 1.60 miliardë lekë, ndërkohë që edhe shpenzimet e përgjithshme arritën në pothuajse të njëjtin nivel prej rreth 1.60 miliardë lekë, duke rezultuar me një

fitim neto për periudhën në rreth 0.7 milionë lekë. Në fund të vitit 2023, të ardhurat e Albcontrol rezultojnë në rreth 3.31 miliardë lekë ndërsa shpenzimet në rreth 3.28 miliardë lekë, duke regjistruar një fitim neto prej rreth 29 milionë lekësh.

- **Autoriteti Portual Durrës, sh.a. (APD):**

Gjatë T2 2024, të ardhurat e APD arritën në rreth 1.40 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 1.36 miliardë lekë, duke regjistruar një fitim neto për periudhën prej rreth 42 milionë lekë. Në fund të vitit 2023, të ardhurat e APD-së rezultojnë në vlerën rreth 3.06 miliardë lekë ndërsa shpenzimet në rreth 2.82 miliardë lekë, duke rezultuar me një fitim neto prej rreth 235 milionë lekësh.

- **Albpetrol, sh.a:**

Gjatë T2 2024, të ardhurat e Albpetrol, sh.a-së., arritën në rreth 2.76 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 2.75 miliardë lekë, duke regjistruar një fitim neto për periudhën prej rreth 13 milionë lekësh. Në fund të vitit 2023, të ardhurat e Albpetrol, sh.a-së., rezultojnë në vlerën rreth 6.01 miliardë lekë ndërsa shpenzimet në rreth 5.93 miliardë lekë, duke rezultuar me ecuri pozitive dhe me një fitim neto prej rreth 75 milionë lekë lekësh.

Detyrimet Kontingjente

Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ) kryesisht çështje dhe vendime që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët.

- Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së janë të kushtëzuara nga një aftësi e dobët parashikuese, për sa kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve.
- Ministria e Financave ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ-ja përmes zbatimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpimëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonesë për çdo ditë vonesë.
 - ✓ *Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MF ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar sipas mundësive të buxhetit të shtetit skedulimin me këste të detyrimit financiar, në negociim me përfituesit. Edhe për vitin 2024, likuidimi i detyrimeve të këtij lloji përballohet nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit.*
- Sjellim në vëmendje se, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku specifikisht në nenin 19/5 përcaktohen dy mënyra ekzekutimi të shpërblimit:
 - ✓ *Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit përkatës të GJEDNJ-së.*
 - ✓ *Përrjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10.000 (dhjetë mijë) euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.*

Në vijim, paraqitet tabela përmbledhëse e detyrimeve për vendimet e GJEDNJ-së, bazuar në informacionin zyrtar të raportuar pranë Ministrisë së Financave:

Tabela 19: Detyrimet faktike dhe kontingjente nga vendimet e GJEDNJ-së deri në Shtator 2024 (në Euro)²

Vendimet e GJEDNJ	Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM	Detyrimi kontingjent	Totali i detyrimit
Delijorgji kundër Shqipërisë	15,600 €		15,600 €
Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë (Kërkesa: Dhimërtika dhe Nika k. Shqipërisë)	4,417,750 €		4,417,750 €
Sharxhi kundër Shqipërisë	13,447,300 €		13,447,300 €
Iiria S.R.L kundër Shqipërisë	10,800 €		10,800 €
Zela kundër Shqipërisë	60,000 €		60,000 €
Cuni dhe të tjerë kundër Shqipërisë	3,850 €*		3,850 €*
Biba kundër Shqipërisë	16,700 €		16,700 €
Kalemi kundër Shqipërisë	2,351 €**		2,351 €**
Ndreka Sh.P.K kundër Shqipërisë	3,600 €		3,600 €
Sovjani kundër Shqipërisë		3,600 €	3,600 €
Danushi kundër Shqipërisë		5,000 €	5,000 €
Totali	17,955,050 €	8,600 €	17,963,650 €

* Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ-së është 8,650€, por nga ana e MF është likuiduar pjesërisht shuma prej 4,800€.

**Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ-së është 4,700€, por nga ana e MF është likuiduar pjesërisht shuma prej 2,349€.

Burimi: Avokatura e Shtetit, Ministria e Financave (2024)

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy- ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar.

- Duke pasur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit. Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje), të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet ‘shteti shqiptar’ apo ‘qeveria shqiptare’, këto vendime likujdohen përmes buxhetit të MF dhe/ose fondit rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja.

✓ *Ministria e Financave, në vazhdimësi, ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllimin final të lehtësimit, reduktimit dhe/ose shmangies së barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.*

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e detyrimeve për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, bazuar në informacionin që disponon Ministria e Financave.

² Detyrim Faktik është detyrimi i cituar në një vendim përfundimtar të gjykatës së gjednj/arbitrazhit/, i formës së prerë, për të cilin nuk janë finalizuar procedurat juridike brenda shtetit shqiptar.

Detyrim Kontingjent është detyrimi i cituar në një vendim të gjykatës së gjednj/arbitrazhit/, dhe/ose kontrata eventuale të studiove ligjore, për të cilin nuk kanë përfunduar procedurat ligjore.

Tabela 20: Detyrimet faktike dhe kontingjente nga vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar deri në Shtator 2024³

në Euro

Ministria e Linjës	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Detyrimi i mbetur nga vendimet e Arbitrazhit/kosto ligjore (A)	Detyrime Kontingjente (B)	Totali i detyrimit (C=A+B)
MIE/ARRSH	ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH). JV Copri-Aktor vs ARRSH.	42,472,629	0	42,472,629
	Kosto ligjore dhe shpenzime gjyqësore ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH)	225,000	0	225,000
MIE/AKUK	ICC Case 24140/MHM Shoqëria Costruzioni DONDI S.P.A	13,492,241	0	13,492,241
	Kostot administrative, të përfaqësimit dhe kosto ligjore për çështjen ICC Case no.24140/MHM/HBH Costruzioni DONDI S.P.A	28,500	0	28,500
MIE	ICC Case No. 20564/EMT/GR Hydro srl	142,976	0	142,976
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit dhe mbrojtjes së RSH për rrëzimin e kërkesës për rishikimit të vendimit datë 04.06.2019 ICC Case no.22919/GR.	0	111,150	111,150
APD	Kosto administrative dhe ligjore për çështjen ICSID Case no.ARB/20/37 (Durrës Kurum Shipping dhe të tjerë kundër Shqipërisë)	200,000	0	200,000
MIE/APD	Kosto ligjore për çështjen ICSID Case EMS Shipping & Trading GmbH. vs Republikës së Shqipërisë	1,299,998	0	1,299,998
	Kosto administrative ICSID Case EMS Shipping & Trading GmbH. vs Republikës së Shqipërisë	575,000	0	575,000
MIE/AKBN/Albpetrol Sh.a	ICC Case no.22676/GR GBC Oil Company LTD vs MIE, AKBN dhe Albpetrol	12,241,533	0	12,241,533
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit të MIE/AKBN në çështjen ICC Case 21349/EMT/GR (BPAL v MIE/AKBN dhe Albpetrol)	41,110	0	41,110
MF	Kosto paraprake dhe kosto ligjore për çështjen SCC Arbitration 2021/155 IVICOM Holding Gmbh	6,316	0	6,316
	Përfaqësimi i Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit Mimoza Ndroqi kundër RSH	250,000	395,000	645,000
	Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	0	108,000,000	108,000,000
	Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	645,637	949,780	1,595,417
	Total	71,620,940	109,455,930	181,076,870

Burimi: Avokatura e Shtetit, Ministrinë e Linjës/Institucionet Buxhetore, Ministria e Financave (2024)

Vlen të theksojmë se, monitorimi dhe raportimi i vendimeve të GJEDNJ-së dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar është institucionalizuar përmes përfshirjes në udhëzimin plotësues nr.1, datë 24.1.2024, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga ML/IB dhe Avokatura e Shtetit, si edhe të formateve standarde respektive për qëllim analize, transparence dhe raportimi të detyrimeve kontingjente të qeverisjes së përgjithshme.

³ Detyrim Faktik është e detyrimi i cituar në një vendim përfundimtar të gjykatës së gjednj/arbitrazhit/, i formës së prerë, për të cilin nuk janë finalizuar procedurat juridike brenda shtetit shqiptar.

Detyrim Kontingjent është detyrimi i cituar në një vendim të gjykatës së gjednj/arbitrazhit/, dhe/ose kontrata eventuale të studiove ligjore, për të cilin nuk kanë përfunduar procedurat ligjore.

Detyrimet e prapambetura - Bazuar në VKM nr.50, datë 5.2.2014, “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, Ministria e Financave ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura. Vlen për t’u theksuar se tashmë monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore. Duke nisur nga muaji dhjetor 2020, ky monitorim dhe raportim i cili më parë kryhej mbi bazë tremujore nëpërmjet raportimit shkresor të institucioneve, tashmë gjenerohet automatikisht nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të udhëzimit nr.37, datë 6.10.2020, “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”. Ky format i raportimit të detyrimeve të prapambetura, përveçse rrit saktësinë dhe siguron të dhënat në kohë, është gjithashtu një format gjithëpërfshirës duke unifikuar modalitetin e raportimit për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Prioriteti kryesor në periudhën afatmesme të Ministrisë së Financave mbetet reduktimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre. Në vitet e fundit ky objektivi është arritur pasi stoku i detyrimeve të prapambetura ka ndjekur një trend rënës. Nga ana tjetër, vendosja e objektivave specifike ndër vite (p.sh. Mirëqeverisja, vlerësimi ERP dhe PEFA) kanë ndihmuar në mbajtjen nën kontroll dhe reduktimin e stokut të detyrimeve të prapambetura në vitet e fundit.

Për vitin 2023 janë përmbushur të gjithë objektivat në bazë tremujorë dhe vjetorë. Për vitin 2024 objektivat e vendosur janë në bazë vjetore. Për periudhën 6-mujore 2024, stoku i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë rezulton më i ulët, me një rënie prej 46.7%, konkretisht:

Për vitin 2024 objektivat e vendosur (Vlerësimi PEFA dhe ERP) janë në bazë vjetore, si më poshtë:

Objektivat e vendosura për vitin 2024:

Vlerësimi PEFA

- ✓ *Stoku i detyrimeve të prapambetura vjetore nuk kalon 2% të totalit të shpenzimeve, në të paktën dy nga tre vitet e fundit fiskalë. Ky target është arritur, për të paktën dy vitet e fundit (2022 dhe 2023), dhe pritshmëritë janë pozitive për plotësimin e plotë të tij dhe për vitin 2024, me finalizimin e të dhënave vjetore në fund të vitit 2024.*

ERP

- ✓ *Targeti i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin 2024 është vendosur në masën: $\leq 2.0\%$ në nivel vjetor. Për 6-mujorin 2024, objektivi për ERP është në nivelin 1.34%, dhe pritshmëritë janë pozitive për plotësimin e plotë të tij në fund të vitit 2024.*

Deri në fund të muajit qershor 2024, u regjistrua një stok kumulativ prej 9.94⁴ miliardë lekësh i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

- ✓ *Totali detyrimeve të prapambetura të qeverisë qendrore rreth 5.72 miliardë lekë, nga të cilat:*
 - *Investimet zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit rreth 54.8%,*
 - *Vendimet gjyqësore zënë rreth 25.3%,*
 - *Detyrime të prapambetura të tjera⁵ zënë rreth 7.8%,*
 - *Mirëmbajtje me rreth 3.8%,*
 - *Detyrimet për sigurimet shoqërore me rreth 2.7%,*

⁴ Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës Kanalizime dhe Universiteteve

⁵ Në zërin detyrime të tjera përfshihen: Energjia elektrike, Paga, Shpronësime, Transferta për individët, Transferta për subjektet, të tjera.

- Shërbimet me rreth 2.1%,
 - Rimbursimi i TVSH-së 1.3%,
 - Mallra me rreth 1.0%,
 - Të ardhurat personale me rreth 0.7%,
 - Detyrimet për sigurimet shëndetësore me rreth 0.3%.
- ✓ Totali detyrimeve të prapambetura të qeverisë vendore rreth 4.22 miliardë lekë, nga të cilat:
- Investimet zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit me rreth 45.8%,
 - Detyrime të prapambetura të tjera me rreth 24.5%,
 - Shërbime me rreth 12.6%,
 - Vendimet gjyqësore rreth 8.9%,
 - Mallra me rreth 3.9%,
 - Mirëmbajtje rreth 2.7%,
 - Detyrimet për sigurimet shoqërore me rreth 1.1%,
 - Të ardhurat personale me rreth 0.4%,
 - Tatime të tjera me rreth 0.1%,
 - Detyrimet për sigurimet shëndetësore me rreth 0.1%.

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për 3M 2024, rezulton se:


- ✓ Niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 0.85 miliardë lekë më i lartë. Konkretisht, totali i detyrimeve të njërive të qeverisjes qendrore është rritur me rreth 2.14 miliardë lekë dhe totali i detyrimeve të njërive të qeverisjes vendore është ulur me rreth 1.28 miliardë lekë.
- ✓ Për periudhën 6-mujore 2024, ashtu si në periudhën 6-mujore 2023, nuk rezultojnë detyrime për rimbursimin e TVSH-së.

Ndonëse krahasuar me 3M 2024, ka pasur një rritje të stokut total të detyrimeve të prapambetura, vlen të përmendet se objektivat e vendosur në fillim të vitit (vlerësimi PEFA, dhe ERP) janë të mirëpozicionuar për përmbushjen e tyre deri në fund të vitit 2024. Detyrimet e prapambetura të qeverisë së përgjithshme për 6-mujorin 2024 si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin 2024 qëndrojnë në 1.34% dhe pritshmëritë janë pozitive që ky objektivi të qëndrojë nën 2% deri në fund të vitit fiskal 2024, duke përmbushur në këtë mënyrë të gjithë objektivat vjetorë.

8. VEPRIMTARITË POTHUAJSE FISKALE

Në fund të muajit qershor 2024, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 36.5 miliardë lekë ose 2.7% e portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore, duke shënuar një rënie me 4.8 miliard lekë krahasuar me fundin e vitit 2023. Garancitë në tregun e brendshëm zënë rreth 41.2% të stokut total të borxhit të garantuar ose 15.0 miliardë lekë, ndërsa garancitë e dhëna në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 58.8% të stokut të borxhit të garantuar ose 21.5 miliardë lekë.


Figura 6: Portofoli i borxhit të garantuar sipas rezidencës së kreditorit (2019–Qershor 2024)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Rreth 79% e totalit të garancive shtetërore i përkasin sektorit të energjisë, duke reflektuar politikat e qeverisë në drejtim të mbështetjes së sektorit të energjisë.

Figura 7: Garancitë shtetërore sipas sektorëve ekonomikë (2019–Qershor 2024)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

9. SHTOJCA ILUSTRUESE

9.1 TREGUESIT E PËRZGJEDHUR MAKROEKONOMIKË DHE FISKAL

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit (inflacioni) në muajin shtator 2024 shënoi +1.9%, një vit më parë ky ndryshim ishte +4.1%. Ndryshimi mujor i inflacionit në muajin shtator 2024, krahasuar me një muaj më parë, ishte +0.6%. Inflacioni mesatar për periudhën janar - shtator 2024 është +2.3%.


Figura 8: Ndryshimi vjetor i inflacionit (në përqind)



Burimi: Instat, Tetor 2024

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) shënoi nivelin 112.5 në muajin shtator 2024, duke u rritur me 0.6 pikë përqindje krahasuar me muajin e kaluar dhe u rrit me 3.6 pikë përqindje në krahasim me të njëjtën periudhë të një vit më parë. Megjithatë, niveli aktual i TNE-së qëndron rreth 12 pikë përqindje mbi mesataren historike. Rritja e TNE-së në këtë muaj u përcaktua nga rritja e besimit në sektorët e industrisë, të ndërtimit dhe të shërbimeve. Nga ana tjetër, besimi në sektorin e tregtisë regjistroi rënie të lehtë, ndërsa besimi konsumator mbeti në të njëjtin nivel me atë të muajit të kaluar.


Figura 9: Treguesi i Ndjesisë Ekonomike



Burimi: Banka e Shqipërisë, Tetor 2024

Indeksi i tregtisë me pakicë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 në terma *Volumi*, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm u rrit me 5.9%. Indeksi i tregtisë me pakicë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 në terma *Vlere*, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm, u rrit me 7.8%

Figura 10: Rritja e vlerës të tregtisë me pakicë (vit-më-vit, në %)



Burimi: Instat, Korrik 2024

Lidhur me të dhënat më të fundit të tregtisë së jashtme, në muajin gusht 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 22 miliardë lekë, duke rënë me -18.2%, në terma vjetorë dhe me një rënie prej -32.5% në terma mujor. Importet e mallrave arritën vlerën 69 miliardë lekë, duke u rritur në terma vjetorë me 1.9%, dhe me një rënie prej -19.4%, në krahasim me muajin korrik 2024. Efekti i çmimeve në rënie, i kombinuar me atë të kursit të mbiçmuar të këmbimit, vijon të jetë një faktor mbështetës i kësaj ecurie. Deficiti tregtar i këtij muaji është 46 miliardë lekë, duke u rritur me 15.6%, krahasuar me muajin gusht 2023, dhe duke u ulur me -11.0%, në krahasim me muajin korrik 2024.

Në këtë tetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 255 miliardë lekë, duke u tkurrur me 14.9% krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 595 miliardë lekë, duke u rritur me 3.2%, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 340 miliardë lekë, duke u rritur me 22.5%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023.

Tabela 21: Eksportet dhe importet në vlerë për periudhën janar-gusht 2024 (krahasuar me të njëjtën periudhë të viti më parë).


	Eksporte		Importe	
	Rritja (në %) mujore	Kontributi në rritje (në pikë %)	Rritja (në %)	Kontributi në rritje (në pikë %)
Ushqime, pije, duhan	-8.8	-1.1	9.1	1.5
Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike	-27.6	-6.4	-10.2	-1.2
Produkte kimike dhe plastike	1.7	0.1	0.0	0.0
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	-26.6	-0.2	-16.9	-0.3
Prodhime druri dhe letre	-12.1	-0.3	0.5	0.0
Tekstile dhe këpucë	-17.8	-5.1	-8.6	-0.9
Materiale ndërtimi dhe metale	-9.1	-1.6	2.7	0.4
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	-7.1	-0.6	12.0	2.9
Të tjera	12.2	0.3	14.7	0.6
Gjithsej	-14.9	-14.9	3.1	3.1

Burimi: Instat, Shtator 2024

Gjatë muajit gusht të vitit 2024 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rritje me 3.7% krahasuar me muajin gusht të vitit 2023. Stoku total i depozitave në lekë pësoi rritje me 9.8%, ndërsa ai në valutë ka pësuar rënie me 0.8% krahasuar me muajin gusht të vitit 2023.

Gjatë muajit gusht të vitit 2024, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 12.1%, krahasuar me muajin gusht të vitit 2023. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 17.8%, ndërsa ai në valutë rritje prej 5.2%, krahasuar me muajin gusht të vitit të kaluar.

Figura 11: (a) Ecuria e rritjes së stokut total të depozitave, në %, në terma vjetorë; (b) Ecuria e rritjes së stokut total të kredive, në %, në terma vjetorë.




Burimi: Banka e Shqipërisë, Shtator 2024

Standardet e kreditimit për bizneset nuk patën ndryshim në tremujorin e dytë të vitit 2024. Standardet u raportuan të pandryshuara në kreditë për financimin e investimeve dhe në ato për mbulimin e nevojave për likuiditet. Sipas madhësisë së biznesit, standardet u lehtësuan disi për segmentin e biznesit të vogël e të mesëm, dhe u mbajtën të pandryshuara në kreditë për biznesin e madh.

Ndërkohë, *standardet për kredinë dhënë individëve* gjatë tremujorit të dytë 2024 për blerje banese u shtrënguan në nivelin 4.4%, ndërsa për kredinë dhënë individëve për konsum gjatë tremujorit të dytë 2024 u shtrënguan në nivelin 5.5%.

Figura 12: (a) Lehtësimi (+) Shtrëngimi (-) Standardeve Kredisë për Biznesin - [Investime]; b) Lehtësimi (+) Shtrëngimi (-) Standardeve të Kredisë për Individët - [Konsum]



Burimi: Banka e Shqipërisë (Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues – T2/2024)

9.2 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 8-MUJORIT 2024

Të ardhurat tatimore totale për 8-mujorin 2024 u realizuan në vlerën 463,8 miliardë lekë, 9.1% ose 38.5 miliardë lekë më shumë se 8-mujori i vitit 2023. Nga totali i të ardhurave, të ardhurat e arkëtuara nga “tatimet dhe doganat” përfshirë kontributet e mbledhura për 8-mujorin 2024, u realizuan në vlerën 409.6 miliardë lekë, 10.4% ose 38.5 miliardë lekë më shumë se 8-mujori 2023 dhe 3% ose 11.9 miliardë lekë më shumë se plani fillestar 8- mujor i vitit 2024.

Tabela 22 Performanca Tatime+Dogana dhe Kontributet Janar-Gusht 2024

(në milionë lekë)

Lloji i taksave	Fakt 8M 2024	Plan Fillestar 8M 2024	Diferenca Fakt/Plan fillestar 2024	
			në vlerë	në %
1. TVSH Neto TOTAL	140,794	138,654	2,140	1.54%
<i>a. Tvsh në import</i>	102,894	102,867	27	0.03%
<i>b. Tvsh brenda vendit Neto</i>	37,900	35,787	2,113	5.90%
<i>c. Rimbursim TVSH</i>	16,411	11,700	4,711	40.26%
2. Tatimi mbi fitimin	39,232	35,264	3,968	11.25%
3. Akciza	41,888	41,568	320	0.77%
4. Tatimi mbi të ardhurat personale	44,864	44,306	558	1.26%
5. Taksat Nacionale Total	31,886	29,110	2,776	9.54%
<i>a. Taksat nacionale</i>	29,988	27,003	2,985	11.06%
<i>b. Renta Minerare në eksport</i>	1,898	2,107	-209	-9.92%
6. Taksë doganore	5,985	5,816	169	2.91%
TOTAL TATIME + DOGANA	304,650	294,718	9,932	3.37%
7. Kontributet e mbledhura	104,965	102,960	2,005	1.95%
TOTAL DPD + DPT+ Kontribute	409,615	397,678	11,937	3%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në performancën e 8-mujorit kundrejt planit janë:

- Niveli i lartë i rritjes së tvsh-së bruto të mbledhur brenda vendit, ku evidentohet sektori i tregtisë me rritje 33%, sektori i transportit me rritje 34% si dhe sektori i prodhimit me rritje 22%. Rimbursimet e dhëna janë 4.7 miliardë lekë më shumë se planifikimi dhe 4.2 miliardë lekë më shumë se viti i kaluar.
- Rritja e sasive të karburanteve me 26.9 mijë tonë më shumë se 8-mujori i vitit të kaluar;
- Rritja e të ardhurave nga akciza nga zbatimi i kalendarit të normës dhe indeksimit dhe rritja e sasive për konsum i duhanit me 121 tonë, me efekt 1,6 miliardë lekë më shumë se 8-mujori 2023;
- Rritje e ndjeshme e tatimit mbi të ardhurat nga sektori publik (+22.3%) dhe privat (+14.6%) në krahasim me 8-mujorin 2023, si rezultat i reformës së rritjes së pagave të administratës;
- Rritja e të ardhurave nga interesat me 54% si rezultat i rritjes së interesave të BSH;
- Rritje e të ardhurave nga shitja e pasurisë së paluajtëshme me 17.1% si rezultat i aplikimit të çmimeve të referencës;
- Taksa nacionale, rezulton me rritje nga viti paraardhës kryesisht për zërat kryesorë si: taksa e qarkullimit me rritje 9%, taksa për automjetet e përdorura të transportit me rritje 13% si dhe taksa e karbonit me rritje 20%;
- Efekti negativ i kursit të këmbimit në të ardhurat doganore, merreth **minus 12 miliardë lekë** për 8-mujorin 2024, referuar analizave të administratës doganore. Në rast se nuk do të ishte efekti i kursit të këmbimit, këto të ardhura të munguara do të ishin të ardhura shtesë nga administrata doganore.
- Ulja e çmimit të energjisë elektrike me efekt në të ardhura **-1.4 miliardë lekë**.

Të ardhurat doganore

Të ardhurat doganore (të ardhurat nga TVSH në import, akciza, taksa doganore dhe renta minerare) u realizuan në vlerën 152.7 miliardë lekë, 11.3 miliardë lekë ose 8% më shumë se 8-mujori 2023, si dhe 1.2 miliardë lekë ose 0.8% më shumë se plani i të ardhurave doganore për 8-mujorin e vitit 2024.

Sipas analizës së 60 grup-mallrave, 57% të kontributit në totalin e të ardhurave doganore për periudhën janar-gusht 2024 e zënë 5 produkte dhe përkatësisht:

- ✓ Karburanti total (import+vendi) 26%;
- ✓ Cigare&duhan në total 15%;
- ✓ Metalet bazë dhe artikujt bazë 7%;
- ✓ Automjete të përdorura 6% ;
- ✓ Ushqime të përgatitura 3%.

Të ardhurat nga **TVSH në import** për 8-mujorin rezultojnë 102.9 miliardë lekë, 7.6 miliardë lekë ose 8% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, si dhe 472 milionë ose 0.5% më shumë se plani për 8-mujorin 2024.

Gjatë 8-mujorit 2024, nga 60 grup-produktet doganore me efekt pozitiv në të ardhurat e TVSH-së krahasuar me 8-mujorin e vitit 2023 janë:

- Automjete të përdorura dhe të reja, me efekt në të ardhura +1.8 miliardë lekë, ose +30%.
- Metalet bazë dhe artikujt prej tyre, me efekt në të ardhura +893 milionë lekë ose 11%.
- Karburantet, me efekt në të ardhura nga TVSH me +852 milionë lekë ose 6.3%
- Cigaret, me efekt në të ardhura +560 milionë lekë, ose 13.7%;
- Automjete të reja, me efekt në të ardhura +330 milionë lekë, ose 25%.
- Detergjentë, parfumeri, me efekt në të ardhura +363 milionë lekë ose 13%;
- Fruta Perime, me efekt në të ardhura +260 milionë lekë ose 20%;

Nga 60 grup-produktet doganore me efekt negativ në të ardhurat e TVSH-së janë:

- ✓ Energjia elektrike, me efekt negative në tvsh me -1.4 miliardë lekë ose -56%.
- ✓ PC. Kompjuter printer fotokopje dhe pjesët; bojra printimi, me efekt negative në tvsh me -183 milionë lek ose -22.2%.
- ✓ Telefona celularë, me efekt negativ në Tvsh prej -54 milionë lekësh ose -19%.
- ✓ Qelqi, me efekt negative në tvsh me -42 milionë lek ose -6%.

Të ardhurat nga **akciza** janë realizuar në masën 41.9 miliardë lekë, 3.7 miliardë lekë ose 9.8% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023, si dhe 646 milionë lekë ose 1.6% më shumë se plani i akcizës për 8-mujorin 2024.

Ndikim të rëndësishëm pozitiv në të ardhurat nga akciza krahasuar me 8-mujorin e vitit 2023 kanë pasur produktet:

- ✓ Karburant në import, me një rritje 41.5 mijë tonë (+9.4%) më shumë se viti i kaluar, me efekt në të ardhura nga akciza me rreth 2.2 miliardë lekë më shumë ose 12.3%.
- ✓ Cigare duhan ne total me një rritje 156 tonë, (+8%) më shumë se viti i kaluar, me efekt në të ardhura +1.6 miliardë lekë, ose 11.3%.

Ndër produktet e akcizueshme që kanë ndikim negativ janë:

- ✓ Karburant prodhim vendi me ulje prej -5,614 tonë krahasuar me një vit më parë, me efekt negativ në akcizë me -207 milionë lekë.
- ✓ Pije Alkoolike prodhim vendi, me një rënie prej -102 mijë litra me efekt negativ në akcizë me -38 milionë lek.

Të ardhurat nga **renta minerare** në eksport janë realizuar në vlerën 1.9 miliardë lekë, 132 milionë ose 6.5% më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe realizim në masën 93.2% kundrejt planit për 8-mujorin 2024.

- Të ardhurat nga renta minerare e naftës bruto janë 1.4 miliardë lek ose -156 milionë lek më pak se renta e 8-mujorit të vitit 2023. Krahasuar me vitin e kaluar, të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto kanë pësuar rënie si rezultat i uljes së sasisë së prodhimit të naftës bruto e cila për 8-mujorin 2024 është 14.6 % më pak se viti i kaluar me efekt në të ardhura -220 milionë lek, por renta për njësi e naftës bruto ka shënuar rritje nga 3.95 lekë/ton në 8-mujorin 2023 në 4.15 lekë/ton në 8-mujorin 2024, me efekt +64.4 milionë lekë.
- Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara janë realizuar në masën 574 milionë lek nga 496 milionë lek në 8-mujorin e vitit 2023, me rritje +78 milionë lekë. Ndikim pozitiv ka pasur renta për njësi e cila ka shënuar rritje nga 0.39 lekë/ton në 8-mujorin 2023 në 0.44 lekë/ton në 8-mujorin 2024. Kjo ka sjellë një efekt në të ardhura me 69.4 milionë lekë më shumë.
- Gjithashtu, sasia e eksportuar e minerale të tjera është rritur me 1.8% për 8-mujorin krahasuara me 8-mujorin 2023

Të ardhurat nga **taksat doganore** janë arkëtuar në vlerën 6 miliardë lekë, 97 milionë lekë ose 1.6% më shumë se 8-mujori 2023, si dhe realizim në masën 103.2% kundrejt planit.

Peshën më të madhe në taksën doganore e zënë produktet si: mishi (11%), veshjet e këmbës dhe kokës (11%), fruta dhe perime (8%) dhe elektro shtëpiake (7%).

II. Të ardhurat tatimore

Të ardhurat tatimore (të ardhurat nga TVSH neto në vend, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat personale dhe taksat nacionale) për 8-mujorin 2024 u realizuan në masën 152 miliardë lekë, +16.5 miliardë lekë ose 12.2% më shumë se 8-mujori i vitit të kaluar, si dhe 6.7 miliardë lekë, ose 4.6% më shumë se plani i 8-mujorit 2024.

Të ardhurat nga **TVSH-ja e arkëtuar(neto)** u realizua në masën 37.9 miliardë lekë, 7 miliardë lekë ose 22.7% më shumë se 8-mujori 2023, si dhe 1.2 miliardë lekë ose 3.3% më shumë se plani i TVSH-së për t'u arkëtuar në 8-mujorin 2024.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave të Tvsh-së brenda vendit krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë:

- TVSH-ja e rritur si rezultat i miradminstrimit tatimor.
- Rritja e të ardhurave nga turizmi dhe të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë që lidhen drejtpërdrejt ose indirekt me turizmin të cilat ndikuan pozitivisht në rritjen ekonomike dhe në të ardhurat që ekonomia ka krijuar për buxhetin e shtetit.

Të gjithë sektorët bazë të ekonomisë kanë rritje në të ardhurat për Tvsh bruto.

TVSH bruto sipas sektorëve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë:

- Në sektorin e tregtisë, TVSH bruto për periudhën janar – gusht 2024 është 16.9 miliardë lekë, me një rritje prej 33% ose 4.2 miliardë lek më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023.
- Në sektorin e shërbimeve TVSH bruto për periudhën janar – gusht 2024 është 17 miliardë lekë, me një rritje prej 20% ose 2.8 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023.
- Në sektorin e prodhimit TVSH bruto për periudhën janar – gusht 2024 është 10.5 miliardë lekë, me një rritje prej 22% ose 1.8 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023.
- Në sektorin e ndërtimit TVSH bruto për periudhën janar – gusht 2024 është 8.7 miliardë lekë, me një rritje prej 29% ose 2 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023.
- Në sektorin e transportit TVSH bruto për periudhën janar – gusht 2024 është 1.4 miliardë lekë, me një rritje prej 34% ose 350 milionë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023.

Rimbursimet për periudhën 8-mujore 2024 janë 16.4 miliardë lekë, 4.2 miliardë lekë ose 33.9% më shumë se 8-mujori 2023, si dhe 4.7 miliardë lekë ose 40.3% më shumë se plani i rimbursimit të TVSH-së për 8-mujorin 2024.

Të ardhurat e mbledhura nga **tatimi mbi fitimin** u realizuan në masën 39.2 miliardë lekë, 1.7 miliardë lekë, ose 4.1% më pak se 8-mujori 2023, si dhe 2.2 miliardë lekë ose 5.8% më shumë se plani i 8-mujorit të vitit 2024 për tatimin mbi fitimin. Kjo për arsye se 8-mujori 2023 përmban edhe taksën e kontributit të solidaritetit gjatë kohëzgjatjes së krizës energjetike, ku të ardhura shtesë nga ky kontribut ishin në vlerën 4.1 miliardë (one-off) lek. Duke e zhveshur këtë shumë,

- Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 8-mujorin 2024 janë 2.4 miliardë lekë ose 6.6% më shumë se 8-mujori 2023;
- Krahasuar me planin, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 8-mujorin janë 2.2 miliardë lekë ose 5.8% më shumë.

Nga analiza e tatimit mbi fitimin sipas sektorëve krahasuar me një vit më parë rezulton se të gjithë sektorët kanë ecur më mirë se vitin e kaluar, me përjashtim të sektorit të tregtisë:

- Në sektorin e prodhimit të ardhurat për periudhën janar – gusht 2024 janë 12.6 miliardë lekë, me një rritje në të ardhura 20% ose 2.1 miliardë lekë më shumë se 8-mujori i vitit 2023.
- Në sektorin e shërbimeve të ardhurat për periudhën janar – gusht 2024 janë 11.6 miliardë lek me rritje në të ardhura 9% ose 976 milionë lek më shumë se 8-mujori i vitit 2023.
- Në sektorin e tregtisë të ardhurat për periudhën janar – gusht 2024 janë 9.2 miliardë lekë, me një ulje në të ardhura -3% ose -305 milionë lek më pak se 8-mujori i vitit 2023.
- Në sektorin e ndërtimit të ardhurat për periudhën janar – gusht 2024 janë 4.8 miliardë lekë, me një rritje në të ardhura 8% ose 365 milionë lekë më shumë se 8-mujori i vitit 2023.
- Në sektorin e transportit të ardhurat për periudhën janar – gusht 2024 janë 1.4 miliardë lekë, me një rritje në të ardhura 31% ose 334 milionë lekë më shumë se 8-mujori 2023.

Tatimi mbi të ardhurat personale është arkëtuar në vlerën 44.9 miliardë lek, 5.5 miliardë lek ose 14.1% më shumë se 8-mujori 2023, si dhe 449 milionë lek ose 1% më shumë se plani i 8-mujorit 2024.

Ndikimin kryesore për periudhën Janar – Gusht 2024 në tatimin mbi të ardhurat personale e kanë zërat kryesore si:

- Të ardhurat nga tatimi mbi pagën nga sektori privat u realizuan në shumën 16.2 miliardë lekë, me

rritje +14.6% në krahasim me 8-mujorin 2023

- Të ardhurat nga tatimi mbi pagën nga sektori publik u realizuan në shumën 9.9 miliardë lekë, me rritje +22.3% në krahasim me 8-mujorin 2023, rritje e cila reflekton rritjen e pagave të ndërmarrë në mesin e vitit të kaluar;
 - Të ardhurat nga interesat në shumën 1.2 miliardë lekë, me rritje mbi 54% në krahasim me vitin e kaluar si rezultat i rritjes së normës së interesit;
 - Të ardhurat nga tatimi nga shitja e pasurisë së paluajtëshme u realizuan në shumën 4 miliardë lek, me rritje +17.1% si rezultat i aplikimit të çmimeve të referencës.
- Gjithashtu, krahasuar me 8-mujorin 2023, konstatohet rritje me 23.4% e të ardhurave nga tatimi mbi deklaratën individuale vjetore si dhe rritje 17.2% e tatimit mbi të drejtën e autorit në krahasim me 8-mujorin 2023;

Nga analiza e tatimit mbi të ardhurat personale sipas sektorve për 8-mujorin 2024 rezultojnë:

- Sektori i shërbimit me gjenerimin më të lartë në të ardhura për periudhën me vlerë 18 miliardë lekë për vitin 2024 ose sa 69% e totalit të arkëtuar.
- Sektori i prodhimit me të ardhura 3.3 miliardë lekë ose sa 13% e totalit të arkëtuar
- Sektori i tregtisë me të ardhura 2.8 miliardë lekë ose sa 11% e totalit të arkëtuar.
- Sektori i ndërtimit me të ardhura 1.1 miliardë lekë ose sa 4.2% e totalit të arkëtuar.
- Sektori i transportit me të ardhura 745 milionë lekë ose sa 2.9% e totalit të arkëtuar.

Taksat nacionale, për periudhën 8-mujore 2024 u realizuan në masën 30 miliardë lekë, 5.7 miliardë lekë ose 23.3% më shumë se 8-mujori 2023, si dhe 2.9 miliardë lekë ose 10.7% më shumë se plani për 8-mujorin 2024.

Ndikim të rëndësishëm në arketime nga taksat nacionale për 8-mujorin 2024 kanë rezultuar:

- Taksa e qarkullimit me të ardhura në masën 13.7 miliardë lek me një rritje nga viti i kaluar me 1.2 miliardë lekë ose 9% më shumë se 8-mujori i vitit 2023, si rezultat i rritjes së sasive të karburantit.
- Të ardhurat nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit u realizuan në shumën 4.4 miliardë lekë me një rritje nga viti i kaluar me 519 milionë lekë ose 13% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023.
- Taksa e karbonit u realizuan në masë 1.9 miliardë lekë me një rritje nga viti i kaluar me 323 milionë lekë ose 20% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2023, si rezultat i rritjes së sasive të karburantit.

III. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mblidhen nga administrata tatimore për të punësuarit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) për derdhjen e kontributeve vullnetare nga fermerët dhe F.S.D.K.SH që paguajnë në mënyrë vullnetare.

Për periudhën 8- mujore, janar-gusht 2024, të ardhurat e mbledhura nga **kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore**, u realizuan në masën **105** milionë lekë, nga të cilat 91,031 milionë lekë sigurime shoqërore dhe 13,934 milionë lekë sigurime shëndetësore.

Krahasuar me 8-mujorin 2023, janë mbledhur 10,664 milionë lekë ose 11.3% më shumë. Krahasuar me planin për 8-mujorin 2024, të ardhurat u realizuan në masën 1,298 milionë lekë ose 1.3% më shumë se planifikimi.

Realizimi i të ardhurave është paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 23

në milionë lek

Emërtimi	Plani Janar -Gusht 2024	Fakt Janar-Gusht 2024	Diferenca Fakt/Plan
Totali	103,667	104,965	1,298
Sigurime shoqërore	90,105	91,031	926
Sigurime shëndetësore	13,562	13,934	372

Administrata tatimore mbledh 96% të totalit të të ardhurave nga kontributet. Rritja e të ardhurave në kontributet e sigurimeve mbështetet në këta faktorë:

- indeksimi i nivelit të pagave në sektorin publik si dhe rritja e pagave në administratën publike;
- rritja e pagës minimale në shkallë vendi.

Sektorët me pjesën më të madhe në të ardhurat nga kontributet që mbledh administrata tatimore janë:

- sektori i shërbimeve me 59.7% të arkëtuar ndaj totalit për 8-mujorin e vitit 2024,
- sektori i tregtisë me 15.5% të arkëtuar ndaj totalit për 8-mujorin e vitit 2024;
- sektori i prodhimit 15.3% të totalit për periudhën 8-mujore për vitin 2024.

9.3 TË ARDHURAT E PRITSHME PËR VITIN 2024

Të ardhurat tatimore të buxhetit në vitin 2024 janë impaktuar pozitivisht nga rritja ekonomike e qëndrueshme dhe konstante, e cila pritet të jetë rreth 3.9%, bazuar kjo në rritjen kryesisht të sektorëve të turizimit, ndërtimit etj. Njëkohësisht, politikat në fushën e pagave, kanë rritur flukset hyrëse në buxhetin e shtetit. Të ardhurat tatimore nga tatimet doganat dhe sigurimet për vitin 2024, pritet të jenë 617.7 miliardë lekë, sipas aktit normativ nr.3, datë 28.8.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

Tabela 24

(në milionë lekë)

Lloji i taksave	Plan fillestar AN, nr. 2 2024	Plani i rishikuar sipas AN, nr.3 29.8.2024	Diferenca i Pritshmi/Plan fillestar	Në %
TVSH Neto	211,203	213,806	2,603	1.2%
Tatimi mbi fitimin	53,679	59,719	6,040	10.1%
Akciza	63,602	64,375	773	1.2%
Tatimi mbi të ardhurat personale	65,206	64,438	-768	-1.2%
Taksat Nacionale Total	44,292	47,555	3,263	6.9%
Taksë doganore	9,021	9,328	307	3.3%

TOTAL TATIME + DOGANA	447,003	459,221	12,218	2.66%
Kontributet e mbledhura	156,720	158,458	1,738	1.1%
TOTAL DPD + DPT + (Kontributet)	603,723	617,679	13,956	2.26%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Pritshmëria e të ardhurave nga administrata doganore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2024 janë vlerësuar mbi bazën e performancës së të ardhurave në periudhën janar-gusht 2024, si dhe të faktorëve që do të ndikojnë në muajt në vijim.

Tabela 25

(në milionë lekë)

Lloji i taksave	Plan fillestar 2024	Plani i rishikuar sipas AN, nr.3 29.8.2024	Diferenca i Pritshmi/Plan fillestar	Në %
Tvsh në import	158,000	158,566	566	0.4%
Akciza	63,602	64,375	773	1.2%
Renta Minerare në eksport	3,000	2,702	-298	-11%
Taksë doganore	9,021	9,328	307	3.3%
TOTAL DOGANA	233,623	234,971	1,348	-6.4%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Performanca e të ardhurave nga TVSH-ja në import pritet të arkëtohen 158.6 miliardë lekë nga 158 miliardë lekë që ishte planifikuar me buxhetin fillestar.

Në të ardhurat nga akciza pritet të arkëtohen mbi 64.4 miliardë lekë ose 773 milionë lekë më shumë.

Në të ardhurat nga “Renta minerare” pritet të arkëtohen 2.7 miliardë.

Të ardhurat nga taksa doganore për 12-mujorin 2024 pritet të jetë deri 9.3 miliardë lekë.

Pritshmëria e të ardhurave nga administrata tatimore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2024 janë vlerësuar mbi bazën e performancës gjatë periudhës Janar-Gusht 2024. Të ardhurat e pritshme për vitin 2024 pritet të jenë 224.3 miliardë lekë.

Tabela 26

(në milionë lekë)

Lloji i taksave	Plan fillestar 2024	Plani i rishikuar sipas AN, nr.3 29.8.2024	Diferenca i Pritshmi/Plan fillestar	Në %
Tvsh brenda vendit Neto	53,203	55,239	2,036	3.7%
Rimbursim TVSH	18,000	22,636	4636	20.5%
Tatimi mbi fitimin	53,679	59,719	6,040	10.1%
Tatimi mbi të ardhurat personale	65,206	64,438	-768	-1.2%
Taksat nacionale	41,292	44,853	3,561	7.9%
TOTAL TATIME	213,380	224,250	10,870	4.9%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Në tatimin mbi vlerën e shtuar brenda vendit pritet të arkëtohen 55.2 miliardë lekë me realizim në masën 103.7% kundrejt planit fillestar ose 2 miliardë lekë më shumë. Rimbursimi i TVSH-së parshikohet 22.6 miliardë lekë.

Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin pritet të realizohen në masën 59.7 miliardë lek, me realizim në masën 110.1% kundrejt planit fillestar, ose 768 miliardë lek më shumë.

Tatimi mbi të ardhurat personale pritet të realizohen në masën 64.4 miliardë lek, me realizim në masën 98.8% kundrejt planit fillestar, ose 768 milionë lek më pak.

Të ardhurat nga taksa nacionale pritet të realizohen në masën 44.9 miliardë lek, me realizim në masën 107.9% kundrejt planit fillestar, ose 3.6 miliardë lek më shumë.

Nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore priten të arkëtohen 158.5 miliardë lekë, 1.7 miliardë lekë ose 1.1% më shumë se në planifikimin e tyre në buxhetin fillestar.

Tabela 27

(në milionë lekë)


Lloji i taksave	Plan fillestar 2024	Plani i rishikuar sipas AN, nr.3 29.8.2024	Diferenca i Pritshmi/Plan fillestar	Në %
Kontributet	156,720	158,458	1,738	1.1%

9.4 ANALIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN JANAR-SHTATOR 2024

9.4.1 BUXHETI QENDROR

Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 8- mujore të vitit 2024 arritën në rreth 406 miliardë lekë me një realizim në masën 93.2 për qind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ky zë ka rezultuar 7.4 për qind më i lartë ose rreth 28.1 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 8- mujorin e vitit 2024 u realizuan në masën 55.1 për qind të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 52.6 për qind të planit vjetor sipas aktit normativ nr.3, datë 28.8.2024 (AN nr.3).

Figura 13: Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (miliardë LEK) dhe ritmi i rritjes për periudhën 8 mujore (në %)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

a. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike

Shpenzimet korrente dhe ato kapitale, për periudhën 8-mujore kanë shënuar një realizim respektivisht:

- ✓ Shpenzimet korrente 95.1% të planit të periudhës dhe 58.9% të planit vjetor sipas AN nr.3.
- ✓ Shpenzimet kapitale 81.9% të planit të periudhës dhe 28.0% të planit vjetor sipas AN nr. 3.

Figura 14: Shpenzimet korrente dhe kapitale fakt dhe plan 8 mujor (në milionë LEK)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet korrente për periudhën 8 mujore të vitit 2024 rezultuan në rreth 363.9 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 8.4% më i lartë ose rreth 28.2 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet korrente për muajin e 8 të vitit 2024 zënë 89.6% të totalit të shpenzimeve ndërkohë që, krahasuar me PBB zënë 14.9%. Për shpenzimet korrente, për periudhën 8-mujore ndër vite, raporti kundrejt PBB-së ka një nivel mesatar prej 15.2%.

Shpenzimet kapitale për periudhën 8- mujore të vitit 2024 paraqesin një realizim në masën rreth 42.1 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ky zë rezulton 0.1% më i lartë ose rreth 46 milionë lekë më shumë. Shpenzimet kapitale për muajin e 8 të vitit 2024 zënë 10.4% të totalit të

shpenzimeve ndërkohë që, krahasuar me PBB-në zënë 1.7%. Për shpenzimet kapitale, për periudhën 8- mujore ndër vite, raporti kundrejt PBB-së ka një nivel mesatar prej 2.6%.

Figura 15: Struktura e shpenzimeve të përgjithshme dhe raporti me PBB-në për periudhën 8 mujore




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet korentë në raport me planin 8 mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej 95.1%, duke rezultuar në rreth 363.9 miliardë lekë. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korentë kundrejt planit 8- mujor janë përkatësisht:

- ✓ *Shpenzimet për fonde speciale me 97.9% të planit të periudhës dhe 61.9% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe AN nr.3.*
- ✓ *Shpenzimet operative mirëmbajtje me 95% të planit të periudhës, 54.1% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 50.2% të planit vjetor sipas AN nr. 3.*
- ✓ *Shpenzimet e tjera sociale me 94.1% të planit të periudhës, 58.9% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 59.2% të planit vjetor sipas AN nr. 3.*

Figura 16: Struktura e shpenzimeve korentë (në milionë LEK dhe në përqindje)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet e personelit për periudhën 8-mujore të vitit 2024 përfaqësuan 19.5% të totalit të shpenzimeve korentë. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 71.1 miliardë lekë realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 8-mujore, në masën 92.2% ose 59.3% e planit vjetor sipas

buxhetit fillestar dhe 59.1% e planit vjetor sipas AN nr. 3. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ky zë është 11.1% më i lartë ose rreth 7.1 miliardë lekë më shumë.


Figura 17: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet për interesa për periudhën 8-mujore të vitit 2024 kanë përfaqësuar 11.1% të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre prej rreth 40.5 miliardë lekë ka rezultuar në masën 92.4% të planit të periudhës ose 61.1% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 62.9% sipas AN nr. 3. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ky zë ka rezultuar 34.4% më i lartë ose rreth 10.3 miliardë lekë më shumë.


Figura 18: Shpenzimet për Interesa (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet operative & mirëmbajtje për periudhën 8-mujore të vitit 2024 kanë shënuar një realizim në masën rreth 36.3 miliardë lekë ose 95.0% të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 54.1% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 50.2% të planit vjetor sipas AN nr.3. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, ky zë ka rezultuar 4.1% më i ulët, ose rreth 1.6 miliardë lekë më pak.


Figura 19: Shpenzimet Operative e Mirëmbajtje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet për subvencione, për periudhën 8-mujore të vitit 2024 arritën nivelin rreth 787 milionë lekë, me një realizim në masën 77.6% të planit të periudhës ose 42.5% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 41.3% sipas AN nr.3. Ndërkohë që, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2023 shpenzimet për subvencione rezultojnë 16.3% më të larta ose 153 milionë lekë më shumë.

Figura 20: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet për fondet speciale për periudhën 8-mujore të vitit 2024 rezultuan në nivelin rreth 154.2 miliardë lekë, me një realizim prej 97.9% kundrejt planit të periudhës ose 61.9% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe sipas AN nr.3. Përkatësisht:

- shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 116.4 miliardë lekë,
- shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 37.2 miliardë lekë dhe
- shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 574 milionë lekë.

Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2023, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 8 miliardë lekë më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë 3.4 miliardë lekë më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve 445 milionë lekë më të ulëta.

Figura 21: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2024)


Shpenzimet për papunësinë për periudhën 8 mujore të vitit 2024 janë realizuar në masën 557 milionë lekë ose 103.9% e planit të periudhës ose 69.6% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe sipas AN nr.3. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2023 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 2.7%, ose 15 milion lekë më shumë.

Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për periudhën 8- mujore të vitit 2024 u realizuan në masën rreth 15.5 miliardë lekë duke rezultuar 97.7% e planit të periudhës ose 59.0% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 59.3% sipas AN nr. 3. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2023 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 1.5% ose 240 milionë lekë më pak.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik, për periudhën 8 mujore të vitit 2024 u realizuan në masën 700 milionë lekë duke rezultuar 80.4% e planit të periudhës ose 58.3% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe sipas AN nr. 3. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2023 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje prej 16.9% ose 142 milionë lekë më pak.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për periudhën 8 mujore të vitit 2024 u realizuan në masën 1.2 miliardë lekë duke rezultuar 66.7% e planit të periudhës ose 54.5% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe sipas AN nr. 3. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2023 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 42.9% ose 900 milionë lekë më pak.


Figura 22: Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet për pushtetin vendor, për periudhën 8-mujore të vitit 2024 kanë arritur në masën rreth 43.2 miliardë lekë duke përbërë 11.9% të shpenzimeve korente. Këto shpenzime janë realizuar në masën 93.7% të planit të periudhës ose 60.6% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 54.4% sipas AN nr. 3. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2023 ky nivel rezulton 6.9% më i lartë ose rreth 2.8 miliardë lekë më shumë.

Figura 23: Shpenzimet e Pushtetit Vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Shpenzimet kapitale, për periudhën 8-mujore të vitit 2024 kanë një realizim në masën rreth 42.1 miliardë lekë ose 81.9% në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Financimi i brendshëm është realizuar në masën rreth 27.5 miliardë lekë ose 83.4% të planit të periudhës. Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë janë realizuar në masën 496 milionë lekë ose 136.2% të planit të periudhës. Financimi i huaj ka shënuar një realizim prej rreth 9.5 miliardë lekë ose 72.6% të planit të periudhës. Fondi i rindërtimit për periudhën 8 mujore të vitit 2024 është realizuar në masën rreth 4.6 miliardë lekë, duke rezultuar 92.5% e planit të periudhës, 66.0% planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 51.4% sipas AN nr.3. Nga ky realizim, rreth 174 milionë lekë janë shpenzime nga qeverisja qendrore dhe rreth 4.4 miliardë lekë janë shpenzime nga qeverisja vendore.

Krahasuar me planin vjetor 2024, për periudhën 8-mujore të vitit 2024 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i shpenzimeve kapitale në masën 32.5% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 28.0% për qind të planit vjetor sipas AN nr.3. Financimi i brendshëm është realizuar në masën 35.5% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 27.3% të planit vjetor sipas AN nr.3. Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë janë realizuar në masën 49.6% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe AN nr.3. Financimi i huaj është realizuar në masën 21.7% të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 23.8% të planit vjetor sipas AN nr.3.

Figura 24: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Fondi rezervë

Fondi rezervë, i miratuar me ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, në masën 3.5 miliardë lekë, është parashikuar të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme.

Deri në fund të periudhës 9-mujore 2024, ky fond është përdorur si më poshtë:

Fondi rezervë për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme është përdorur nëpërmjet 8 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) me vlerë totale prej rreth 1 742 milionë lekësh, nga 3.5 miliard lekë të planifikuara ose në rreth 49.7 % për qind të planit. Nga këto:

- ✓ 1.6 milionë lekë janë përdorur për shpenzime personeli;
- ✓ 203 milionë lekë janë përdorur për shpenzime të tjera korrente (shpenzime operative dhe transfertat të brendshme);
- ✓ 1 537 milionë lekë janë përdorur për investime.

Gjendja e papërdorur e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, në fund të 9-mujorit 2024 rezulton rreth 1 758 miliard lekë.

Fondi i kontingjencës për “Politika të reja pagash”

Ky fond i cili në ligjin e buxhetit është planifikuar prej **11 miliardë lekësh**, deri në fund të periudhës 9-mujore 2024 është përdorur në vlerën **9 982 milionë lekë**, i cili është akorduar ministrive dhe institucioneve qendrore si edhe njëjësive të qeverisjes vendore për përballimin e efekteve të rritjes së pagave në zbatim të VKM-ve si më poshtë:

- ✓ VKM nr.421, datë 26.6.2024, “Për një ndryshim në VKM nr.325, datë 31.5.2023, 'Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

- ✓ VKM nr.422, datë 26.6.2024, "Për një ndryshim në vendimin nr.326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike".
- ✓ VKM nr.424, datë 26.6.2024 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompesimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të forcave të armatosura të RSH, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit".
- ✓ VKM nr.425, datë 26.6.2024, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar".

Fondi i kontigjencës për risqet e borxhit i planifikuar në masën 5.42 miliardë lekësh, deri në fund të 9- mujorit 2024 nuk është përdorur.

Fondi i rindërtimit i planifikuar prej 9 miliardë lekësh është përdorur sipas përcaktimeve të ligjit nr.97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar", për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja.

Deri në fund të periudhës 9-mujore, përdorimi i fondit të rindërtimit me vendime të Këshillit të Ministrave rezulton i përdorur në masën 7 miliardë lekë ose 78% të planit, i ndarë si më poshtë:

- ✓ Rreth 776 milionë lekë janë për projekte të qeverisjes qendrore; dhe
- ✓ Rreth 6 224 milion lekë janë për projekte të qeverisjes vendore.

9.4.2 BUXHETI VENDOR

Menaxhimi i financave publike në nivel vendor përbën një shtyllë të rëndësishme në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike. Në këtë drejtim, Ministria e Financave pas miratimit të ligjit nr.68, datë 27.4.2018 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ka unifikuar, përmirësuar dhe modernizuar procedurat që lidhen me planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit në nivel vendor. Asistenca e dhënë për rritjen e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore si në menaxhimin e të ardhurave, po ashtu edhe të shpenzimeve, po jep efekt të drejtpërdrejtë në përmirësimin e treguesve të të ardhurave dhe menaxhimit të shpenzimeve. Referuar të dhënave të treguesve fiskalë të konsoliduar për pushtetin vendor për 8-mujorin 2024 dhe bazuar në të dhënat e Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë është realizuar analiza e treguesve fiskalë të buxhetit të konsoliduar në 8-mujorin 2024 për pushtetin vendor.

Të ardhurat e pushtetit vendor


Për vitin 2024 të ardhurat e pushtetit vendor u planifikuan në rreth 29.1 miliardë lekësh, por referuar rezultatit të fundvitit 2023 në arkëtimin e këtyre të ardhurave që shënoi një tejkalim me 3.9 miliard lekë krahasuar me planin e rishikuar 2023, e po ashtu edhe realizimit të të ardhurave tatimore të pushtetit vendor gjatë muajve janar-korrik 2024 që rezultoi me një tejkalim prej 7.3 miliardë lekësh kundrejt realizimit faktik të të njëjtës periudhë gjatë vitit 2023, me aktin normativ nr.3 datë 28.8.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, u miratua rishikimi

me rritje prej 8 miliardë lekësh i të ardhurave tatimore të pushtetit vendor, duke rritur planifikimin për taksat lokale me 6.9 miliardë lekë, dhe me 1.1 miliardë lekë për taksën e pasurisë, bazuar pikërisht në performancën e realizimit të tyre në vitin 2023, si edhe përgjatë muajve janar-korrik 2024, duke krijuar kështu besimin e justifikuar për vazhdimësinë e këtyre ritmeve edhe për pjesën tjetër të vitit 2024 dhe rrjedhimisht propozimin për përditësimin në rritje të planit vjetor të tyre nëpërmjet aktit normativ.

Tashmë, deri në fund të 8-mujorit 2024 rrezulton se të ardhurat tatimore të pushtetit vendor janë realizuar në rreth 27.6 miliardë lekë (ku taksa e pasurisë është mbledhur në mbi 5.5 miliardë lekë dhe taksat lokale në rreth 22 miliardë lekë, ku vetëm taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është realizuar me rreth 12 miliardë lekë) dhe referuar këtij realizimi, prishmëria deri në fund të vitit 2024, është që edhe plani prej 37.1 miliardë lekë sipas aktit normativ, të realizohet e madje të tejkalohet.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, të ardhurat e veta vendore të pushtetit vendor janë realizuar me 8.5 miliard lekë më shumë që përkthehet në rreth 45% më shumë.

Figura 25: Të ardhurat e përgjithshme tatimore të pushtetit vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre




mi: Ministria e Financave, <https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/>

- **Taksat lokale**

Nga të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore peshën më të madhe e zënë taksat lokale. Për 8 mujorin 2024 këto taksa zënë rreth 79.8% të shumës totale të të ardhurave tatimore të pushtetit vendor. Të ardhurat nga taksat lokale kanë konsoliduar trendin në rritje nga viti në vit pas reformës administrativo-territoriale dhe për 8- mujorin 2024 këto taksa janë mbledhur në vlerën 22 miliardë lekë, shifër kjo që është rreth 7.2 miliardë lekë ose 48.4% më shumë se vlera e mbledhur gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2023.

Në këtë grup të taksave, vërejmë se pjesën më të madhe të tyre e zë taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, me rreth 54.5% të taksave lokale, që sipas të dhënave të 8- mujorit 2024 vërehet se ka një rritje të konsiderueshme sidomos në bashkinë Tiranë, apo dhe Tarifatat e pastrimit dhe higjienës që zënë rreth 20% të taksave lokale. Referuar të dhënave të treguesve fiskalë të 8- mujorit 2024, Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është rritur me 5.5 miliardë lekë kundrejt 8- mujorit 2023 dhe tarifatat e pastrimit dhe higjienës janë realizuar me rreth 1.2 miliardë lekë më shumë se 8- mujori i vitit 2023.

Figura 26: Të ardhurat nga taksat lokale dhe ritmi i ndryshimit të tyre




Burimi : Ministria e Financave, <https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/>

- **Taksa e pasurisë**

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor. Për 8- mujin 2024, grupi i taksave mbi pasurinë ku përfshihet, ndërtesa, trualli, toka bujqësore dhe transaksionet mbi pasurinë, përbën 20 % të totalit të të ardhurave të veta tatimore të pushtetit vendor. Në vlerë absolute, ato janë mbledhur në rreth 5.5 miliardë lekë në 8- mujin 2024, shifër kjo që është rreth 1.3 miliardë lekë më e lartë ose me një rritje prej rreth 32% krahasuar me vlerën e mbledhur gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2023.

Figura 27: Të ardhurat nga Taksa e pasurisë dhe ritmi i ndryshimit të tyre



Burimi: Ministria e Financave, <https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/>

- **Taksa e biznesit të vogël**

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël pas ndryshimeve fiskale ligjore është bërë zero (ligji nr.112/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”). Kjo lehtësi fiskale që u miratua nga buxheti qendror iu kompensua pushtetit vendor në rritjen e transfertave nga qeveria qendrore. Nga realizimi faktik gjatë 8-mujorit 2024, rezulton se nga ky zë janë mbledhur rreth 56 milionë lekë, që zënë vetëm 0.2% të të ardhurave vendore, të cilat përfaqësojnë detyrime të paguara me vonësë. Disa nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mbledhin detyrime nga ky burim për ato subjekte të cilat nuk kanë kryer pagesat brenda afatit dhe rezultojnë debitorë.

- **Të ardhura të tjera jotatimore të pushtetit vendor**

Një burim tjetër i rëndësishëm i të ardhurave të veta vendore që lidhet drejtëpërdrejtë me aktivitetin e pushtetit vendor, janë të ardhurat jotatimore. Për 8-mujorin 2024, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura jo tatimore në masën mbi 2.7 miliardë lekë, shifër kjo që

është rreth 760 milionë lekë më shumë se 1.9 miliardë lekë të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2023.

Shpenzimet e pushtetit vendor

Shpenzimet e pushtetit vendor si një komponent që kanë një kontribut të rëndësishëm në mirëqënien e qytetarëve, paraqesin tendenca zhvillimore të ekonomisë në tërësi. Objektivi kryesor i Ministrisë së Financave për rritjen e peshës së shpenzimeve të pushtetit vendor në raport me produktin e brendshëm bruto, apo kundrejt shpenzimeve të buxhetit qendror, përbën një tregues të rëndësishëm për vlerësimin e ecurisë pozitive të reformave në menaxhimin financiar në nivel vendor në drejtim të thellimit të decentralizimit fiskal.

Ndër vite shpenzimet e qeverisjes vendore evidentohen si një tregues financiar në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vjen si pasojë e përmirësimit të nivelit të shërbimeve apo funksioneve që qeverisja vendore ofron për qytetarët, të financuara këto si nëpërmjet mbështetjes financiare nga qeveria qendrore në formën e transfertave, po ashtu edhe rritjes së të ardhurave të veta vendore.

Në kuadër të reformës administrative-territoriale, rritja e kompetencave, hapësirës territoriale në administrim dhe sigurisht numrit të banorëve të një bashkie, ka bërë që tashmë ato të rrisin përgjegjësinë, transparencën e konsultimin publik, si dhe llogaridhënien në përdorimin e financave publike vendore.


Buxheti vendor ndër vite ka një rritje të dukshme që vjen si rrjedhojë e decentralizimit fiskal në aspektin e mbledhjes dhe përdorimit në mënyrë autonome të të ardhurave dhe rritjes së transfertave buxhetore nga qeveria qendrore. Konsolidimi i financimit të funksioneve të pushtetit vendor dhe menaxhimi i mirë i shpenzimeve është reflektuar gjatë kësaj periudhe në financimin e shërbimeve publike. Rritja e kapaciteteve administrative për mbulimin e shërbimeve publike ka fuqizuar dhe motivuar ndjeshëm personelin e njësisive të vetëqeverisjes vendore për të arritur rezultate. Megjithatë ndryshimet thelbësore që po pëson pushteti vendor janë në proces konsolidimi të vazhdueshëm.

Shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2024, u planifikuan në rreth 71.4 miliardë lekë dhe u rishikuan në rreth 79.4 miliardë lekë me rishikimin e rritjes së të ardhurave sipas aktit normativ nr.3, datë 28.8.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024, i ndryshuar”. Rritja e shpenzimeve të planifikuara të pushtetit vendor në vitin 2024 vjen për shkak të rritjes së të ardhurave të veta vendore, që gjithashtu do të ndikojë në përmirësim të nivelit të shërbimeve që qeverisja vendore ofron për qytetarët dhe të kapacitetit të njësisive për të zbatuar projektet e investimeve.

Referuar të dhënave të treguesve fiskalë të pushtetit vendor për 8- mujorin 2024, shpenzimet vendore janë realizuar në masën prej rreth 43.1 miliardë lekë, nga 40.3 miliardë lekë që kanë qenë realizuar në 8 mujorin 2023, pra me rreth 2.7 miliardë lekë më shumë ose 7% rritje krahasuar me një vit më parë. Rritja e shpenzimeve të pushtetit vendor reflekton ecurinë mjaft pozitive si në drejtim të menaxhimit financiar ashtu edhe të eficiencës së personelit në mbulimin e shërbimeve publike në nivel vendor.

Sipas grafikut të mëposhtëm, buxheti i pushtetit vendor tashmë ka konsoliduar një trend të qëndrueshëm rritjeje duke shmangur luhatjet e konsiderueshme nga viti në vit, efekt ky i cili vjen që prej vitit 2017.


Figura 28: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre



Burimi: Ministria e Financave, <https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/>

Sa i përket strukturës së shpenzimeve në 8- mujin 2024, peshën më të madhe të zërave të shpenzimeve e zënë ato për personelin me rreth 49.7% të totalit të shpenzimeve, më pas vjen zëri i shpenzimeve operative me rreth 27.3%, dhe më pas shpenzimet për investime të cilat zënë rreth 18% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor në 8- mujin 2024. Për këtë periudhë në tërësi, të gjithë zërat e buxhetit vendor kanë pësuar rritje në raport me 8- mujin 2023, siç konstatohet edhe nga grafiku më poshtë.

Figura 29: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas llogarive ekonomike



Burimi: Ministria e Financave, SIFQ, https://financa.gov.al/realizimi-accrual_cash/

Shpenzimet e personelit, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Për 8- mujin 2024, këto shpenzime janë realizuar në masën 21.4 miliardë lekë (respektivisht 18.4 miliardë lekë paga dhe 3 miliardë lekë sigurime shoqërore e shëndetësore), duke rezultuar me rritje prej rreth 2,2 miliardë lekë më shumë nga e njëjta periudhë e vitit 2023. Rritja e këtyre shpenzimeve, lidhet kryesisht me faktin e rishikimit të nivelit të pagave në kuadër të politikave qeveritare për përmirësimin e pagave në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në buxhetin e vitit 2024 rreth 1.5 miliardë lekë u akorduan me ligj si transfertë e përgjithshme nga buxheti qendror në buxhetin vendor, drejtpërdrejtë për mbulimin e rritjes së pagave, politikë që u nis në vitin 2023 me ndryshimin e pagës minimale. Po ashtu në kuadër të politikës së qeverisë për përmirësimin e pagave edhe gjatë këtij viti, pushteti vendor është financuar konkretisht me 702 milionë lekë për rritjen e pagave për funksionet sektoriale, për punonjësit e Arsimit bazë dhe parashkollor (me 585 milionë lekë) sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.425, datë 26.6.2024, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet

arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, si dhe punonjësit e PMNZSH (me 117 milionë lekë) sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.419, datë 26.6.2024, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Gjithashtu, për pushtetin vendor janë akorduar edhe 702.2 milionë lekë shtesë për rritjen e pagave për punonjësit e administratave të bashkive sipas VKM nr.503, datë 1.8.2024, “Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, të cilat janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve, rezultojnë me rritje prej 11.4% në 8- mujorin 2024 në krahasim më të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 27.3% të totalit të shpenzimeve të periudhës. Në vlerë absolute në 8- mujorin 2024 janë shpenzuar rreth 11.7 miliardë lekë ose rreth 1.2 miliardë lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Duke marrë në analizë edhe vitet e kaluara, vihet re tendenca e rritjes së shpenzimeve operative nga viti në vit, si rrjedhojë e konsolidimit të NJVQV-ve në ushtrimin e funksioneve, por edhe të rritjes së nivelit të shpenzimeve të mirëmbajtjes së vazhdueshme që shoqërojnë investimet tashmë të realizuara.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjera, janë shpenzimet që përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore për të paguar interesat, për të subvencionuar politikat e ndryshme vendore dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Shpenzimet për subvencione në 8- mujorin 2024 janë realizuar në masën 355 milionë lekë dhe kanë rritje me rreth 50 milionë lekë apo rreth 16% më shumë se 8ë mujori 2023, ndërsa shpenzimet e tjera korente janë realizuar në masën mbi 1.8 miliard lekë duke u rritur me rreth 722 milion lekë në krahasim më të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo reflekton kontributin e financimit nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet transfertave në buxhetet familjare apo individët, të ndihmës ekonomike, bursave etj, ndaj qytetarëve në nevojë.

Shpenzimet Kapitale, janë një zë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për faktin që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të buxhetit vendor me rreth 18% të totalit të shpenzimeve faktike për periudhën, por edhe për shkak se këto shpenzime kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Deri në fund të 8- mujorit 2024 vëmë re që shpenzimet për investime janë realizuar në masën 7.7 miliardë lekë. Pritshmëria e ecurisë së realizimit për shpenzimet kapitale mbetet pozitive deri në fund të vitit.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur tabela e të ardhurave tatimore vendore dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 8- mujorit të vitit 2024 dhe 8- mujorit të vitit 2023 dhe ndryshimet e tyre në vlerë dhe në përqindje.

Tabela 28: Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës (në milion lekë)

Nr	E M Ë R T I M I	Realizimi faktik		Ndryshimet	
		8 mujori 2024	8 mujori 2023	në vlerë 2024 ndaj 2023	në % 2024 ndaj 2023
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	27,569	19,049	8,520	144.7%
I.1	Taksa mbi pasurinë	5,514	4,185	1,329	131.7%
I.2	Taksa e biznesit të vogël	56	42	14	134.2%
I.3	Taksa Lokale	21,999	14,822	7,177	148.4%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	43,143	40,357	2,786	106.9%
II.1	Shpenzime Korente	35,379	31,138	4,241	113.6%
	Personeli	21,424	19,156	2,268	111.8%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	11,758	10,558	1,201	111.4%

	<i>Subvencione</i>	355	305	50	116.3%
	<i>Te tjera</i>	1,841	1,119	722	164.6%
II.2	<i>Shpenzime Kapitale</i>	7,764	9,219	-1,454	84.2%

Burimi: Ministria e Financave, <https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/>

Fondi i rindërtimit që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përdorur për rimëkëmbjen pas tërmetit është një pjesë tjetër e shpenzimeve që i kalon drejtpërdrejt buxhetit vendor. Përveç transfertave të pakushtëzuara nga qeverisja qendrore dhe të ardhurave të veta të njërive të vetëqeverisjes vendore, akordimi i këtij fondi ka ndikuar gjithashtu në rritjen e tyre ekonomike. Financimi për NJVQV-të në vitin 2024 është rreth 12.3 miliardë lekë (akorduar me VKM gjatë vitit 2024, si dhe fondet e papërdorura në vitin e kaluar), ndërkohë që përdorimi deri në fund të 8- muorit 2024 është rreth 4.4 miliard lekë.

Tabela 29: Detajimi i fondit të rindërtimit sipas llojit të shpenzimeve (në milion lekë)

Nr	E M Ë R T I M I	8 mujori 2024	
		Realizimi faktik	Buxheti operativ
III.	Fondi i Rindërtimit	4,449	12,332
	<i>Shpenzime kapitale</i>	3,233	9,464
	<i>Shpenzime Operative & Mirëmbajtje</i>	0	148
	<i>Transferta për familjet dhe individët</i>	1,216	2,721

Burimi: Ministria e Financave, SIFQ, https://financa.gov.al/realizimi-accrual_cash/

Detyrimet e prapambetura të pushtetit vendor. Deri në fund të muajit qershor 2024, stoku i detyrimeve të prapambetura për pushtetin vendor është rreth 4.2 miliardë lekë, respektivisht rreth 4.1 miliardë lekë për bashkitë e vendit dhe rreth 90 milionë lekë për qarqet. Krahasuar me vlerën e stokut të detyrimeve të prapambetura të evidentuara deri në fund të muajit dhjetor 2023 konstatohet një ulje e detyrimeve të prapambetura me rreth 619 milionë lekë.

Nga të dhënat deri në qershor 2024 rezultojnë se janë 30 bashki të cilat kanë ulur stokun e detyrimeve të prapambetura krahasuar me stokun në fund të dhjetorit 2023 (bashkitë *Cërrik, Devoll, Dibër, Dimal, Durrës, Fier, Has, Himarë, Kamëz, Kavajë, Klos, Konispol, Kukës, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Mat, Memaliaj, Mirditë, Peqin, Përmet, Poliçan, Prrenjas, Pukë, Roskovec, Sarandë, Skrapar, Tepelenë, Tropojë, Vau i Dejës*). Këtu evidentojmë se bashkitë Prrenjas dhe Librazhd e kanë ulur 100% stokun e tyre të detyrimeve duke e zëruar atë.

Nga të dhënat deri në fund të qershorit 2024 rezultojnë se janë 5 bashki të cilat e kanë zero stokun e detyrimeve të prapambetura (bashkitë *Fushë Arrëz, Përmet, Këlcyrë* që nga viti 2023 dhe tashmë edhe bashkitë *Librazhd e Prrenjas*).

Evidentohen 14 bashki të cilat nuk kanë ndryshim në stokun e detyrimeve të prapambetura për periudhën qershor 2024 krahasuar me stokun në fund të dhjetorit 2023 (bashkitë *Bulqizë, Delvinë, Dropull, Gjirokastrë, Kolonjë, Korçë, Kurbin, Libohovë, Pustec, Rrogozhinë, Shijak, Shkodër, Vlorë dhe Vorë*).

Megjithatë evidentohen edhe 14 bashki të cilat rezultojnë me një rritje të stokut të detyrimeve të prapambetura deri në fund të qershorit 2024 krahasuar me stokun në fund të dhjetorit 2023.

Sa i përket qarqeve rezulton se vetëm 5 nga 12 qarqe kanë detyrime të prapambetura, të cilat deri në fund të qershorit 2024, janë rreth 90.7 milionë lekë. Qarku *Durrës, Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë* të cilët

kanë detyrime të prapambetura, nuk kanë ndryshim në stokun e detyrimeve të prapambetura për periudhën qershor 2024 krahasuar me stokun në fund të dhjetorit 2023, kurse qarku Berat ka një rritje të detyrime të prapambetura me rreth 4.1 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2023.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur tabela e detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor për bashkitë dhe për qarqet, për periudhat: deri në fund të vitit 2023 dhe deri në qershor të vitit 2024, si dhe ndryshimet e tyre në vlerë.

Tabela 30: Detyrimet e prapambetura të pushtetit vendor (në milion lekë)

Detyrimet e prapambetura	Detyrimi i Mbetur deri në Dhjetor 2023	Detyrimi i mbetur deri në Qershor 2024	diferenca Qershor 2024 - Dhjetor 2023
Total 61 Bashkitë	4,752.7	4,129.1	-623.6
Total 12 Qarqe	86.6	90.7	4.1
Totali	4,839.3	4,219.8	-619.5


Burimi: Ministria e Financave, <https://financa.gov.al/detyrimet-e-prapambetura/>

9.5 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2024

Në fund të muajit qershor 2024, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,356.5 miliardë lekë. Në terma nominalë, stoku i borxhit publik është ulur me 6.3 miliardë lekë krahasuar me fundin e vitit 2023.

Edhe gjatë vitit 2024 raporti i borxhit ndaj PBB-së do të vazhdojë të ulet në krahasim me nivelin e fundit të vitit të kaluar si dhe do të vijojë të planifikohet në trajektore rënëse edhe në vitet e ardhme, derisa niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë nën 45% të PBB-së, kjo në përputhje me parimin përkatës fiskal të përcaktuar në kuadrin ligjor. Konkretisht, për vitet në vijim raporti borxh ndaj PBB-së parashikohet 55.8%, 55% dhe 54.1%, përkatësisht në vitet 2025, 2026 dhe 2027.

Figura 30: Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2019- 2024)




Burimi: Ministria e Financave (2024)

Përbërja e Borxhit Shtetëror

Për sa i përket strukturës së maturimit, në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, referuar të dhënave të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024, peshën më të madhe e mbajnë titujt afatmesëm (2-5 vite) me 38.1% të peshës. Në përputhje me objektivin strategjik për rritjen e jetëgjatësisë së portofolit të borxhit të brendshëm, pesha e titujve me afat të gjatë maturimi (7vj, 10vj, 15vj) ka pasur një rritje prej 0.9 pp, ndërkohë pesha e

titujve afatshkurtër ëhtë ulur me 0.6 pp. Pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme ëstë reduktuar edhe përgjatë këtij gjashtëmujori, pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka patur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës për tituj me maturitet të ngjashëm.


Figura 31: Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit të titujve dhe tipit të interesit (2019–Qershor 2024)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 60% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pesha e Eurobondit vlerësohet të jetë në rritje nga viti në vit për shkak të emetimeve më të shpeshta në tregjet ndërkombëtare, ku eurobondi më i fundit është emetuar në muajin qershor 2023 në vlerën prej 600 milionë eurosh. Aktualisht në portofolin e borxhit shtetëror janë 4 eurobonde të pamaturuar në vlerën totale prej 227 miliardë lekë. Pas kategorisë së eurobondit, një peshë të konsiderueshme në portofolin e borxhit të jashtëm shtetëror mbajnë huatë me burim kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh, me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore.

Figura 32: Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas tipit të instrumenteve dhe tipit të interesit (2019–Qershor 2024)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Realizimi i Huamarrjes

Gjatë viteve të fundit, huamarrja është realizuar në përputhje me nevojat buxhetore dhe në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e stabilitetit të marrëdhënies ndërmjet raporteve të kostos dhe risqeve.

Gjashtëmujori i parë i vitit 2024 ka qenë një periudhë pozitive për sa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe nëpërmjet burimeve të jashtme. Huamarrja gjatë periudhës janar-qershor 2024 u

realizua në linjë me buxhetin e vitit 2024 si edhe në linjë me planin e huamarrjes së vitit 2024. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 250.5 miliardë lekë, nga të cilat 95.6% (ose 239.6 miliardë lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 4.4% (ose 10.9 miliardë lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Tabela 31: Realizimi i Huamarrjes (6M1 2023-6M1 2024)

Burimet e Huamarrjes	6M1 2023		6M1 2024	
	Vlera (në mld Lekë)	%/Total	Vlera (në mld Lekë)	%/Total
Burime të Brendshme	224.0	77.5%	239.6	95.6%
Bono Thesari	143.2	49.5%	136.5	54.5%
Obligacione	80.8	28.0%	103.1	41.1%
Burime të Jashtme	65.1	22.5%	10.9	4.4%
Hua për financimin e projekteve	2.3	0.8%	5.3	2.1%
Mbështetje Buxhetore	0.0	0.0%	5.6	2.3%
Eurobond	62.8	21.7%	-	0.0%
Total Huamarrja	289.0	100.0%	250.5	100.0%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Huamarrja e Brendshme

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, Ministria e Financave ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 239.6 miliardë lekë, nga të cilat 136.5 miliardë lekë i përkasin titujve afatshkurtër dhe 103.1 miliardë lekë titujve afatgjatë. Në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 është rritur frekuenca dhe vlera e emetimeve të instrumenteve afatgjata.

Kërkesa për tituj shtetërorë ka qenë më e lartë se oferta e qeverisë pothuajse në të gjitha ankandet e realizuara gjatë fillimit të vitit. Huamarrja neto në tregun e brendshëm në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 rezultoi në nivel prej 23.9 miliardë lekë, dhe u arrit kryesisht (89.7%) nëpërmjet instrumenteve afatgjata. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit u maturuan dy linja obligacionesh në vlera të mëdha, përkatësisht obligacioni 3vj në vlerën 20.8 miliardë lekë dhe obligacioni 5 vjeçar në vlerën 18.7 miliardë lekë. Maturimi i instrumenteve referencë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, do të vijojë me linja të reja instrumentesh referencë 3 dhe 5- vjeçare, emetimi i të cilave do të shtrihet gjatë gjithë vitit 2024.

Tabela 32: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma neto dhe bruto (Janar-Qershor 2024)

Lloji i Titullit	6M1 2024		
	Emetim (në mld Lekë)	Maturim (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në mld Lekë)
Tituj Afatshkurtër	136.5	134.1	2.5
Bono Thesari në Lekë	136.5	134.1	2.5
Tituj Afatgjatë	103.1	81.6	21.5
Obligacione 2 vjeçare	40.9	23.0	18.0
Obligacione 2 vjeçare në Euro	0.0	7.0	-7.0
Obligacione 3 vjeçare	14.7	20.8	-6.2
Obligacione 5 vjeçare	20.9	18.7	2.1
Obligacione 7 vjeçare	15.2	8.4	6.8
Obligacione 10 vjeçare	7.7	3.6	4.1
Obligacione 15 vjeçare	3.6	0.0	3.6
Gjithsej Instrumenta Shtetëror	239.6	215.7	23.93

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Huamarrja e Huaj

Përsa i përket huamarrjes së huaj, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, huamarrja e huaj bruto u realizua në nivelin 10.9 miliardë lekë, e realizuar nëpërmjet kredive në formën e mbështetjes buxhetore dhe kredive për financim projektsh. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, huamarrja e huaj është ulur, për arsye se gjatë të njëjtës periudhë të vitit të kaluar u emetua eurobondi në vlerë 600 mln euro i cili mbante peshën kryesore në huamarrjen e huaj.

Tabela 33: Huamarrja e huaj në terma bruto (6M1 2023-6M1 2024)

Huajamarrja e Huaj Bruto	6M1 2023		6M1 2024	
	Vlera (në mld Lek)	%/Total	Vlera (në mld Lek)	%/Total
Kredi për financim projektsh	2.3	3.5%	5.3	48.5%
Energjia	0.4	0.6%	0.4	4.1%
Transporti	0.7	1.1%	2.1	19.6%
Ujësjellës Kanalizime	0.5	0.7%	0.9	7.8%
Infrastruktura Urbane	0.5	0.7%	1.1	9.9%
Shëndetësia	0.2	0.3%	0.4	3.5%
Të Tjera	0.1	0.1%	0.4	3.6%
Mbështetje Buxhetore	0.0	0.0%	5.6	51.5%
Eurobond	62.8	96.5%	0.0	0.0%
Total Huamarrja e Huaj	65.1	100.0%	10.9	100.0%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Kostot dhe Risqet

Kosto dhe shërbimi i borxhit

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, shpenzimet për interesa të borxhit përllëqariten në vlerën prej 29.3 miliard Lekë, përkatësisht 17.4 miliardë lekë për interesa të borxhit të brendshëm dhe 11.9 miliardë lekë për interesa të borxhit të jashtëm. Ripagesat e borxhit të jashtëm për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 ishin 20.6 miliardë lekë (pagesa për principalin). Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 8.5 miliardë lekë më të larta (41.3% më shumë se gjashtëmujori i parë viti 2023), kjo për disa arsye: (i) si rezultat i rritjes së normave të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj dhe për rrjedhojë zëvendësimit të titujve me norma interesi më të ulëta të cilat maturohen, me tituj të emetuara në kushtet me norma interesi të rritura, dhe (ii) shpërndarja e shpenzimeve për interesa gjatë vitit ndryshon nga viti në vit në varësi të profilit të maturimeve të portofolit të borxhit. Shpenzimet për interesa për gjithë vitin 2024 vlerësohet se do të jenë rreth 23.8% më të larta se shpenzimet e vitit 2023.

Efekti i rritjes së normave në rritjen e koston së borxhit të vendit tonë ka qenë i zbutur si rrjedhojë e kompozimit të stokut të borxhit prej mbi 80% me norma interesi fikse. Rritja e shpenzimeve për interesa ka qenë brenda fondit të parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2024.

Figura 33: Shërbimi i Borxhit T2 2019-T2 2024





Figura 34: Shërbimi i Borxhit 2019-2024



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Yield-i mesatar i ponderuar për borxhin e brendshëm në fund të muajit qershor 2024 rezultoi në nivelin 4.57%, duke u rritur me 0.09 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2023 ku u vlerësua në nivelin 4.48%. Rritja ka ardhur në kategorinë e instrumentave afatgjata kryesisht si rrjedhojë e zëvendësimit të titujve me norma interesi të ulëta që maturohen, me tituj me norma interesi më të larta.

Në portofolin e borxhit të huaj, kosto mesatare për vitin 2024 parashikohet të rezultojë në vlerën 4.11%, duke u rritur me 1.04 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2023, ku u vlerësua në nivelin 3.07%.

Për optimizimin e kostos, huamarrja nga partnerët e zhvillimit për mbështetje buxhetore ose për financimin e projekteve do të jetë një burim i rëndësishëm financimi. Republika e Shqipërisë vazhdon të ketë një bashkëpunim të gjerë në këtë drejtim me një numër të gjerë kreditorësh. Ndër kryesorët do të përmendnim Bankën Botërore, BERZH, KfW (Qeveria gjermane), CEB, EIB, IDB. FMN ka qenë gjithashtu një kontribues i rëndësishëm, veçanërisht në vitin 2020 përmes një Instrumenti Financimi të Shpejtë, i cili na asistoi në një moment të vështirë ku nevojat për financim ishin të larta dhe fondet nevojiteshin në një kohë sa më të shpejtë. Aktualisht kjo kredi është duke u ripaguar.

Risqet

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes së kostos në nivelet më të ulëta të mundshme, bazuar në kushtet aktuale të tregut. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024, strukturat pranë Ministrisë së Financave përgjegjëse për menaxhimin e portofolit të borxhit, kanë vazhduar përpjekjet në kuadër të mirëmenaxhimit të portofolit të borxhit, dhe të gjithë indikatorët e riskut kanë evoluuar në drejtim të objektivave strategjikë. Përzgjedhja e titujve dhe

orientimi i huamarrjes drejt titujve afatgjatë me norma interesi fikse, ka favorizuar evolucionin e indikatorëve të riskut drejt objektivave strategjik.

Jetëgjatësia e borxhit të brendshëm (ditët mesatare në maturim) është rritur me 85 ditë, nga 835 ditë (2.32 vite) në fund të vitit 2023 në 920 ditë (2.56 vite) në fund të muajit qershor 2024. Gjithashtu, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti është reduktuar nga 44.7% në fund të vitit 2023, në 43.9% në qershor 2024.

Për sa i përket riskut të normave të interesit, është rritur koha mesatare në rifiksim nga 2.33 vite në dhjetor 2023 në 2.57 vite në muajin qershor 2024, ndërkohë që është reduktuar pesha e instrumenteve që rifiksojnë normën e interesit nga 45.4% në fund të vitit 2023, në 44.4% në qershor 2024.

Risku i kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll duke qëndruar nën tavanin e përcaktuar në strategji. Konkretisht, totali i stokut të borxhit në valutë ndaj stokut të borxhit total rezultoi 43.26% në fund të muajit qershor 2024.

Tabela 34: Treguesit e riskut të borxhit të brendshëm shtetëror (2019–Qershor 2024)

	2019	2020	2021	2022	2023	T2 2024
Borxhi që maturuhet brenda një viti	47.7%	44.8%	46.6%	47.9%	44.7%	43.9%
Koha Mesatare në Maturim (në Vite)	2.19	2.18	2.20	2.17	2.32	2.56
Borxhi që rifiksohet brenda një viti	50.9%	46.7%	48.0%	49.0%	45.4%	44.4%
Koha Mesatare në Rifiksim (në Vite)	2.11	2.14	2.19	2.17	2.33	2.57
Borxhi në monedhë të huaj/Totalit të stokut të borxhit	45.60%	47.38%	49.78%	46.85%	45.65%	43.26%

Burimi: Ministria e Financave (2024)

Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë

Ecuria e ankandëve


Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë periudhës janar-qershor 2024 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ku vlen të përmendet kërkesa e tregut në nivele të kënaqshme në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje dhe vijimi me projektin market maker për emetimin e obligacionit 5-vjeçar dhe 3-vjeçar referencë. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024 kërkesa për tituj shtetërorë ishte në nivele të kënaqshme, duke tejkaluar ofertën e qeverisë për tituj shtetërorë. Raporti i mbulimit ka qenë mbi 1.0 në pothuajse të gjithë ankandet e realizuara si në kategorinë e titujve afatshkurtër dhe në kategorinë e titujve afatgjatë. Kërkesa për tituj shtetërorë ka vazhduar të mbështetet tek investitorët vendas (rezidentë), ndërkohë që sektori bankar mbetet burimi kryesor i kërkesës me mbi 60% të peshës.

Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së tregut primar dhe stimulimit të tregut sekondar, kanë vazhduar të ndërmerren aktivitete, të cilat kanë pasur si objektiv reduktimin e fragmentimit të kërkesës, si dhe konsolidimin e madhësive benchmark për titujt afatgjatë. Titujt referencë 3 dhe 5- vjeçar janë emetuar me sukses gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024: konkretisht Obligacioni referencë 3 vjeçar është emetuar në shumën totale 14.6 miliardë lekë dhe obligacioni referencë 5- vjeçar është emetuar në shumën totale 16.4 miliard lekë.

Ecuria e normave të interesit

Normat mesatare të ponderuara gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2024 kanë shënuar rritje të lehtë krahasuar me fundin e vitit 2023 në kategorinë e instrumenteve afatgjatë, e ndikuar kjo nga rritja e normave të interesit, kryesisht gjatë viteve 2022 dhe 2023, dhe për rrjedhojë zëvendësimit të titujve me norma interesi më të ulëta të cilat maturohen, me tituj të emtuar në kushtet me norma interesi të rritura. Ndërkohë, në kategorinë e instrumenteve afatshkurtër, normat mesatare të ponderuara janë ulur krahasuar me fundin e vitit 2023.

Figura 35: Yield-et titujve shtetërorë⁶ (2022- 6MI 2024)



Burimi: Ministria e Financave (2024)

Pritshmëritë për borxhin në vitin 2025

Referuar parashikimeve të rritjes ekonomike, si edhe deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2024, niveli i borxhit publik në raport me PBB-në në fund të vitit 2024 parashikohet të ulet në rreth 56.3%, ndërkohë që në fund të vitit 2025 planifikohet në nivelin prej 55.8%. Gjithësesi, niveli i pritshëm i borxhit mbetet në varësi të realizimit të planit të huamarrjes gjatë pjesës së mbetur të vitit 2024 dhe gjatë 2025.

Huamarrja e brendshme gjatë vitit 2025 planifikohet në një vlerë prej 50 miliardë lekësh, në të njëjtin nivel me vitin 2024. Huamarrja e re në tregun e brendshëm pritet të realizohet kryesisht nëpërmjet titujve shtetërorë afatgjatë në përputhje me objektivat për reduktimin e risqeve, por gjithashtu duke ju përshtatur edhe preferencave të investitorëve për titujt.

Huamarrja e huaj parashikohet të realizohet kryesisht nëpërmjet disbursimit të huave që financojnë ecurinë e zbatimit të projekteve prioritare të qeverisë, si dhe disbursimit të mbështetjeve buxhetore procedurat dhe kushtet paraprake të cilave mund të arrijnë të plotësohen gjatë vitit 2025. Në rast se kushtet e tregut do të jenë të favorshme, gjatë vitit 2025 planifikohet gjithashtu dhe emetimi i një Eurobondi. Në total huamarrja e huaj gjatë vitit 2025 vlerësohet të jetë rreth 111.3 miliardë lekë dhe duke konsideruar borxhin e huaj që ripaguhet gjatë vitit, huamarrja neto pritet të rezultojë në nivelin 8.2 miliardë lekë.

Sa i përket zhvillimeve më të fundit të normave të interesit, në tregjet ndërkombëtare kushtet financiare vijojnë të mbeten të shtrënguara, duke reflektuar nivelin ende të lartë të normave bazë të interesit. Megjithatë, gjatë vitit 2024 ka filluar rënia e normave të inflacionit duke bërë të mundur nisjen e uljes së normave të interesit nga disa prej bankave qendrore. Ndërkohë Banka e Shqipërisë, në muajin mars 2024 uli për herë të parë normën bazë të interesit nga 3.25% në 3%, dhe ka vazhduar ta mbajë në të

⁶ I referohet normës mesatare të ponderuar të titujve shtetërorë të emtuar vetëm në tregun primar.

njëjtin nivel prej 3% në vazhdim. Pavarësisht, uljes së normës bazë në tregun vendas dhe uljes së normave bazë në tregun e huaj, portofoli aktual i borxhit ka në stok instrumenta të cilat janë emetuar në kushtet e normave të rritura të interesit, të cilat japin efekt deri në përfundim të afatit të maturimit të këtyre instrumeve. Bazuar në normat më të fundit të interesit, si edhe bazuar në nivelin e huamarrjes së brendshme dhe asaj të jashtme për vitet 2024 dhe 2025, shpenzimet për interesa në tregun e huaj pritet të jenë në nivele të krahasueshme me vitin 2024, ndërkohë në tregun e brendshëm shpenzimet për interesa janë planifikuar me një rritje prej rreth 3.4 mld lekë krahasuar me vitin 2024. Për sa i përket ripagesave të borxhit të jashtëm (principali), në vitin 2025 planifikohen të jenë në vlerën 103.12 mld lekë. Ripagesat në vitin 2025 përfshijnë veç të tjerave edhe maturimin e eurobondit të emetuar në vitin 2018 në vlerën 39.9 mld lekë si edhe maturimin e huas së garantuar nga Banka Botërore në vlerën 200 mln euro.

Tabela 35: Shërbimi i borxhit shtetëror 2024-2025

(në milion Lekë)

<i>Shërbimi</i>	<i>Janar-Qershor 2024 (Fakt)</i>	<i>2024 (I Pritshmi)</i>	<i>2025 (Plan)</i>
<i>Shërbimi Borxhit Shtetëror</i>	49,820.5	104,286	165,893
<i>Interesat e Borxhit të Brendshëm Shtetëror</i>	17,387.6	34,494	37,906
<i>Interesat e Borxhit të Jashtëm Shtetëror</i>	11,869.6	24,414	24,866
<i>Ripagesat e Borxhit të Jashtëm</i>	20,563.3	45,379	103,120

Burimi: Ministria e Financave (2024)

9.6 BUXHETIMI I PËRGGJIGJSHËM GJINOR PËR VITIN 2025

Për vitin 2025, qeveria shqiptare do të vijojë zbatimin e angazhimeve të saj në adresimin e problematikave me bazë gjinore në sektorë të ndryshëm. Vëmendje u është dhënë përmbushjes së objektivave afatmesëm të parashikur në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030, të shprehur në 5 shtylla kryesore veprimi afatgjatë dhe që kanë të bëjnë në pjesën më të madhe të tyre me fuqizimin e grave dhe vajzave në Shqipëri. Arritja e këtyre objektivave synon jo vetëm krijimin e mundësive dhe kushteve të përshtatshme për gratë dhe vajzat që të mund të jetojnë dhe kontribuojnë në mënyrë të barabartë me burrat dhe djemtë, por sigurisht edhe ruajtjen e balancave dhe ekuilibrave të qendrueshëm mes tyre në shoqëri. Ofrimi i shërbimeve publike të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, është jo vetëm në linjë me objektivat gjinor të Qeverisë shqiptare, por edhe në përputhje të plotë të objektivave të zhvillimit të qendrueshëm të OKB-së, me qëllim që askush të mos mbetet pas.

Trendi i parashikimeve buxhetore që adresojnë çështje të ndjeshme gjinore ka një rritje kryesisht të reflektuar në programe buxhetore për të gjithë sektorët në nivel qendror në: mbrojtje sociale, arsim, shëndetësi, rend publik, bujqësi, drejtësi, etj. Konkretisht, 77 programe buxhetore nga 131 programe buxhetore kanë përfshirë në mënyrë efektive buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në kërkesat e tyre ose 11 ministri linje dhe 26 institucione qendrore kanë kryer analiza gjinore të politikave dhe buxheteve të tyre si dhe kanë parashikuar të adresojnë çështje me rëndësi për barazinë gjinore në Shqipëri. Në tabelën e mëposhtme⁷ paraqiten në mënyrë më të detajuar shpenzimet e planifikuara me kostot përkatëse që adresojnë pabarazi gjinore të sektorëve ku veprojnë ministrinë e linjës dhe institucione të tjera qendrore.

⁷ Këtu përfshihen vetëm të dhënat e marra nga sistemi AFMIS dhe relacionet e institucioneve përkatëse. Përlllogaritjet përfshijnë vetëm të dhënat e dukshme në sistem. Politika/objektiva të tjerë që adresojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë pabarazitë gjinore, nuk janë përfshirë në këtë përmbledhje.

Tabela 36

Ministria/Institucioni	Programi Buxhetor	Kosto e planifikuar (në lekë)
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Planifikim, Menaxhim, Administrim	218,941,404
	Keshillimi dhe informacioni bujqesor	2,400,000
	Zhvillimi Rural	519,288,172
	Nen-Totali	740,629,577
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	Planifikim, Menaxhim, Administrim	346,097,613
	Ujesjelles Kanalizime	10,800,000
	Nen-Totali	356,897,613
Ministria e Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit	Planifikim, Menaxhim, Administrim	60,356,800
	Arsim i mesem Profesional	50,888,482
	Tregu I Punes	668,954,517
	Inspektimi ne Pune	230,835,600
	Sigurimi Shoqeror	17,350,685,594
	Strehimi Social	64,066,594
	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	23,611,343
	Nen-Totali	18,449,398,930
Ministria e Arsimit dhe Sportit	Planifikim, Menaxhim, Administrim	12,220,998
	Arsimi Baze	14,602,197,362
	Arsimi I Mesem I Pergjithshem	5,674,083,450
	Arsimi I larte	5,627,137,670
	Nen-Totali	25,915,639,480
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	Sherbimi Paresor	520,503,191
	Sherbimi Dytesor	5,336,348,788
	Shendeti Publik	38,500,000
	Perkujdesi Social	16,926,055,968
	Nen-Totali	22,821,407,946
Ministria e Drejtesise	Planifikim, Menaxhim, Administrim	35,000,000
	Ndihma Juridike	27,000,000
	Sistemi I Burgjeve	8,500,000
	Permbarimi Gjyqesor	101,516,223
	Shërbimi i Provës	7,100,000
	Mjekesia Ligjore	4,300,000
	Nen-Totali	183,416,223
Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	Mbeshtetje Diplomatike jashte vendit	100,000,000
	Nen-Totali	100,000,000
Ministria e Brendshme	Policia e Shtetit	761,316,014
	Garda e Republikes	1,165,100,671
	Gjendja Civile	336,633
	Nen-Totali	1,926,753,318
Ministria e Mbrojtjes	Forcat e Luftimit	1,143,240,800
	Mbështetja e Luftimit	464,218,050
	Mbeshtetje per shendetesine	3,811,110
	Arsimi Ushtarak	65,128,492
	Nen-Totali	1,676,398,452
Avokati Popullit	Sherbime te Avokatise	3,015,718
	Nen-Totali	3,015,718
Shkolla e Magjistratures	Veprimtaria Arsimore	85,583,437
	Nen-Totali	85,583,437
Kuvendi	Veprimtaria Ligjvenese	12,988,564
	Nen-Totali	12,988,564
Akademia e Shkencave	Veprimtaria Akademike	2,400,000
	Nen-Totali	2,400,000
Qendra Kombetare e Kinematografise	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	19,000,000
	Nen-Totali	19,000,000
Agjencia per Media dhe Informim	Sherbime te tjera	78,228
	Nen-Totali	78,228
Agjencia per Rinine	Mbeshtetje per Rinine dhe Femijet	125,000
	Nen-Totali	125,000
	TOTALI	72,293,732,486
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore 2025	795,833,545,557
	Perpjese e Buxhetimit te Pegjigjshem Gjiner (ne %)	9.1%

- ❖ Një përlogaritje më e qartë mbi shpenzimet që dedikohen buxhetimit të përgjigjshëm gjinore do të reflektohet në fazës finale të projektbuxhetit, pasi në këtë fazë për një pjesë të produkteve nuk mund të përlogariten në mënyrë të drejtpërdrejt shpenzimet me bazë gjinore, për më tepër dhe totali i shpenzimeve buxhetore është parashikuar në rritje. Si pjesë e kostove me bazë gjinore janë përfshirë dhe politikat e reja që janë financuar gjatë procesit të projektbuxhetit

Më konkretisht:

Me qëllim zbutjen e efekteve ekonomike dhe sociale të rritjes së inflacionit si dhe ndryshimeve në tregun e mallrave, është rritur vëmendja e qeverisë ndaj grupeve në nevojë:

- të moshuarve, sidomos ata të vetëm dhe atyre nga grupet në nevojë, për të cilët është alokuar një fond prej 4,609,029,000 lekësh, me qëllim zbutjen e efektit të rritjes së çmimeve. Nga ky fond përfitojnë 423 570 pensionistë, prej të cilëve 47400 janë gra të vetme, kostoja e përfitimit për të cilat është rreth 10,384,057,830. Kjo masë synon zbutjen disi edhe të efekteve financiare që vijnë nga humbja e bashkëshortëve për këto gra dhe familje në përgjithësi. Përfitime në vlerën rreth 1.246 miliardë lekë vijnë edhe nga indeksimi i pensioneve për gratë pensioniste; ndjeshmëri më e lartë dhe mbrojtje e veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj. Për vitin 2025 parashikohet të përfitojnë 8 000 gra për një vlerë prej 820,000,000 lekësh.
- 5,720,204,000 lekë do të shpërndahen për 15 655 nëna që parashikohet të lindin gjatë 2025 dhe të cilat janë aktive në tregun e punës; po ashtu 699 pritet të përfitojnë nga leja e barrë-lindjes, në rastet kur nënat nuk mund të përfitojnë nga kjo skemë.
- 2,250,000,000 lekë për 33 000 bebe që parashikohet të lindin gjatë 2025, përmes garantimit të shpërblimit financiar për çdo fëmijë të ardhur në jetë, pavarësisht, statusit social dhe ekonomik, si dhe në kuadër të incentivave për rritjen e natalitetit, ku për 8 muajt e parë të 2024 janë mbështetur 10 893 fëmijë;
- Mbështetja e grupeve në nevojë me ndihmë ekonomike në 2025 do të ofrohet për 62 000 familje, me një ulje prej 1000 familjesh, duke synuar përfshirjen e burrave dhe grave nga këto familje në tregun e punës;
- 47% e përfituesve (29 140) të ndihmës ekonomike janë gra të dhunuara dhe vlera e përfitimit në total prej tyre është 3,209,400,000 lekë;
- 8000 gra me më shumë se 3 fëmijë do të përfitojnë 3-fishin e ndihmës ekonomike për vitin 2025 për një vlerë prej rreth 820 milionë lekë;
- 18,138,000,000 lekë do të shpenzohen për gra dhe burra me aftësi të kufizuara si dhe kujdestarët e tyre. Edhe kjo masë synon të zbusë jo vetëm problematikat e shkaktuara nga aftësitë e kufizuara të tyre, por edhe të njohë punën e papaguar të kujdestarëve (më së shumti të grave) që kujdesen për ta;
- 170 fëmijë do të përfitojnë nga shërbimet sociale ditore. Duke qenë se pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve janë nga familje vulnerabël, strehimi i tyre ditor në këto qendra ndihmon edhe në uljen e kohës së punës së kujdesit të papaguar të grave në këto familje, duke u shtuar mundësitë e tyre për të hyrë në tregun e punës. Për sa i përket numrit të fëmijëve femra që trajtohen në këto qendra sociale janë 60 dhe kostoja për këtë produkt është 106,072,941 lekë;
- 300 të moshuar, nga të cilët 125 janë gra, do të strehohen në qendrat e kujdesit për moshën e tretë. Kostoja për kujdesin ndaj këtyre grave në këto qendra është 93,078,750 lekë;
- Për gratë dhe vajzat e dhunuara apo familjet njëprindërore do të vijohet të mbështeten me strehim social. Kostoja për strehimin social të 970 grave dhe vajzave të kategorisë së përcaktuar sipas

ligjit përlllogaritet rreth 64,066,594 lekë, përlllogaritur si përpjesë e dy produkteve kryesore të skemave.

Reduktimi i numrit të personave që përfitojnë nga pagesa e papunësisë 3 750 papunë përgjatë 2025-2027, synon të përkthehet në integrimin e grave dhe burrave nga këto familje, në tregun e punës. Për këtë qëllim:

- do të vijojë puna me NJQV në kuadër të “Fondit social” për punësimin e 148 grave dhe burrave gjatë 2025;
- Synohet të punësohen në total 9 800 punëkërkues të rinj (16- 29 vjeç) në 2027 nga 9 546 të parashikuar në vitin 2024;
- Synohet të rritet punësimi i punëkërkuesve të papunë nga grupet me aftësi të kufizuar (nga ndërmjetësi dhe nxitja e punësimit) dhe nga grupe të tjera të veçanta në rreth 420 në vitin 2027 nga 332 të parashikuar në vitin 2024;
- 79% e punëkërkuesve të papuna gra të mbajtura në punë pas përfundimit të programit të nxitjes së punësimit në vitin 2027 nga 75% të planifikuara në vitin 2024;
- 150 të rinj që përfitojnë nga skema e garancisë rinore, çdo vit përgjatë 2025-2027;

Arsimimi i vajzave, sidomos atyre nga zonat rurale vijon të mbetet një prioritet i politikave të arsimit, sidomos gjatë vitit 2025, ku vërehet një ulje e ndjeshme e nxënësve në të gjitha ciklet e studimit, kryesisht për shkak të uljes së numrit të lindjeve dhe emigracionit. Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:

- 44% e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin 9-vjeçar (240 000 gjithsej nxënës për 2025 ose 105 600 nxënës) janë nga zonat rurale. Prej tyre 46 464 vajza ose 44% ndaj totalit dhe kostoja për shkollimin e tyre në institucionet publike është 5,672,121,453 lekë;
- 56% e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin 9-vjeçar nga zonat urbane ((134 400 gjithsej) ose 75 264 vajza ose 56% ndaj totalit do t’u mundësohet shkollimi për një kosto prej 9,187,899,213 lekësh.
- Do të vijojë të përfitojnë libra falas për vajzat dhe djemtë rreth 240 000 nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe 16 000 në arsimin e mesëm të lartë;
- do të vijojë të ofrohet kompensimi për shërbimin e transportit për 33 000 vajza dhe djem (44% janë vajza) që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe transportin për rreth se 12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë (rreth 95% e stafit arsimor në arsimin bazë dhe të mesëm janë gra);
- do të ofrohen bursa financiare apo kuotë ushqimore/financiare për mesatarisht 4 000 nxënës me nevoja të veçanta si dhe fëmijëve më me ndikim në uljen e braktisjes shkollore, të nxënësve të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë;

Në sektorin e shëndetësisë synohet, si më poshtë:

- Do të vijojnë të mbështeten nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor dhe dytësor, për veten e tyre dhe për bebet që do të vijnë në jetë, duke përmirësuar shërbimet shëndetësore në institucionet e shëndetit parësor dhe dytësor publik. Parashikohet një rritje deri në 85% nga 70% në 2024 të numrit të grave që marrin shërbime në këto institucione. Gjithashtu, parashikohet që 100% e bebeve të lindura të marrin shërbime në institucionet e shëndetit parësor publik. Investimet në maternitete me një kosto prej 337,463,285 lekësh, si dhe mbulimi i kostove prej 4,534,183,600

ekësh për trajtimin e 51 500 nënave dhe bebeve në këto institucione synojnë përmirësimin e kushteve të ofrimit të shërbimeve si dhe rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj shërbimeve shëndetësore publike;

- Do të shtohet numri i grave dhe vajzave që përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës.
 - 5 500 gra parashikohet të përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të gjirit nga strukturat e Shëndetit Publik, për një kosto prej 10,000,000 lekë;
 - 11 500 gra parashikohet të përfitojnë nga shërbimet e depistimit të kancerit të qafës së mitrës nga strukturat e Shëndetit Publik, me një kosto prej 28,500,000 lekë.
- Për herë të parë me qëllim rritjen e mundësive për t'u bërë prindër, do të ofrohet shërbimi i paketave të fertilitetit për 150 çifte, për një kosto prej 25 milionë lekësh;
- Do të punohet për të zbutur diferencat në numrin e burrave dhe grave të moshës 35-66 vjeç që përdorin shërbimin e *check-up* falas, duke shtuar numrin e burrave që përdorin ato për identifikimin në kohë të sëmundjeve, etj.

Në sektorin e sigurisë publike dhe rendit synohet:

- Parandalimi i rasteve të dhunë në familje, mbrojtja e viktimave të dhunës me bazë gjnore dhe asaj në familje si dhe rritja e rolit të grave në strukturat e rendit publik do të vijojnë të jenë prioritetet e sektorit edhe për vitin 2025, si një nga elementet e ndërhyrjes së shtetit për krijimin e mundësive të fuqizimit të grave.
- Do të ulet koha e reagimit ndaj këtyre krimeve deri në 14 minuta;
- Do të ekzekutohen 2 900 urdhra mbrojtjeje të menjëhershëm me një kosto prej 733,415,858 lekë (kostoja mundëson hetimin dhe përgjigjen në kohë ndaj këtyre rasteve emergjente);
- Do të shtohet numri i vajzave dhe grave në forcat e policisë me 100 ose 11% nga 917 rekrutë gjithsej, janë rekrute femra të trajnuara, shpenzimi për trajnimin e të cilave parashikohet të jetë 21,303,162 Lekë;
- Vijon mbështetja me pagesë kalimtare 548,650,000 lekë, ku përfshihet dhe mbështetja për bashkëshortet e policëve të transferuar në vende të ndryshme shërbimi, duke zbutur disi efektet e ndryshimeve në jetët e familjeve të tyre.

Në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural:

- Në politikat e zhvillimit rural për vitet 2025-2027 do të vijohet t'i jepet përparësi, ku prioritet do të kenë edhe rritja e numrit të grave që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor- 520 gra do të përfitojnë shërbime të targetuara informacioni dhe këshillimi bujqësor me një kosto prej 2,400,000 lekësh;
- 154 gra fermere nga 13 900 përfitues gjithsej ose 15.5% të totalit të përfituesve, do të përfitojnë nga një fond prej 519,288,179 lekësh, nga skemat kombëtare të mbështetjes;

Në sektorin e kulturës do të vijohet t'i jepet përparësi:

- grave dhe vajzave artiste që promovojnë skenën e pavarur;
- grave artizane që ruajnë dhe trashëgojnë më tej vlerat dhe traditat e kulturës shqiptare.

Në sektorin e drejtësisë do të vijohet t'i jepet përparësi:

- Të mbahen në kushte të përshtatshme rreth 5 500 të dënuar burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe të trajtohen me shërbim shëndetësor 438 të dënuar të sëmurë;
- Të ofrojë ndihmë juridike falas për rreth 5 000 individë në total që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, prej të cilëve 3 000 ose 60% të totalit, janë gra dhe vajza;
- Të realizojë rreth 18 500 akte ekspertimi të klasifikuara si, mjeko-ligjore, prej të cilave rreth 145 raste të dhunës seksuale;
- Të riintegrohen nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standartet europiane, rreth 360 të dënuar burra, 2 të dënuara gra dhe 6 të dënuar të mitur;
- Të mbikëqyrë në mënyrë efektive 7 000 burra, 800 gra dhe 200 të mitur gjatë shërbimit të provës.

KËSHILLI I MINISTRAVE